


Korrik 2022
Numri: 172
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

MOS E CENONI NATYRSHMËRINË E PASTËR



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.


Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.





ARMIQËSIA NDAJ NATYRSHMËRISË ËSHTË MË E TMERRSHME SE MOHIMI

— Mehmet Lutfi Arslan —

Kur Allahu (xh.xh.), e mallkoi shejtanin, ky i fundit tha: **«Unë do të marr një pjesë të caktuar nga robërit e Tu, me siguri do t'i devijoj, do t'i mashtroj, do t'i urdhëroj dhe ata patjetër do t'u presin veshët kafshëve dhe do t'i urdhëroj që të ndryshojnë atë që ka krijuar Allahu...»** (Nisa, 119) Ndryshimi në pjesën e fundit të vargut erdhi si ekuivalent i fjalës «tag'jir».

Tag'jiri është një nga konceptet më të habitshme në mesin e koncepteve si tebdil, texhdit, tahrif, tedavul, tasrif, të cilat përdoren edhe në Kuranin Fisnik si sinonim me fjalën ndryshim. Kjo fjalë, e cila është e afërt me fjalën «Gajr», do të thotë edhe të japësh dietë në arabisht. Dieta është çmimi ose zëvendësimi i një veprimi. Tag'jiri mund të jetë dy llojesh, si ndryshimi i formës ose krijimi i një alternative. Në secilin rast, e preferuara supozohet të jetë më e mirë se zëvendësuesi.

Kjo folje, për të cilën shejtani thotë se do të urdhërojë për të mashtruar njeriun, shfaqet edhe në dy vende të tjera (Rad, 11 dhe Enfal, 58) në Kuran përveç atij të mësipërmit, dhe e njëjta e vërtetë sociologjike përmendet në të dyja ajetet. Prandaj, nëse njerëzit nuk e ndryshojnë atë që kanë në nefsin e tyre, Allahu nuk do ta ndryshojë vendimin e Tij për ta. Për ata që kanë moral të lartë dhe sjellje të mira dhe vazhdojnë ta mbajnë këtë gjendje, do të ketë mirësi. Kurse prej atyre që e ndryshojnë moralin me të keqen, të mirën me ligësinë dhe drejtësinë me padrejtësinë, u hiqen (merren) begatitë, dinjiteti, mundësitë dhe besimi.

Tag'jiri që shejtani do t'i urdhërojë njerëzit tregon devijim, prishje dhe metamorfozë. Komentuesit kanë bërë interpretime të ndryshme se si mund të ndodhë kjo. Disa prej tyre kanë deklaruar se ndryshimi i formës së krijuar nga Allahu dhe ndryshimi

i pamjes është tag'jir. Shumica e ka kuptuar tag'jirin si prishje të fesë së Allahut (xh.xh.), duke përfshirë edhe kuptimin e lartpërmendur. Ajeti vijues është dhënë si dëshmi për këtë: “Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Rum, 30) Me fjalë të tjera, vepro në përputhje me atë natyrë që Allahu e ka bërë thelbësore në krijimin e qenieve njerëzore. Askush nuk mund ta ndryshojë këtë krijim të Allahut. Ja, kjo është feja e vërtetë. Por shumica e njerëzve nuk e dinë këtë.

Të ndryshosh të krijuarën do të thotë të prishësh natyrshmërinë. Fitrati-natyrshmëria, nëse mund ta shprehim me terma modernë, përbëhet nga cilësimet e fabrikës. Ky është terreni mbi të cilin do të lulëzojë edhe feja. Të gjithë dërgohen në këtë botë me këtë. Mëshira për botët, Profeti ynë, paqja qoftë mbi të, e shpreh këtë në një nga hadithet e tij siç vijon: *«Çdo fëmijë lindi me një natyrshmëri të pastër. Kjo gjendje e tij vazhdon deri në moshën e të folurit, pastaj prindërit e bëjnë atë të krishterë, çifut apo adhures të zjarrit. Nëse prindërit e tij janë myslimanë, edhe fëmija bëhet mysliman.»* (Buhari, Xhenaiz, 79; Muslim, Kader, 23-25.)

Fitrati është vendi i fesë hanif (së pastër). Hanifizmi shpreh besimin e pastër, të qartë dhe të lirë nga të gjitha llojet e politeizmit. Natyrshmëria si një gjendje origjinale dhe natyrore në të cilën Allahu ka krijuar njeriun, e bën të lulëzojë besimin e pastër që nuk është prishur dhe nuk ka pësuar ndryshim nga ndikimi i mjedisit. Për këtë arsye është po aq e rëndësishme sa vetë feja. Fitrati është origjina jonë, potenciali dhe minerali ynë që duhet ta përpunojmë. Kurse feja, nga ana tjetër, është mundësia jonë në këtë çështje, bekimi më i madh i Zotit mbi ne.

Ne erdhëm në këtë botë për të njohur Atë. Këtë do ta bëjmë duke gjetur kuptimin tek ne, duke pastruar neftin tonë dhe duke pastruar zemrat tona. Natyrshmëria është gjendja e pastër e këtij kuptimi. Dita kur lindim është gjendja më e pastër dhe më e dëlirë e natyrshmërisë sonë. Kjo pastërti gërryhet ndërsa përfshihet në jetë. Zgjedhjet tona dhe mjedisi ynë ndikojnë pozitivisht ose negativisht në natyrshmëri. Kështu vështirësohet rikthimi i natyrshmërisë së pastër, e cila është paraqitur në tregun botëror, te Poseduesi i saj. Njeriu që jeton duke e ruajtur natyrshmërinë e tij, mund të ketë një zemër të shëndoshë. Kjo zemër është zemra e shpirtit që është ftuar në shtëpinë e paqes dhe që ka arritur prehjen. Zemra e shëndoshë është ajo që kërkohet nga ne në ditën kur nuk bën dobi as pasuria, as fëmijët.

Vetëm feja e përkufizon dhe përcakton se si do të jetë rruga që fillon me dëlirësinë e natyrshmërisë dhe përfundon me vendin e paqes. Nëse natyrshmëria është cilësimet tona të fabrikës, atëherë feja është udhëzuesi i fabrikës. Prodhim nuk mund të ketë pa punuar fabrika. Ajo që ne prodhojmë ose se si do të jetojmë në këtë fabrikë lidhet me veçantinë tonë. Natyrshmëria duhet të ruhet për sa i përket bukurisë dhe vazhdimësisë së veprave tona. Njeriu që bën vepra të mira dhe ruan natyrshmërinë e tij, jo vetëm që mbron fenë e tij, por ka edhe sukses në një jetë prej së cilës edhe Allahu, edhe njerëzit, edhe ai vetë janë të kënaqur.

Feja, siç thotë ajeti, është «e besuar». Ajo është e bazuar në prova dhe argumente. Në këtë aspekt nuk pranon asnjëherë ndryshim, sepse e mbështet dija dhe arsyeja. Sugjerimi i shejtanit për «shkatërrimin e krijimit» synon të prishë fenë. Prishja e fesë fillon me përkeqësimin e natyrshmërisë, sepse natyrshmëria është themeli mbi të cilin ndërtohet feja. Turma, të cilën shejtani e përshkruan si «pjesën që do të marrë nga robërit e Tij», nuk ndryshon vetëm atë që ka krijuar Allahu, por jeton me iluzione të kota, i mashtron me to edhe të tjerët dhe u pret veshët kafshëve. Këto gjëra, siç e pamë në analizën e fundit, e ndryshojnë fenë e Allahut. Këtë mund ta quajmë edhe tradhti ndaj natyrshmërisë njerëzore. Me fjalë të tjera, ky është mohim i besëlidhjes që kemi bërë me Zotin në Bezmi Elest.

Iluzionet boshe të përshkruara me konceptin Umnije, shprehin dëshirat e nefsit dhe besimet e pritshmëritë që nuk kanë bazë. Njerëzit trillojnë një logjikë alternativë me pëshpëritjet e djallit dhe tërheqjen e jetës së kësaj bote, krahas së vërtetës së sigurt që Allahu e ka nxjerrë në pah me fenë dhe natyrshmërinë, dhe më pas e përvetësojnë këtë logjikë si bariu që i beson gënjeshtërisë së vet. Ky trillim, i hollë sa rrjeta e merimangës, duket shumë i qëndrueshëm në pamje të parë, por ka një jetë shumë të shkurtër. Megjithatë, njerëzit shkojnë pas iluzioneve, hamendjeve dhe ëndrrave të tyre të kalburës dhe injorojnë të vërtetat që vlejnë sa diamantet. Ja pra, kjo është tradhtia me iluzionet, hamendjet dhe ëndrrat tona për ta ndryshuar të vërtetën e besëlidhjes për të cilën Zoti (xh.xh.), na ka njoftuar.

Prerja e veshëve të kafshëve është një formë tjetër e tradhtisë ndaj natyrshmërisë apo besëlidhjes sonë. Ky është guximi për të shpërfillur të drejtën e Zotit (xh.xh.). Arabët ia prisnin veshin devesë që e pillte mashkull të voglin e saj të pestë dhe e linin të lirë rreth Qabesë. Këtë deve, të cilën e konsideronin të shenjtë, e shpallnin të paprekshme. Kjo

do të thotë të shkelësh sovranitetin e Allahut dhe ta bësh të shenjtë një qenie që Ai nuk e ka bërë të tillë. Kjo ndërhyrje arbitrare në hierarkinë e botës së gjallesave është shirk ndaj Allahut Teala duke e ndryshuar atë që është e natyrshme dhe origjinale. Shtrembërimi në cilësinë dhe sasinë e të shenjtës është gjithashtu një tradhti ndaj Allahut (xh.xh.). Askush përveç Allahut nuk mund ta bëjë haram hallallin dhe hallall haramin. Kjo është vjedhja e të drejtës së Rububijetit. Ky ndryshim është një gjendje që djalli dëshiron ta shohë te njerëzit, si një tjetër tradhti ndaj natyrës dhe betimit të njeriut.

Ndryshimi i krijimit të Zotit nga njeriu është tradhti ndaj vetvetes. Përpijka për ta ndryshuar duke mos e pëlqyer atë që konsiderohet e denjë për ne, do të thotë ta hedhim qëllimisht veten në zjarr. Kjo është shpërfillje e nderit që Allahu e konsideron të denjë. Nderi nuk është vetëm të bësh një besëlidhje, nder në të njëjtën kohë është edhe fakti se natyrshmëria që na është caktuar është natyrshmëria e Allahut (xh.xh.). Ajo që ne e quajmë natyrshmëri është natyrshmëria e Allahut, i Cili na ka krijuar me këtë natyrshmëri. Natyrshmëria e Allahut janë ligjet ose Sunnetullahu që Allahu ka vendosur në gjithësi. Përpijka e njeriut për të ndryshuar krijimin dhe natyrshmërinë është mospëlqim i natyrshmërisë së Allahut (xh.sh.). Çfarë do të thotë kjo përveç mospëlqimit të Allahut? Sidoqoftë: **«Ai e ka bërë të bukur gjithçka që ka krijuar.»** (Sexhde, 7). Ai që nuk e pëlqen Allahun, nuk e pëlqen as veten e tij, as krijesat, as ata që e rrethojnë... Kur ndodh kjo, ai përpiqet të ndërhyjë në atë që i jepet. Në radhë të parë dëshiron të ndryshojë hierarkinë e krijesave. Ai i cakton një rol të veçantë Allahut dhe një rol të veçantë vetes së tij, në këtë mënyrë, bëhet prej atyre që e tradhtojnë Zotin, besëlidhjen dhe veten e tij.

Në vazhdim të ajetit të natyrshmërisë vizatohet plotësisht portreti i një tradhtari të tillë. Edhe pse ky tradhtar, të cilit iu dhanë dëshmitë, por i hodhi mënjane, ndoqi shejtanin dhe përfundimisht u bë një nga tiranët, në fillim ndoqi ajetet e Allahut, më vonë u largua prej tyre. Ai kapet fort pas kësaj bote, u bindet pasioneve të tij dhe më pas djalli e ndjek dhe kështu bëhet një nga të devijuarit. Zoti e

krahason këtë tradhtar, të cilin e ka informuar me vargjet e tij, por që gjithnjë e ka përdorur këtë dituri për interesa të kësaj bote për shkak të së keqes së natyrës së tij, me gjendjen e një qeni që e nxjerr gjuhën dhe merr frymë pa pushim edhe nëse e përzë, edhe nëse e lë të qetë. (Shik. A'raf, 175-176.)

Shkurtimisht, prishja e krijimit të Allahut është prishje e natyrshmërisë. Natyrshmëria është vullneti i Zotit për ne dhe feja është bekimi i tij për realizimin e këtij vullneti. Natyrshmëria u është dhënë të gjithëve, kurse feja u është propozuar. Armiqtë e fesë përpiqen të hyjnë mes njerëzve dhe propozimit të fesë. Xhihadi është përpijka për të hequr barrierat ndërmjet fesë dhe njeriut duke u përballur me këta armiq. Por armiqët e natyrshmërisë janë shumë më të dhunshëm dhe më të rrezikshëm. Ata përpiqen ta kthejnë ters vullnetin e Zotit duke sulmuar qëllimin



kryesor të Zotit krahas veprave të Tij. Armiqësia e tyre nuk është ndaj njerëzve apo veprave të tyre, por ndaj vullnetit të Allahut në lidhje me njerëzit. Para së gjithash, nuk e njohin besëlidhjen që kemi bërë me Zotin (xh.xh.). Ata i refuzojnë detyrat që i janë caktuar trupit, gjinisë, mendjes dhe zemrës sonë dhe caktojnë role sipas mendjes së tyre. Rolet ogurzeza që kanë krijuar armiqët e natyrshmërisë, jo vetëm që e bëjnë njeriun lëndë djegëse për zjarrin, por shkaktojnë edhe përkeqësimin e ekuilibrit në univers. Kështu shfaqet prishja në tokë dhe në det. Në këtë kuptim, armiqësia ndaj natyrshmërisë është më e keqe se mohimi.

Të jesh kundër fesë është blasfemi, por të jesh kundër krijimit, kundër roleve që përcaktohen nga krijimi, dhe rrjedhimisht kundër natyrshmërisë, është ta shpallësh Allahun drejtpërdrejt si armik. Lëreni faktin që një njeri i tillë nuk mund të gjejë shpëtim, por kihet frikë edhe për fatin e atyre që janë në një vend, në një kohë dhe në një tokë me të. Historia është plot me shembuj të trishtuar të kësaj, sepse nuk ka ndryshim në natyrshmërinë e Allahut. Ata që janë armiqtë ndaj natyrshmërisë duke ndjekur tekat dhe dëshirat e tyre, në vend që të gjejnë, të kuptojnë dhe të jetojnë sipas vullnetit hyjnor, marrin një përgjigje (ndëshkim) të menjëhershme. Edhe ata që mbyllin veshët ndaj blasfemisë së atyre, marrin pjesën e tyre të këtij përfundimi.

PRISHJA E NATYRSHMËRISË

— Dr. Adem Ergyl —

Fitrati/natyrshmëria shpreh stilin dhe formën e parë të krijimit. Në këtë kuptim, e gjithë ekzistenca ka një natyrorë origjinale që përbëhet nga pajisjet me të cilat mund të realizojnë qëllimin e krijimit të dhënë nga Krijuesi i Plotfuqishëm. E njëjta gjë është edhe për njerëzit. Kjo natyrshmëri, me kalimin e kohës, mund të zhvillohet drejt nivelit të përsosmërisë si rezultat i mjedisit shoqëror, prirjeve të personit, veprave dhe sjelljeve që i ka bërë zakon. Ajo degëzohet dhe jep fruta duke shkuar kështu drejt qëndrueshmërisë më të bukur. Ndryshe nga kjo prirje e natyrshme, si rezultat i moskujdesit ndaj zërit dhe orientimit të natyrshmërisë, dhe më e rëndësishmja, për shkak të kaplimit nga rrymat e dëmshme që ndodhin si rezultat i pranimeve, besimeve dhe sugjerimeve të ndryshme egoiste e djallëzore pavarësisht natyrshmërisë, natyrshmëria mund të mbyllet dhe të bëhet e pafunksionueshme dhe më në fund mund ta humbasë veten në vorbullën e degradimeve dhe devijimeve. Në fakt, misioni themelor i feve dhe profetëve që Zoti u dërgoi robërve të Tij si manifestim i mëshirës së Tij është t'i kujtojë njerëzimit, i cili është prishur apo ka ndryshuar drejtim, vijën e natyrshmërisë dhe të heqë koret mbi xhevahirin në zemrat e tyre. Në ajetin fisnik thuhet:

“(O i Dërguari im!) Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim

të krijimit të Allahut. Ja, kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë...” (Rum, 30)

I ndjeri Elmallëllë Muhamed Hamdi Jazëri thotë në interpretimin e këtij ajeti: “Mos tentoni për ta prishur dhe ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme natyrshmërinë, e cila është krijimi origjinal i Allahut, duke vepruar kështu në kundërshtim me atë që është e nevojshme, sepse nuk ka çmim për krijimin e Allahut Teala. Nuk mund të zëvendësoni me asnjë art një talent që e keni humbur. Feja nuk është për ta ndryshuar natyrshmërinë, por për ta përmirësuar atë. Kjo është feja e vërtetë dhe e shëndoshë. Me fjalë të tjera, është për të shmangur shtrembërimin dhe për të ndjekur me saktësi natyrshmërinë mbi të cilën janë krijuar të gjitha qeniet njerëzore. Mirëpo, shumica e njerëzve nuk e dinë dhe shkojnë në rrugë të gabuar, ata e kërkojnë fenë jo në natyrshmëri, por në zakone, ose ndjekin tekat e tyre dhe kështu përpiqen ta ndryshojnë natyrshmërinë e krijuar nga Allahu (xh.xh.).»

Ndërkohë, gjithçka është e bukur, produktive dhe paqësore për sa kohë që mbetet në natyrshmërinë e saj origjinale. Ashtu siç feminizimi i burrave është padrejtësi, edhe tendenca maskulinizuese e grave është një padrejtësi ndaj rendit dhe harmonisë së ekzistencës, veçanërisht natyrshmërisë së tyre. Çfarë lloj produkti i mendjes dhe inteligjencës është që, në vend që t'i zhvillojë aftësitë dhe qenien





tuaj, t'u dorëzoheni erërave që fryjnë nga brenda (të shkaktuara nga nxitjes egoiste) dhe nga jashtë (me në qendër prishjen satanike) dhe të zvarriteni drejt shkatërrimit duke degraduar? Zoti (xh.xh.), i paralajmëron ata që u drejtohen dëshirave të tilla pavarësisht nga natyrshmëria e tyre siç vijon:

“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët: meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Nisa, 32)

Kurani Fisnik flet për ndryshkjen e zemrave (thelbit njerëzor, natyrshmërisë) si rezultat i sjelljeve të këqija, keqbërjeve dhe mëkateve njerëzore, si dhe për pandjeshmërinë, shurdhimin dhe verbërinë ndaj së vërtetës si pasojë e këtyre.¹ Ja pra, kjo gjendje është rezultat i natyrshëm i zënies kore të natyrshmërisë (prishjes së saj) për shkak të disa dëshirave dhe zakoneve supersticioze. Kjo është një zënie kore e i tillë që zëri i ndërgjegjes nuk dëgjohet më dhe të gjitha dritaret janë pothuajse të mbyllura e të kyçura kundrejt thirrjeve për të vërtetën nga jashtë. Kurani e përshkruan formimin e këtij rezultati si «e keqja që rrethon personalitetin».² Tashmë, kjo situatë e re konsiderohet si një natyrë

e dytë (personalitet), pra një natyrë (personalitet) e dytë që formohet mbi natyrshmërinë e krijimit dhe e mbulon atë. Ajo fillon ta shohë supersticiozen si të drejtë dhe të drejtën si supersticioze. Emocionet, shijet dhe qëllimet ndryshojnë. Pastërtia dhe ndotja, bukuria dhe shëmtia ndërrojnë vend. Mevlana e përshkruan një ndryshim të tillë në Mesnevinë e tij me një tregim si më poshtë:

“Kur dikush shkoi në pazarin e shitësve të parfumeve, e humbi veten, i ra të fikët dhe u shemb për tokë. Era e barbarozës, që vinte nga shitësit e parfumeve, e trulloi atë burrin dhe ai ra përtokë. Ai qëndroi i shtrirë si një kufomë për gjysmë dite në vendkalimin e rrugës, pa dijeni për asgjë.

Atëherë, njerëzit u mblodhën rreth tij dhe filluan të kërkonin një zgjidhje për problemin e tij. Dikush i vuri dorën në zemër duke dashur të dinte nëse ajo po i rrihte. Tjetri i spërkaste ujë me aromë trëndafili në fytyrë. Ai që i spërkaste ujë me aromë trëndafili nuk e dinte se ajo që i ndodhi, i ngjau nga uji me aromë trëndafili. Dikush i fërkonte duart dhe kokën. Tjetri solli kashtë të lagur dhe e fërkoi në gjoks që t'i qetësohej (ulej) temperatura. Dikush po përziente udin me sheqer dhe po bënte tym. Dikush tjetër po i zhvishte rrobat që ta lehtësonte. Dikush tjetër i maste pulsin për të parë se si po rrihte. Një tjetër u përkul dhe po i nuhaste gojën. Ai donte të dinte nëse kishte pirë verë, kishte pirë drogë apo kishte gëlltitur opium. Njerëzit mbetën të shtangur nga humbja e vetëdijes së tij.

1. Shik. Bekare, 6-7; Mutaffifin, 14.

2. Shik. Bekare, 81.

Pastaj u dërguan fjalë të afërmve të tij: “Filani ra pa ndjenja në tregun e shitësve të miskut dhe është shtrirë përdhe.” Pse i ra të fikët, pse i ra legenit nga çatia, domethënë pse u turpërua dhe u shkatërrua? Këtë askush nuk e dinte.

Ai regjës lëkurësh i nxirë që u rrëzua dhe i ra të fikët, kishte një vëlla të fortë dhe të kuptueshëm. Ai erdhi me vrap menjëherë. Ai kishte pak jashtëqitje qenit në mangë. Shkoi te koka e vëllait duke hyrë ndërmjet njerëzve.

«Unë e di pse i ka rënë të fikët atij.», tha ai.

Kur dihet shkaku, është i lehtë për ta kuruar. Nëse shkaku nuk është i qartë, atëherë kurimi është i vështirë. Cili është ilaçi për këtë sëmundje? Ka qindra mundësi për këtë. Por nëse e di shkahun, bëhet më i lehtë. Njohja e shkaqeve të jep mundësinë e kurimit.

Ai tha me vete: “Era e kësaj jashtëqitjes së qenit i ka përshkuar trurin, venat dhe palcën e tij. Sepse, për të siguruar furnizimin (jetesën) e tij, ai përpiket çdo ditë nga mëngjesi në mbrëmje, i zhytur në pisllek, mes erërave të këqija. Kështu ka thënë edhe mjeku i madh, Xhalinusi, i cili konsiderohet mjeshtër në shkencën e mjekësisë: “Jepi pacientit atë që është mësuar, çfarëdo që ai e ka bërë zakon. Sepse sëmundja e tij është diçka që bie ndesh me zakonet e tij. Për këtë arsye, shërimin e sëmundjes së tij kërkoje në gjërat me të cilat ai është mësuar.” Edhe ky burrë është shndërruar në një in-sekt plehu duke qëndruar vazhdimisht në pleh. Natyrisht, insektit të plehut i bie të fikët nga lëngu i trëndafilut. Ilaçi i tij është jashtëqitja e qenit. Sepse ai është mësuar me atë. Ai është mësuar të merret me të. Kështu që e ka bërë zakon.”

Vëllai i lëkurëpunuesit që i kishte rënë të fikët, i përzuri ata që ishin mbledhur rreth të sëmurit që të mos e shihnin ilaçin që do t’ia jepte. E afroi kokën pranë veshit të lëkurëpunuesit, sikur po i thoshte diçka sekrete dhe ai i vuri në hundë një pjesë të pisllekut që kishte në dorë. Ai e kishte shtypur atë në dorë ngaqë e shihte ilaçin për trurin e ndyrë të lëkurëpunuesit në jashtëqitjen e qenit. Burri pa ndjenja, të cilit iu fut jashtëqitja e qenit në hundë, pas pak filloi të lëvizte.

Kur njerëzit e panë këtë gjendje, filluan të thoshin: «Kjo është një magji e mahnitshme.» Ata thoshin:

“Ky njeri i pëshpëriti një magji dhe i fryu në vesh të pavetëdijshmit. Magjistari e ndihmoi njeriun që kishte vdekur.”

Përpëlitjet e njerëzve të këqij janë për shkak të së keqes dhe mëkatit. Ata veprojnë nga tradhtia bashkëshortore, vështirimi keqdashës, shikimi i syrit të lig dhe lëvizja tedencioze e vetullave. Ai që nuk përfiton nga misku këshillues, nga aroma e këndshme e këshillave, patjetër është mësuar me erërat e këqija. Gjërat e pista dhe gjërat e pastra janë të papajtueshme.


O njerëz të besueshëm! Gjërat e pista dhe gjërat e pastra janë të papajtueshme. Gjërat e pista nuk janë të denja për gjërat e pastra. Mosbesimtarët u goditën nga aroma e shpalljeve që u erdhën profetëve. Ata e humbën edhe veten dhe filluan të bërtisnin: «Ne kemi pasur fat të keq për shkakun tuaj.» Ata thoshin: “Fjalët tuaja po na sëmurin, po na shqetësojnë. Ne nuk i komentojmë për mirë këshillat tuaja. Nëse nuk e mbyllni gojën dhe vazhdoni këshillimin në mënyrë të hapur, ne do t’ju vrasim me gurë menjëherë. Ne jemi njerëz të ngopur me budallallëqe që nuk kanë bazë. Kështu që nuk jemi mësuar të dëgjojmë këshilla. Ushqimi ynë është gënjeshtër dhe llafet. Gjërat që thoni ju, nuk janë të vërteta. Gjërat për të cilat na njoftoni ju, po na e shqetësojnë stomakun. Ju po na e rritni sëmundjen njëqindfish. Ju po i jepni mendjes opium si ilaç.”

Po, edhe populli i Lutit, alejhi’s-selam, natyrshmëria e të cilëve ishte ndyrë dhe që e kishin bërë zakon të hanin nga fëlliqësirat, thoshin gjithashtu:

“Përzëjini këta nga vendi juaj! Këta janë njerëz që duan të qëndrojnë të papërlyer.” (Neml, 56)

Ajo që duhet bërë kundrejt atyre që e mbulojnë xhevahirin e natyrshmërisë me katranin e mëkatit, nuk është që t’i lëmë në hallin e tyre duke u thënë: “Mbytuni në fëlliqësinë tuaj!” Po ashtu, nuk është as mbajtja e një qëndrim pasiv. Përkundrazi, është përpjekja për t’i pastruar ata. Nëse ka rezistencë ndaj pastrimit, atëherë është të mos lejohet që fëlliqësia të përfshijë të gjithë shoqërinë. Sigurisht, në këtë rrugë ka diçka për të bërë të gjithë. Thelbësore është të mos ia delegojmë detyrën dikujt tjetër, por ta marrim detyrën sipas fuqisë sonë. Ky është zëri i natyrshmërisë.

GJITHÇKA ËSHTË E BUKUR, PRODUKTIVE DHE PAQËSORE PËR SA KOHË QË MBETET NË NATYRSHMËRINË E SAJ ORIGJINALE. ASHTU SIÇ FEMINIZIMI I BURRAVE ËSHTË PADREJTËSI, EDHE TENDENCA MASKULINIZUESE E GRAVE ËSHTË NJË PADREJTËSI NDAJ RENDIT DHE HARMONISË SË EKZISTENCËS, VEÇANËRISHT NATYRSHMËRISË SË TYRE.



MOS E PRISH RREGULLIN E NATYRSHMËRISË!

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun në mënyrë të veçantë, e bëri atë superior ndaj të gjitha krijesave dhe të gjitha krijesat e kësaj bote i vuri në shërbim të tij. Kjo epërsi i është dhuruar njeriut për shkak të shpirtit të tij, i cili i është fryrë nga Allahu (xh.xh.). Nëse njeriu nuk e menaxhon trupin e tij që vjen nga toka me mendjen dhe shpirtin e tij, bie nga pozita Ahseni Takvim në humnerën Bel Hum Edal. Sepse ndërsa shpirti na tërheq drejt botëve sublime, trupi i krijuar nga dheu na bëhet pengesë dhe na thërret për të kënaqur dëshirat tona shtazore. Megjithatë, trupi ynë ka edhe disa të drejta mbi ne, të cilat duhet t'i jepen. Problemi këtu është se kush do të vendosë masën e dëshirave të pamatura të nefsit dhe nevojave të natyrshme. Sipas myslimanëve, kjo linjë përcaktohet nga Kurani dhe Suneti, ndërsa në gjeografi (vende) të tjera ku fetë janë dobësuar, grupe që ndjekin nefsu'l-emmarë janë përpjekur t'i identifikojnë këto nevoja.

Në shekujt e fundit, përparimi i dijes dhe shkencës dhe arritjet në fushat materiale e kanë destabilizuar shumë ekuilibrin e njerëzimit. Qeniet njerëzore, të

cilat kanë bërë përparime të rëndësishme në fushën e teknologjisë, shkelën në hënë, ndërtuan makineri inteligjente, gjetën kura për shumë sëmundje dhe sekretet e trupit të njeriut i zgjidhën deri në një masë. Disa njerëz të arsimuar, të cilët u trullosën nga këto zhvillime, pohuan se njerëzit nuk kanë më nevojë për fenë dhe se ata mund t'i zgjidhin çështjet shpirtërore/morale sipas mendjes së tyre. Një tregues i këtij mashtrimi është se disa njerëz, të cilët mendojnë se do të mbrojnë të drejtat dhe ligjet e popullit tonë, së fundmi janë përpjekur të fyejnë paralajmërimet e Kryetarit tonë të Çështjeve Fetare për lutizmin (homoseksualizmin) duke i quajtur ato si «një zë i lashtë». Fakti që kjo vepër shumë e shëmtuar sipas mjekësisë, moralit dhe mendjes paraqitet si një virtyt nga këta njerëz që kanë nocionin ligj(!), është shumë i rëndësishëm për të treguar pamjaftueshmërinë e mendjes dhe nevojën që njerëzimi ka për shpalljen hyjnore. Sepse vetëm ata që e shohin mendjen si autoritet dhe nuk besojnë në shpalljen hyjnore, mund t'i bëjnë të duken të mira duke i zbukuruar veprimet më të ulëta morale si

FEJA ISLAME NUK I NDALON GJËRAT E MIRA DHE TË DOBISHME VETËM PËR TË LËNDUAR NJERËZIT, SIÇ MENDOJNË DISA. PËRKUNDRAZI, GJËRAT E NDALUARA JANË GJËRA TË DËMSHME SI HELMI I MBULUAR ME MJALTË. NDALIMET E VENDOSURA NDAJ NJERËZVE JANË PËR TË SIGURUAR MEKASIDI SHERIAT (QËLLIMET E FESË), QË ËSHTË MBROJTJA E JETËS, PRONËS, INTELEKTIT, PREJARDHJES DHE NDERIT TË NJERËZVE.



alkooli, tradhtia bashkëshortore dhe homoseksualizmi nën emrin e kërkesave të biologjisë njerëzore. Sipas sufive, pas përpjekjeve të tyre për të normalizuar haramet qëndron nefsu'l-emmare, të cilën ata e quajnë qenie hije. Poseduesit e nefsu'l-emmares mendojnë se kjo hije është vetvetja e tyre e vërtetë dhe ata galopojnë pas saj drejt shkatërrimit.

NEFSI, VETJA E RREME

Sipas sufive, unë ynë kryesor është shpirti. Junusi i madh e shpreh këtë të vërtetë në formën: «Ka një unë brenda meje.» Megjithatë, meqenëse shpirti vjen në këtë trup si mysafir nga botët e tjera, zëri i tij është i ulët. Zëri i tij mund të forcohet vetëm me edukimin e Profetit (a.s.) dhe pasardhësve të tij, dijetarëve dhe evliave. Turmat e pavëmendshme që nuk kanë vetëdije për shpirtin, e kanë keqkuptuar se këto dëshira janë të lindura, duke pasur parasysh se ndjenjat e kryerjes së haramit gjenden në natyrën/strukturën biologjike të njeriut. Në fakt, çdo njeri ka një dëshirë për gjërat e dëmshme që janë të ndaluara, sepse brumi i nefsit është i mburitur me të ndaluarat. Ky është një sekret sprove që ne nuk mund ta kuptojmë lehtë. Sepse, duke u thënë ndal dëshirave të tepërta të nefsit, njeriu do të fitojë sprovën dhe do të shkojë në xhenet.

Atëherë le t'u pyesim këtë atyre që ndjekin egon e vet dhe përpiqen t'i tregojnë disa haram si normale dhe të natyrshme: Sot, shumë njerëz mund të vrasin qoftë edhe kur nxehen pak, të përdorin dhunën në familje dhe të vjedhin pasurinë e të tjerëve me justifikimin se kanë nevojë. Meqenëse ndjenja e kryerjes së të gjitha këtyre gjërave të ndaluara gjendet te të gjithë, atëherë a duhet t'i tolerojmë këto krime duke i konsideruar si një domosdoshmëri të natyrës sonë? A nuk duhet t'i ndëshkojmë vrasësit, hajdutët dhe përdhunuesit? Çfarë duhet t'u themi sidomos atyre që vrasin gra dhe fëmijë të pafajshëm? Mos vallë duhet të themi: «Çfarë të bëjmë, kjo është natyra e burrave?» Megjithatë, shumë njerëz të

virtutshëm janë në gjendje ta frenojnë nefsin dhe të kontrollojnë natyrën e tyre biologjike në kushte shumë më të vështira.

Kjo do të thotë se dëshira për të bërë haram nuk është një nevojë e lindur, por një teprim i nefsit. Nefsu'l-emmare jo vetëm që i bën këto haramë, por edhe përpiket t'i tregojë këto të këqija si racionale, të natyrshme dhe të bukura duke përdorur mendjen që nuk është edukuar nga shpallja hyjnore. Nëse nefsi gjen rastin e duhur, bëhet faraon dhe nuk ndjen as dhimbjen më të vogël nga robërimi, vrasja dhe shfrytëzimi i dhjetëra mijëra njerëzve. Njerëzit e tillë i quajmë të pashpirt, sepse ata e kanë vlarë plotësisht shpirtin e tyre. Mevlana, një nga sufistë, i cili është mjeshtër në njohjen e natyrës njerëzore, e shpreh këtë tërbim të nefsit si më poshtë: «Ky nefsi është një xhehenem i tillë që as detet nuk mund ta shuajnë zjarrin e tij... Edhe pse me një kafshatë e gëlltit një botë të tërë, stomaku i tij akoma bërtet me zë të lartë duke thënë: «A nuk ka edhe më shumë?» (Vëll. 1, 1375-80.)

Epo, atëherë si ta mbrojmë natyrën tonë pa rënë në tërbimin e nefsit? Përgjigjen e kësaj pyetjeje, veçanërisht sufistë, të cilët janë trashëgimtarë të Profetit në mesin e intelektualëve islamë, e japin duke përcaktuar nevojat e domosdoshme dhe jo të domosdoshme të njeriut brenda kornizës së Kuranit e Sunetit, duke caktuar ndjenjat e mira dhe të këqija të njeriut dhe duke u përpjekur t'i pastrojnë të këqijat prej këtyre përmes dhikrit, meditimit, adhurimit, vetmisë dhe bisedës fetare. Ata na mësojnë se si të luftojmë me nefsin pa lënë pas dore nevojat e natyrshmërisë. Ata e kanë kuptuar se urdhrat e fesë nuk janë ndëshkim, por mëshirë në aspektin e natyrës njerëzore dhe na e kanë mësuar këtë të vërtetë. Për shembull, Imam Rabbani thotë në lidhje me këtë çështje:

«Qëllimi i adhurimeve të sjella nga sheriat i Muhamedit (a.s.), është mbrojtja e interesave dhe mirëqenies së robërve të Zotit. Përndryshe, adhurimet

nuk kanë asnjë dobi për Allahun e Madhërishëm. Andaj, njeriu duhet t'i kryejë këto adhurime me një ndjenjë të pafund mirënjohjeje dhe falënderimi. Edhe pse Allahu Teala nuk ka nevojë për asgjë në mënyrë absolute, i ka nderuar robërit e Tij duke vendosur urdhra dhe ndalesa. Prandaj, duhet të jemi mirënjohës për këtë bekim të madh dhe t'i përmbushim dispozitat e Sheriatit me mirënjohje." (Letra e 73.të)

Feja Islame nuk i ndalon gjërat e mira dhe të dobishme vetëm për të lënduar njerëzit, siç mendojnë disa. Përkundrazi, gjërat e ndaluara janë gjëra të dëmshme si helmi i mbuluar me mjaltë. Ndalimet e vendosura ndaj njerëzve janë për të siguruar mekasidi sheriat (qëllimet e fesë), që është mbrojtja e jetës, pronës, intelektit, prejardhjes dhe nderit të njerëzve. Të jap një shembull, kur myslimani nuk gjen asgjë për të ngrënë, mund të konsumojë edhe alkoolin dhe mishin e derrit të ndaluar nga feja jonë, në një masë aq sa mos të vdesë, sepse nëse nuk mbrohet jeta, nuk mund të mbrohet as feja. Është ose nga injoranca ose nga qëllimet e këqija që disa njerëz të shitur shikojnë fetë e shtrembëruara që shtypin njerëzimin dhe e tregojnë Islamin si të barabartë me to.

Arsyeja e këtij keqkuptimi ka qenë teprimi i feve të tjera përveç Islamit në lidhje me natyrën njerëzore. Sepse klerikët e krishterimit, budizmit dhe të feve të tjera si këto, e kanë përcaktuar gabim natyrën e njeriut dhe në emër të përshpirtshmërisë, e bënë të paligjshme martesën dhe krijimin e familjes, punën dhe zotërimin e pronave, që janë nevojat më të natyrshme të njeriut. Besimtarët e feve të manipuluar, të cilët nuk mund t'i plotësonin nevojat e tyre të lindura në mënyrë të lejuar, shpejt u mbytën para vërshimit të nevojave të paplotësuara dhe kryen lloj-lloj haramesh, veçanërisht perversitete seksuale. Priftërinjtë e këtyre feve madje themeluan kisha të pavarura për të siguruar vazhdimin e marrëdhënieve të degraduara. Kështu, mëkatet individuale u bënë institucionale.

Asnjë nga këto kufizime, të cilat janë në kundërshtim me natyrën njerëzore, nuk kanë vend në Islam. Feja jonë e inkurajoi martesën, nuk e ndaloi fitimin nga hallalli me kushtin e dhënies së zekatit dhe gjithashtu e pranoi si një formë adhurimi plotësimin e të gjitha nevojave tona natyrore. Për këtë arsye, edhe nëse haramet kryhen individualisht, ato kurrë nuk janë kryer nën një çati institucionale si në kulturat e tjera, sepse nuk ka asnjë justifikim për t'i shtyrë njerëzit t'i kryejnë këto harame. Imam Rabbani e shpjegon në shembullin e jogëve, të cilët janë të njohur për asketizmin e tyre ekstrem, faktin

se praktikat dhe ndalesat fetare që janë në kundërshtim me natyrshmërinë e bëjnë njeriun të devijojë nga rruga e drejtë, siç vijon:

"Urtësia pas dërgimit të profetëve dhe përgjegjëse fetare është të dobësosh dhe disiplinosh këtë nefsu'l-emma. Përderisa pasohet Islami, dëshirat e nefsit thyhen. Për këtë arsye, kryerja e një urdhri të sheriatit ka një efekt më të fortë në shkatërrimin e dëshirave të nefsit sesa bindjet dhe përpjekjet mijëra vjeçare të bëra nga besimtari sipas mendjes së tij. Nëse këto bindje dhe adhurime nuk janë në përputhje me sheriatin, atëherë i shtojnë edhe më shumë dëshirat e nefsit. Priftërinjtë Brehmen dhe magjistarët të quajtur xhukija në Indi shkuan shumë larg në asketizëm dhe luftë me nefsin. Mirëpo, duke qenë se edukimi i tyre nuk është në përputhje me Sheriatin, kurrë nuk do të shohin dobi prej tij. Në fund, ata nuk do të kenë asgjë tjetër veçse një tërbim akoma më të madh të nefseve të tyre..."

Në fakt, Profeti (a.s.), i ndaloi gjërat që ishin në kundërshtim me natyrën njerëzore në mesin e shokëve të tij dhe i paralajmëroi tre nga shokët e tij, të cilët thanë se njëri do ta kalonte gjithë natën në namaz për të qenë më fetar, tjetri do të agjëronte gjithmonë dhe i treti se do të largohej nga gratë e nuk do të martohej, siç vijon: *«Betohem në Allahun se unë jam ai që i frikësohet dhe i druhet më shumë Allahut prej jush. Megjithatë, ndonjëherë agjëroj, ndonjëherë jo. Fal namaz nafile (në një pjesë të natës) dhe fle (në një pjesë të saj). Martohem edhe me gra. Kushdo që largohet nga Suneti im, ai nuk është prej meje.»* (Buhari, Nikah, 1.)

Në një ndodhi tjetër të ngjashme, Osman ibn Maz'uni kishte vendosur të hiqte dorë nga kjo botë. Aq shumë iu përkushtua agjërimit dhe namazit, saqë nuk mund ta shihte as gruan e tij Havlenë. Pamja e çrregullt dhe e pakënaqur e Havlesë tërhoqi vëmendjen e Profetit (a.s.). Kur e mësoi çështjen nga Aishja, e thirri Osmanin (r.a.), dhe e qortoi: *«A je larguar nga suneti im?»* Më pas i dha këto këshilla që e ftonin atë në një jetë të ekuilibruar: *«Unë edhe fle, edhe falem. Ndonjëherë agjëroj, ndonjëherë jo. Martohem edhe me gra. Frikësoju Allahut, o Osman! Dije se familja jote ka të drejtë mbi ty, mysafiri yt ka të drejtë mbi ty, trupi yt ka të drejtë mbi ty. Nganjëherë agjëro, nganjëherë jo, falu nga pak dhe fli nga pak!»* (Ibn Hanbel, VI, 267.)

Falënderimi i takon Zotit që kemi Pejgamber dhe fe me rregulla të përsosura në të gjitha çështjet. Allahu na e mundësoftë të bëjmë një jetë shpirtërore të ekuilibruar dhe të na ruajë të gjithëve nga dembelizmi dhe ekstremizmi. Amin!..

ISLAMI ËSHTË NËN AKUZËN PËR KRIM DHE URREJTJE



— Ergyn Jëlldërëm —

Marrëdhënia në lidhje me lirinë e mendimit dhe krimet e urrejtjes në Perëndim formohej rreth fesë, medhhebit, racës dhe kulturës deri më tani, kurse çështjet seksuale apo gjinore nuk përfshiheshin në krimet e urrejtjes. Megjithatë, ka pasur një zhvillim shumë të ndryshëm në tridhjetë vitet e fundit. Krimet e lirisë dhe urrejtjes tani përqendrohen kryesisht rreth homoseksualitetit. Homoseksualiteti konsiderohet një zgjedhje dhe orientim seksual. Kritika ndaj këtyre pranohet gjithashtu një krim urrejtjeje. Në fakt, mendimi perëndimor ka pasur gjithmonë një qëndrim shumë tolerant ndaj kritikës. Mendimi iluminist është një mendim kritik. Kritika është e rëndësishme edhe në mendimin modern. Por, shumë interesante, kritikimi i homoseksualizmit konsiderohet një krim urrejtjeje. Prandaj, askush nuk guxon të kritikojë homoseksualitetin. Ai (kritikuesi) përballet menjëherë me marginalizimin dhe përjashtimin. Ashtu siç stigma e kritikimit ndaj hebrenjve si «antisemitizëm» pas Holokaustit në Luftën e Dytë Botërore. Në të vërtetë, filozofi mysliman Garaudy u akuzua si antisemitik për shkrimin e një libri që kritikonte sionizmin.

Përtej lirisë së homoseksualizmit, ne po hasim në një despotizëm për ta mbështetur atë ose për të heshtur. Të gjithë pritet të miratojnë sjelljet homoseksuale në emër të lirisë. Ata që i kundërshtojnë, i kritikojnë dhe i refuzojnë, shtypen menjëherë. Po përjetohet tjetërsim dhe përjashtim.

Singerisht, jemi ballë për ballë me një despotizëm homoseksual. Për shkak të kësaj, në fakt, mendimi dhe kritika e lirë janë plotësisht të bllokuara. Po jepen përpjekje që të gjithë t'i nënshtrohen një qëndrimi pervers.

Ky despotizëm i homoseksualizmit mbështet shumë nga idetë e feminizmit dhe barazisë gjinore. Sigurisht që në plan të parë dalin edhe lobe të ndryshme dhe diskurse për të drejtat e njeriut. Një qëndrim imoral mbrohet si e drejtë nën emrin e të drejtave të njeriut. Duke shkuar përtej lirisë dhe të drejtave, ata që i kritikojnë ato stigmatizohen se kryejnë krime të urrejtjes dhe janë homofobikë (armiq të homoseksualizmit).

Në Kuranin Fisnik homoseksualiteti konsiderohet si veprim i ulët, kalim i cakut dhe devijim. Thuhet qartë se është imoralitet dhe devijim në sjellje. Allahu e dënoi popullin e Lutit për këtë sjellje të çoroditur. Ai e tregoi këtë si shembull për njerëzimin dhe ka thënë se njerëzit do të dënohen dhe shkatërrohen për shkak të këtyre perversitetëve. Prandaj, Allahu e dënon homoseksualitetin, e cilëson atë si heretik dhe e sheh si të pamoralshëm. Ky është botëkuptimi i Islamit. Ky botëkuptim tani shihet si një krim urrejtjeje nga homoseksualët. Këtë qasje e mbështesin edhe simpatizantët e tyre. Për këtë arsye, ata mendojnë se edhe Allahu, Zoti na faltë, po kryen një krim urrejtjeje. Kështu që e vendosin Zotin në ulësen e të akuzuarve! Kur i shikojnë ato që thotë Allahu

me besimet dhe qëndrimet e tyre të çoroditura, u duken si krim urrejtjeje. Sepse njerëzit e konsiderojnë të vërtetë atë që e besojnë dhe i shikojnë kështu edhe të tjerët që kanë përballë. Ata që besojnë në homoseksualizëm dhe jetojnë në këtë sjellje devijuese e shohin këtë si normale dhe liri për veten e tyre. Me këtë këndvështrim, guxojnë të gjykojnë Allahun. Ky nivel perversiteti i idesë perëndimore të lirisë akuzon fjalën dhe fenë tonë për krime të urrejtjes. Në vend që të përballen me çoroditjet e tyre, na thërrasin në myslimanëve që të përballemi me Allahun dhe Kuranin, Zoti na faltë. Gjithashtu duan që ne të dyshojmë në këto çështje.

Myslimanët e frymëzuar nga libri ynë që ua kujtojnë sjelljet devijuese dhe i paralajmërojnë njerëzit, i akuzojnë për kryerje të krimeve të urrejtjes dhe për homofobi. Në fakt, këto qarqe janë adhurues të vetvetes në perversitetin e tyre homoseksual. Sepse ata i shohin qëndrimet imorale dhe devijuese të tyre si absolutisht të sakta. Ata e marrin si masë epshin dhe devijimin e tyre. Çdo dëshirë atyre u duket normale. Ky është adhurimi ndaj dëshirës së egos. Është adhurim i nefsit ndaj nefsit. Kjo është arsyeja pse atyre u pëlqen ajo që bëjnë. Ata që i kundërshtojnë dhe i kritikojnë ata gjithashtu konsiderohen sikur kryejnë krime të urrejtjes dhe janë homofobikë.

Evropianët e kanë gjykuar gjithmonë Zotin e tyre. Ata edhe e kanë vrarë zotin e tyre në kohët moderne! Nietzsche (Niçe) këtë po thoshte ndërsa bërtiste: «Zoti ka vdekur.» Krishterimi e percepton kryqëzimin e Jezusit si vdekjen e një zoti, birit të zotit. Edhe ateizmi e ka vrarë Zotin, ndërsa deizmi e dëboi Atë nga jeta. Në fund të fundit, për perëndimin, e vërteta nuk është e pandryshueshme. Një mentalitet që gjykon, vret dhe ndryshon qenien hyjnore, që është e vërteta e së vërtetës, mund ta akuzojë lehtësisht Zotin për kryerjen e krimeve të urrejtjes. Kështu ai e deklaroi hyjninë e tij. Sepse adhuron seksualitetin. Atë e sheh si kriterin e duhur. Nefsi dhe dëshira kanë të drejtë të pafundme. Nuk njohin kufij. Ai (njeriu perëndimor) jeton në botën e seksualitetit për të hyjnizuar nefsin. Ne

po hasim një ndërgjegje që e ka humbur masën e së vërtetës. Kjo ndërgjegje e çoroditur pret që ne të ngrihemi dhe të bashkohemi me ta dhe ta shikojmë fenë tonë ashtu siç e shikon ajo. Edhe ne pothuajse na kërkohet të vrasim të vërtetën tonë. Pritet ta gjykojmë dhe ta ndryshojmë. Të presësh miratimin e homoseksualitetit nga myslimanët nuk është gjë tjetër veçse kjo.

Asnjë ndërgjegje nuk mund ta përcaktojë të vërtetën vetë. Lojërat e nefsit gjithmonë kërkojnë ta joshin njeriun. Instinktët, imagjinatat, stomaku, libidotë nuk mund të jenë të vërteta në vetvete. E vërteta nuk lind nga nefsi dhe dëshirat. Askush nuk mund ta gjykojë fjalën e Zotit me instinktët dhe libidotë e tij. Ky veprim është kallim i caktuar. Mendimi perëndimor është në një

gjendje të tillë. Të gjitha shoqëritë prodhojnë devijime të tilla kur ngrihen në kulmin e luksit dhe pompozitetit, në kulmin e dynjasë. Ibn Halduni e ka bërë këtë diagnostifikim në veprën e tij Mukaddime, të shkruar në shekullin e 14-të dhe thotë: Kur shoqëritë pasurohen, fokusohen te dëshirat dhe nefsi i tyre. Ata fillojnë të mos njohin kufij në këtë drejtim. Kështu lindin luksi dhe pompoziteti. Del në pah homoseksualiteti. Ja pra, kjo është ajo që shoqëritë perëndimore po përjetojnë sot. Ky devijim i vetes dhe i egos përhap imoralitet të madh. Në vend që të shohin dhe të përballen me devijimet e tyre, ata përpiqen t'i imponojnë të

gjithëve si të vërtetë dhe liri. Edhe ne na akuzojnë për krime të urrejtjes.

Para se të shkojnë më tej, myslimanët duhet të marrin masa paraprake kundër këtyre tendencave që shfaqen në shoqërinë e tyre, dhe veçanërisht ata duhet të rezistojnë kundër shikimit të këtyre mendimeve dhe kërtimeve si normale në shoqëri. Ata nuk duhet t'i lënë vend kontratave dhe teksteve që mund t'i justifikojnë këto qëndrime devijuese, siç është Konventa e Stambollit. Ata duhet të mbajnë distancën dhe të luftojnë kundër atyre që adhurojnë libidotë dhe instinktët e tyre. Në konsideratën e një myslimani, akuzat dhe mendimet e atyre që adhurojnë libidonë e tyre nuk kanë asnjë vlerë, pavarësisht se çfarë maskimi kanë dhe me çfarë bojë janë lyer...



NE DUHET TË MBETEMI ASHTU SIÇ NA KA KRIJUAR ALLAHU

— Ahmet Hamdi Jëlldërëm —


Falënderimet e pafundme qofshin për Allahun (xh.xh.), i Cili e krijoi njeriun në mënyrën më të bukur. Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të Nderuarin e botëve, i cili ishte më i përsosuri nga të gjitha krijesat në natyrë dhe formë, dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

Zoti ynë i Plotfuqishëm thotë: **“Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.”** (Tin, 4); **“...Është Allahu Ai që ju jep trajta/forma dhe i bën të bukura ato...”** (Gafir, 64). Këto ajete fisnike tregojnë se njeriu është krijuar në formën më të përsosur.

Pasi Allahu i jep në detaje fazat e krijimit të njeriut, thotë: **“...Allahu i Lartësuar është më i miri i krijuesve.”** (Mu'minun, 14) Çdo fazë e krijimit të njeriut është zhvilluar në formën më të përsosur dhe njeriu është bërë qenia më me vlerë e botës. Ndërhyrja në krijim, për çfarëdo arsye qoftë, do të shkatërrojë strukturën hyjnore. Në fakt, akti i ndryshimit të krijimit përmendet në Kuran si urdhri i djallit: **«...Unë do t'i urdhëroj ata dhe ata do ta ndryshojnë/prishin krijimin e Allahut...»** (Nisa, 119) Kështu shejtani, armiku i pamëshirshëm i njerëzimit, do të përpiqet të hakmerret për mallkimin e Allahut.

PRISHJA E KRIJIMIT

Çdo gjë përveç Allahut Teala është krijuar. Allahu (xh.xh.), është krijuesi i çdo gjëje. Krijimi i Allahut



është krijim nga asgjëja i bazuar në një urtësi/qëllim. Allahu i ka krijuar xhindët dhe njerëzit që ta adhurojnë Atë. (Shik. Dharijat, 56.) Nuk ka ndryshim në krijimin e Allahut. (Shik. Rum, 30.) Detyra e të gjithë njerëzve në tokë, nga i pari tek i fundit, është të adhurojnë Allahun. Nuk mund të ketë devijim nga adhurimi, i cili është qëllimi i krijimit tonë.

Shejtani është mallkuar për shkak të braktisjes së detyrës së bindjes dhe adhurimit, e cila është qëllimi i krijimit. Shejtani në fakt kundërshtonte përmbajtjen e detyrës, pra kundërshtonte t'i bënte sexhde Ademit, duke thënë se ishte më i mirë se ai. Për ta vërtetuar këtë, ai kërkoi lejen e Allahut dhe deklaroi se do të luftonte me qeniet njerëzore, të cilët i shihte si rivalë të tij, duke marrë mallkimin e Allahut mbi vete: **“Ata nuk adhurojnë tjetër veçse idhuj femërorë dhe nuk thërrasin tjetër përveç djallit kryengritës, të cilin e ka mallkuar Allahu, sepse (djalli) ka thënë: “Unë, doemos do të marr një pjesë të caktuar të robërve të Tu. Doemos do t'i shpie ata në rrugë të shtrembër, do t'i josh me shpresa të kota dhe, me siguri, do t'i urdhëroj që t'u presin veshët bagëtive, e pastaj do t'i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e Allahut. “Kush merr djallin për mbrojtës në vend të Allahut, ai ka pësuar humbje të qartë.”** (Nisa, 117, 118, 119)

Nga këto shprehje kuptohet se, ata që devijojnë nga qëllimi i krijimit, ata që nuk e pëlqejnë atë që ka bërë dhe urdhëruar Allahu dhe përpiqen ta prishin, do të jenë të mallkuar. Të jesh i mallkuar nga Allahu do të thotë të dëbohesh nga mëshira e Tij, të meritosh dënimin e Tij dhe të privohesh nga xheneti i Tij. Do të thotë të humbasësh suksesin. (shik. Tehanevi, Keshshafu istilahati'l-funun.)

Përveç Allahut, çdo gjë është krijuar dhe e sjellë në ekzistencë nga Allahu (xh.xh.). Allahun e madhëron çdo gjë që ka krijuar (Shik. Isra, 44.) Domethënë vepron në përputhje me qëllimin e krijimit të saj. Ai që e humb/braktis madhërimin e Allahut, do të thotë se ka braktisur qëllimin e krijimit dhe është mallkuar.

PRISHJA E NJERIUT

Ne jemi të urdhëruar të ndjekim natyrshmërinë në të cilën Allahu i krijoi qeniet njerëzore. Çdo veprim që është në kundërshtim me natyrshmërinë njerëzore është një ndërhyrje në krijim, një prishje dhe për rrjedhojë një mallkim. Masa në të gjitha llojet e ndërhyrjeve në trupin e njeriut me shqetësime estetike është nëse (ndërhyrja) është e përshtatshme apo jo për natyrshmërinë njerëzore, domethënë mesatarisht për një qenie njerëzore. Ndërsa ato që janë të përshtatshme për natyrshmërinë janë të pranueshme, ato që janë në kundërshtim me të janë të mallkuara. Për shembull, megjithëse është e përshtatshme për natyrshmërinë, ndërhyrja te vetullat dhe qerpikët, shtuarja e flokëve, hollimi i dhëmbëve, etj. janë veprime të mallkuara (Shik. Buhari, «Libas», 84; Muslim, «Libas», 120.) Mallkuar janë gratë që përpiqen të imitojnë burrat dhe burrat që përpiqen të imitojnë gratë. (Shik. Buhari, «Libas», 61.) Megjithatë, nëse ekziston një situatë në kundërshtim me natyrshmërinë, pra, nëse një njeri ka gjashtë gishtërinj në vend se të ketë pesë, lejohet heqja e tepërt me ndërhyrje kirurgjikale. Rekomandohet që gruaja të heqë mjekrën ose mustaqet që i rriten në fytyrë. (Hashijetu ibn Abidin, 6/373.) Prandaj, përderisa veprimet që duhen bërë me qëllim të trajtimit në trupin e njeriut konsiderohen të lejuara, veprimet që synojnë prishjen e krijimit/natyrshmërisë janë të mallkuara.

DEGRADIMI I MJEDISIT

Rregulli në marrëdhëniet e njeriut me krijesat e tjera është mbrojtja e natyrshmërisë së tij. Veprimet në kundërshtim me natyrën janë mallkuar. Keqpërdorimi i kafshëve që Allahu i ka dhënë në shërbimin tonë, torturat dhe mizoria ndaj kafshëve janë mallkuar (Shik. Nesai, «Dahaja», 8.)

Ne jemi përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit ku jetojmë, natyrën dhe universin. Është e ndaluar prerja në masë e pemëve (Shik. Ebu Davud, «Edeb», 159.) dhe dëmtimi i burimeve ujore. (Shik. Buhari, «Vudu», 68.)

Ata që përpiqen ta bëjnë tokën të pabanueshme janë të mallkuar. Kurani i përkufizon njerëzit që të djegin në shpirt kur flasin, por veprimet e të cilëve janë vetëm ligësi, si më poshtë: **“Kur vjen në krye të detyrës, rend për të bërë prishje në tokë dhe për të shkatërruar të korrat dhe brezat. Allahu nuk e do prishjen.”** (Bekare, 205) Këto dy cilësi janë dhënë si karakteri kryesor i hipokritëve: Shkatërrimi i prodhimeve bujqësore e shtazore dhe prishja e brezave.

NË MARRËDHËNIET TONA ME VETEN DHE BOTËN E JASHTME, JEMI TË DETYRUAR T'I PËRMBAHEMI NATYRSHMËRISË DHE TË RESPEKTOJMË KRIJIMIN E ALLAHUT. DEVIJIMI MË I VOGËL NË EKUILIBËR DO TË MJAFTOJË PËR TË SHKATËRRUAR TË TASHMEN DHE TË ARDHMEN TONË. NE DETYRIMISHT DUHET TË JEMI ORIGJINALË, NATYRALË, ORGANIKË, TË PANDRYSHUAR DHE TË PAPRISHUR, PRA, SIÇ NA KA KRIJUAR ALLAHU TEALA.



Aktivitetet gjenetike në bujqësi dhe blegtori janë konsideruar të kësaj natyre. Ndërsa inkurajohen aktivitetet për vazhdimin dhe përmirësimin e të korrave, ato që lidhen me sterilizimin dhe monopolin janë të ndaluara. Parimi më themelor në të gjitha këto veprime është mbrojtja e natyrshmërisë dhe mosdëmtimi.

Në këtë kontekst diskutohet edhe çështja e ushqimeve të modifikuara gjenetikisht. Ndërsa shkojmë përtej normave ekzistuese në natyrë, i gjithë njerëzimi vuan prej kësaj. Sepse ka një ekuilibër të mrekullueshëm në univers. Ndryshimet gjenetike në të korrat dëmtojnë trupin e njeriut dhe strukturën e kafshëve. Prandaj, është e ndaluar shmangia nga natyrshmëria.

PËRFUNDIMI

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).” (Rum, 41) Veprimet e njeriut e kanë bërë të gjithë tokën të pabanueshme.

Në marrëdhëniet tona me veten dhe botën e jashtme, jemi të detyruar t'i përmbahemi natyrshmërisë dhe të respektojmë krijimin e Allahut. Devijimi më i vogël në ekuilibër do të mjaftojë për të shkatërruar të tashmen dhe të ardhmen tonë. Ne detyrimisht duhet të jemi origjinalë, natyralë, organikë, të pandryshuar dhe të paprishur, pra, siç na ka krijuar Allahu Teala.

JETA ËSHTË TË NDJEKËSH ATË

— Abdullah Sert —

Allahu i Plotfuqishëm, me fuqinë dhe vullnetin e Tij të pafund, e formoi njeriun në formën më të bukur dhe e krijoi atë në mënyrën më të bukur, e bëri të aftë për të pranuar arsyen, idenë dhe fuqinë me një ekuilibër hyjnor, e bëri atë të dominojë mbi gjallesat e tjera dhe kështu e lartësoi në një nivel pjekurie që krijesat e tjera në këtë botë nuk mund ta arrijnë. (Shik. Infitar, 7-8.)

Njeriu, me këtë përsosmëri materiale/fizike, që shprehet si fitra, është përgjegjës për ta mbrojtur atë frymën hyjnore që i është dhënë atij trupit, domethënë është përgjegjës për të shkuar në audiencën e Zotit (xh.xh.), me shpirtin dhe trupin e pastër siç është krijuar duke e ruajtur për një jetë të tërë deklaratën «Ti je Zoti ynë» që e ka bërë në botën shpirtërore e cila shprehet si elest bezmi.

Një dhuratë tjetër i është dhënë njeriut për të ruajtur natyrën e tij dhe ajo janë profetët dhe programi hyjnor se si të jetojmë me masat hyjnore të shpallura atyre profetëve nga Vetë Allahu. **“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në**

rrugë krejt të gabuar.” (Al Imran, 164)

Ndërsa Zoti (xh.xh.), ua kujton besimtarëve këtë bekim të madh, na urdhëron që t'i përgjigjemi plotësisht të Dërguarit (shik. Nisa, 65), pra të dëgjojmë çdo ftesë të tij dhe ta ndjekim atë me nënshtrim dhe kënaqësi të plotë duke qenë të vetëdijshëm për këtë mirësi. Në një ajet tjetër thotë: **«O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!»** (Enfal, 8)

Elmallëllëu i ndjerë prek një pikë të bukur në interpretimin e këtij ajeti dhe thotë: “Ftesa është një. Ftesa e Allahut do të dëgjohej nga profeti i tij dhe ftesa e të Dërguarit nuk do të jetë gjë tjetër veçse ftesë e Allahut. Kurse shprehja ‘do t’ju japë jetë’, do të thotë dije ose vepër që do t’ju japë jetë, do t’ju nxjerrë nga gjendja e bimëve dhe e kafshëve, do t’ju çojë në një jetë të lirë dhe të lumtur për të cilën njerëzimi aspiron dhe do t’ju ngrejë në jetën e përjetshme me vullnetin tuaj. Profeti është dërguar për të ftuar në këtë dhe për këtë janë dhanë veshët, gjuha dhe mendja e njeriut. Dëgjoje menjëherë çdo ftesë/thirrje të Profetit dhe shndërroje atë “në jetë.” Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), të fton në dituri ose veprime



që do të të ngrenë në jetën e amshueshme, derisa të kesh mundësi, vrapo me dëshirë drejt urdhrit të tij pa e lënë pas dore atë. Sepse nuk do të tuboheni te dikush tjetër, por vetëm te Allahu dhe do të merrni shpërblimin sipas gradës së veprave tuaja.”

I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është padyshim një shembull unik në mbrojtjen e natyrshmërisë sonë shpirtërore dhe fizike ashtu siç dëshiron Allahu (xh.xh.). Resulullahu (a.s.), kur ka treguar rrugët e takimit hyjnor që hapen vetëm për njerëzit dhe që janë një horizont për qeniet njerëzore, ka vënë në pah edhe çështjet që duken të thjeshta në jetën tonë të përditshme, por që ulin cilësinë e jetës individuale dhe shoqërore kur neglizhohen. Kur tha: *“Mua më është bërë e dashur aroma e mirë”*, shprehu mirësjelljen, hijeshinë dhe dëlirësinë e trupit të njeriut. Në të njëjtën fjali, tha gjithashtu: *«Drita e syve të mi është namazi.»* Kështu tregoi parimet themelore të të qenët një besimtar i përsosur në harmoninë shpirtërore duke theksuar miraxhin (lartësimin) e shpirtit.

Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka një hadith fisnik në të cilin ka shprehur bazat e mirësisë në natyrshmërinë njerëzore:

“Aishja, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Dhjetë gjëra janë nga natyrshmëria:

1- Prerja e mustaqeve,

2- Rritja e mjekrës,

3- Përdorimi i misvakut,

4- Futja e ujit në hundë,

5- Prerja e thonjeve,

6- Pastrimi i pjesëve ndërmjet gishtave,

7- Pastrimi i sqetullave,

8- Pastrimi i zonës intime,


9- Marrja e taharetit,

10- Futja e ujit në gojë.»

Në këtë hadith fisnik shpjegohen dhjetë mirësi që janë nevojë e natyrshmërisë, domethënë e krijimit të njeriut. Fitrat / natyrshmëri do të thotë sunet, traditë apo zakon i profetëve dhe sunet të cilin të gjitha fetë dhe shariatet e miratojnë bashkërisht. Përmbajtja e natyrshmërisë, e cila mund të kuptohet si domosdoshmëri natyrore e të qenët i krijuar si qenie njerëzore, sigurisht që nuk kufizohet me këto.

Aspektet sociale dhe shëndetësore të secilës prej dhjetë bazave sigurisht që mund të shkruheshin gjerë e gjatë. Le të mjaftohemi me vetëm njërin prej tyre. Ndërsa përshkruhen masat për t’u mbrojtur nga një epidemi që përfshiu sot të gjithë botën, kujtimet në ekrane se si të lani duart, si të pastroni gojën dhe hundën, si të mbroheni nga mikrobet, sikur t’u mësohen fëmijëve të vegjël, a nuk tregojnë se sa ka nevojë në të vërtetë njerëzimi për udhëzimet profetike?

Nuk duhet harruar se me botëkuptimin “çdo gjë që bën i Dashuri është e mirë”, çdo këshillë dhe praktikë në lidhje me botën dhe ahiretin do të jetë shkak jetese për ne besimtarët dhe ndërmjetësim në botën e përtejme.



ÇFARË DO TË SJELLË 5G-JA?

— Jasin Tyrkjëllmaz —

PERSONI DO TË JETOJË NË NJË MJEDIS TË UDHËHEQUR KU NUK DO TË JETË NË GJENDJE TË KUPTOJË PSE KA NDRYSHUAR VULLNETI I TIJ. KY MJEDIS I RI, KU SJELLJET MUND TË NDRYSHOHEN ME TEKNOLOGJINË DHE NJERËZIT MUND TË MOTIVOHEN, NË AFAT TË GJATË DO TË ÇOJË NË NJË EPOKË TË RE NË TË CILËN NJERËZIT NUK DO TË JENË NË GJENDJE TË VËNË NË DYSHIM 5G-NË DHE TEKNOLOGJI TË NGJASHME.



Imagjinoni, keni hyrë në një mjedis, pas një ose dy minutash keni filluar të ndjeni se nervat tuaja janë të tensionuara dhe se po nervozoheni. Mirë, por sikur të mos ketë mundësi për të shpëtuar nga ky mjedis? Me fjalë të tjera, po sikur të mos ketë mbetur asnjë vend ku do të ishte e mundur të dilni nga mjedisi që ndikon në ndjenjat tuaja? Çfarë duam të themi? Ata duan të gjejnë një mënyrë për të dominuar sjelljen tonë dhe një nga faktorët kryesorë për ta arritur këtë do të jetë 5G-ja.

5G-ja është një term anglisht dhe do të thotë; “5th Generation”, pra “Gjenerata e 5-të”. Me fjalë të tjera, është rrjeti i teknologjisë celulare të gjeneratës së pestë. Teknologjitë 4G që kemi përdorur tashmë janë përfshirë në telefonat tanë si vazhdimësi e teknologjisë 3G. Me teknologjinë 4.5G, teorikisht u premtua shpejtësia e internetit 100 Mbps, por kjo shpejtësi nuk u arrit në praktikë. Teknologjia 5G duket se i kapërcen të gjitha teknologjitë celulare për nga shpejtësia. 5G-ja do të jetë në gjendje të ofrojë shpejtësi ndërmjet 1Gbps dhe 10Gbps. Megjithatë, premtimi më i madh i teknologjisë 5G, përtej shpejtësisë, është se ajo do të jetë në gjendje të lidhë me internetin jo vetëm pajisjet celulare, por edhe të gjitha objektet në jetën tonë, të gjalla apo të pajetë.

Rrjeti i teknologjisë celulare të gjeneratës së

pestë përdor frekuencë të lartë dhe gjerësi bande të lartë. Ndërkohë që 4G-ja ishte 10 herë më e shpejtë se 3G-ja, 5G-ja do të jetë rreth 1000 herë më e shpejtë se 4G-ja. Megjithatë, për një transferim kaq të lartë të të dhënave dhe shpejtësi të ulët latente, valët milimetroshe me gjatësi të shkurtër të stacioneve bazë 5G, të cilat nuk mund të arrijnë distanca shumë të gjata, duhet të vendosen më shpesh se 4G-ja dhe të mbështeten me antena përforcuese çdo 150 metra mesatarisht. Përveç kullave transmetuese të vendosura tashmë në zonat rurale dhe urbane, do të jetë e mundur të shihen antena përforcuese të vendosura në tabela rrugore, dritat e rrugëve dhe madje edhe kutitë postare, pasi nivelet e frekuencës do të duhet të rriten për rrjetet 5G.

5G-ja, e cila do të vijë në jetën tonë, do të na lejojë të qëndrojmë në komunikim të vazhdueshëm me frekuencat. Ndërsa bënin kërkime mbi ADN-në, shkencëtarët kuptuan se njeriu është tashmë një sistem që shkëmben informacione me frekuencat.


Në fakt, njeriu është një organizëm elektromagnetik dhe fushat tona elektromagnetike në trupin tonë kanë një ekuilibër harmonik. Truri ynë e transmeton dhe e përpunon informacionin në mënyrë elektrike. Struktura qelizore e trurit funksionon në formën e valëve elektrike dhe truri e përpunon informacionin në një brez të caktuar frekuencash. Në këtë aspekt, çdo mendim dhe çdo ndjenjë është një frekuencë. Pasi hyni në një mjedis plot me njerëz të zemëruar, nervozë dhe të stresuar, ju prekeni nga këto ndjenja për shkak të frekuencës së zemërimit dhe stresit në trurin tuaj. Njerëzit në përdorim të përditshëm e kanë quajtur këtë si energjia e mjedisit, atmosferë, ambient, etj.

Teknologjitë e internetit me valë (Wi-Fi) ose teknologjitë e të dhënave celulare prishin këtë ekuilibër, nga i cili varet tërësisht shëndeti ynë mendor dhe fizik. Kur këto frekuenca të rreza-

tuara dhe të ekspozuara prishin ekuilibrin tonë, që është një strukturë elektromagnetike, ndodhin disa sëmundje. Në këtë pikë, është një pyetje që duhet të bëjmë për sa i përket shëndetit tonë fizik dhe mendor, se sa na shërbejnë telefonat, kompjuterët apo shumë pajisje teknologjike, që në krye u është vendosur fjala «inteligjente», që janë bërë të domosdoshme për punën tonë të përditshme dhe që na kanë bërë të varur në njëfarë mënyre ndaj tyre.

Në këtë pikë, duhet të vëmë në dyshim edhe teknologjinë e re 5G. 5G-ja, përveç veçorive pozitive të saj, mund të thuhet se do të hyjë në jetën tonë me rreziqe apo kërcënime të mundshme. 5G-ja nuk ka nevojë për kulla të mëdha për të funksionuar.

Ajo mund të gjendet në çdo cep dhe në çdo rrugë. Kjo do të thotë se nuk do të jetë kurrë e mundur të hysh në një zonë pa 5G. Do të krijohet një fushë ndikimi elektro-



magnetike që ka aftësinë të ndryshojë plotësisht funksionimin e trurit të njeriut. Të ndikosh në funksionimin e trurit të njeriut nënkupton ndryshimin e realitetit të perceptuar. Personi do të jetojë në një mjedis të udhëhequr ku nuk do të jetë në gjendje të kuptojë pse ka ndryshuar vullneti i tij. Ky mjedis i ri, ku sjelljet mund të ndryshohen me teknologjinë dhe njerëzit mund të motivohen, në afat të gjatë do të çojë në një epokë të re në të cilën njerëzit nuk do të jenë në gjendje të vënë në dyshim 5G-në dhe teknologji të ngjashme. Ata që mendojnë se teknologjia na bën më të lumtur, më të qetë dhe më të shëndetshëm se më parë, mund të mirëpresin epokën e re që do të fillojë me 5G-në, sepse tani po hyjmë në një periudhë interesante ku kimia jonë shpirtërore dhe fizike mund të ndryshojë shumë më shpejt. Ne do të vazhdojmë të ndajmë karakteristikat e kësaj periudhe, të cilat i ndjekim me shqetësim dhe faktin se çfarë mund të sjellë ajo.

FEJA NUK ËSHTË SIPAS POROSISË

— Rexhep Ënxhel —

E drejta dhe e gabuara, e mira dhe e keqja janë shfaqur me ekzistencën e njerëzimit. Lufta mes këtyre ka filluar me armiqësinë e shejtanit ndaj Ademit (a.s.). Përgjatë historisë, luftërat e të gjithë profetëve dhe lufta e Profetit tonë të fundit me Ebu Xhehlin është e njëjtë. Të ngjashme janë edhe luftërat e të tjerëve. Lufta vazhdon edhe në ditët e sotme.

Veprimtaritë që u shfaqën në vendin tonë (Turqi), veçanërisht me Komitetin e Bashkimit dhe Përparimit, kundër administratës, të mbështetur nga armiqtë e fesë dhe të vendit brenda dhe jashtë vendit, vazhduan edhe në periudhën republikane. Aktivitetet anti-islame mund të shtjellohen në dy kategori në këtë mënyrë:

E para është armiqësia që lind për shkak të mungesës së diturisë, injorancës, properëndimorizimit dhe marrëzisë. Pretendimi këtu është se Islami e pengon përparimin dhe vlerat perëndimore janë më të përshtatshme për zhvillim. Ata që mendojnë kështu nuk veprojnë racionalisht e shkencërisht dhe e admirojnë e imitojnë verbërisht perëndimin si pasojë e robërimit dhe skllavërimit. Ata nuk e dinë se sa të vlefshme janë vlerat e Islamit dhe sa janë jetike për mbijetesën, përparimin dhe paqen e njerëzimit.

Kurse ata në kategorinë e dytë janë rezultat i një qasjeje krejtësisht të pabesë. Edhe pse e dinë se Islami është i madh dhe i vlefshëm, janë armiqësorë ndaj fesë në kuadrin e qasjeve imperialiste, politike dhe ideologjike. Ata ofrojnë ilaçe të gabuara për njerëzimin dhe përpiqen të përjashtojnë sistemin e mendimit islam, i cili është burimi i paqes dhe lumturisë së vërtetë.

Vini re, në Izrael nuk ka planifikim të popullsisë. Tradhtia bashkëshortore është krim. Mishi i derrit është i pangrënshëm. Imoralitetet nuk tolerohen. Por interesante është se veçanërisht në vendet myslimane themelohen shoqata për planifikimin e popullsisë. Formacionet imorale si alkooli, bixhozi, droga dhe tradhtia bashkëshortore tregohen si zgjedhje normale dhe të drejta demokratike përmes shtypit dhe mediave sociale. Shoqëritë vihen në gjumë për-

mes gjërave si moderniteti, demokracia, liria, etj. Zgjedhjet e gabuara dhe të paligjshme pothuajse i imponohen njerëzimit.

Grupet imorale që zënë axhendën e Turqisë së fundmi janë një pakicë shumë e vogël në shoqëri. Por me diskursat e shprehura prej tyre po kryhen operacione perceptimi dhe po tregohet sikur është e rëndësishme ajo që thonë. Njerëz dhe grupe të tilla bëjnë shumë zhurmë, sepse janë arrogantë. Sa i saktë është termi 'pakicë e tërbuar' për ta!

Shikoni zërat e kundërshtimit ndaj deklaratës së Kryetarit të Çështjeve Fetare se veprimet e paligjshme si tradhtia bashkëshortore dhe homoseksualiteti janë haram! Çfarë, a nuk do të deklarojë personi në autoritetin më të lartë të ngarkuar për çështjet fetare të Turqisë se ky është urdhri i Allahut? A nuk do ta tregojë hallallin dhe haramin? Çfarë mosrespektimi!

Ky veprim duhet të karakterizohet si pohim i një dijetari për vlerat fetare dhe vrazhdësi ndaj fesë sonë të lartë, Islamit. Për të njëjtat çështje, nëse një rabin ose prift flet, ata nuk mund të thonë për ta diçka të tillë si 'ne respektojmë besimet fetare'. Megjithatë, kur një hoxhë thotë diçka, ata menjëherë sulmojnë. Ja pra, ata janë kaq dyfytirësh.

Ata që përpiqen t'i përgjigjen Kryetarit të Çështjeve Fetare, në deklaratat e tyre, fyejnë Islamin nën maskën e demokracisë, të drejtës dhe ligjit. Në Turqi, jo vetëm shoqatat e avokatëve, por edhe disa organizata profesionale si dhomat e mjekësisë dhe dhomat e inxhinierëve angazhohen në diskurse ideologjike në vend të aktiviteteve profesionale. Administruesit anti gjërave të shenjta të grumbulluar këtu, nuk i respektojnë vlerat fetare dhe kombëtare kurdo që u jepet rasti. Kjo është e papranueshme!

Hz. Mevlana thotë: "Edepsëzi i vë zjarrin horizontit." Këta duan një fe që u mundëson të bëjnë çfarëdo që dëshirojnë. Mirëpo feja nuk është si pas porosisë, por sipas urdhrave dhe ndalesave të Allahut.



ÇFARË KËRKOHET NË RRUGËN SHPIRTËRORE?

— Sadik Dana —

Para së gjithash, prej atyre që aspirojnë rrugën shpirtërore kërkohet ndershmëri, përlësi, zemër e gjerë, mirësi, pajtueshmëri (me të gjithë), sinqeritet dhe istikamet (orientim i drejtë). Së dyti, kërkohet mund, sinqeritet dhe sakrificë. Shkurtimisht, aspirantët e marifetullahut mund të arrijnë kënaqësinë shpirtërore që kërkojnë vetëm përmes sufizmit. Për të përfutur, qëllimet duhet të jenë të sinqerta dhe përpjekjet duhet të jenë për hir të Allahut (xh.xh.).

Megjithatë, njeriu e arrin përsosmërinë në masën e sinqeritetit dhe përpjekjes së tij në rrugën e sufizmit. Atëherë ai mund t'i përmbushë rregullat e Kuranit siç duhet. Sepse nefs i tij vdes. Ai ekziston me të drejtën. Njohuritë e tij fetare janë të plota. Ai ka edukatë dhe turp. Përbrenda nuk mbart diçka të tillë si dyshimi, vesvesi apo mashtrim.

Ai nuk është i shkujdesur ngaqë gjithmonë e kujton Zotin (xh.xh.) dhe besimi, sinqeriteti e drejtimi i tij gjejnë forcë. Pavarësisht kësaj, namazet, lutjet, adhurimet dhe faljet e tij janë të shumta. Ai është bërë mik i Allahut, pasi te ai janë mbledhur të gjitha virtytet. Ky grup njerëzisht frikësohet jashtëzakonisht nga thyerja e moralit, sjelljeve dhe urdhrave të Kuranit qoftë edhe një grimë. Ata me kënaqësi i kryejnë edhe gjërat më të vogla me gëzim të madh. Ata janë praktikues të plotë të rrugës islame, sepse dinë të luftojnë me nefsin e tyre.

Është shumë e pakuptimtë dhe zhgënjyese të përdorësh fjalë të ekzagjeruara e të panevojshme në rrugën e udhëtimit shpirtëror siç bëjnë disa njerëz për shehlerët e tyre për shkak të dashurisë së tyre të tepruar. Sepse kjo rruga e së Vërtetës është shkolla e trajnimit dhe edukimit të njerëzve të së Vërtetës që kanë aftësi e që janë të pranuar. Kjo është rruga e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të dhe e shokëve të tij të nderuar. Në mënyrë të arsyeshme dhe të qëllimshme, tarikati urdhëron që të mos rrimë duarkryq anash, të mos u zgjasim duart të gjithëve dhe të mos jemi barrë për individët e shoqërinë, por të punojmë, të ndihmojmë dhe t'u shërbejmë individëve e komunitetit, jo siç është keqkuptuar nga të gjithë. Sepse pëlqimi i Allahut është në punë dhe në shërbim. Në fakt, shprehja «mos u bëj barrë, por ndihmës» përsëritet shpesh.

Kur aplikohet për përparim në rrugën e tarikatit, shehu i nderuar nuk e pranon menjëherë çdo aplikant.



Ai shikon moralin dhe pamjen e tij. Nëse e sheh se e ka njetin të pastër dhe ka aftësi për ta pranuar përshtatshmërinë, i jep leje, nëse nuk e sheh të denjë, e vonon. Qëllimi i tyre nuk është të mbledhin ata që u dalin rastësisht përpara, por të identifikojnë njerëzit e devotshëm dhe t'i bëjnë ata të përsosur.

Shehlerët e vërtetë të tarikatit janë gjithmonë të përluruar para Allahut të Madhëruar për shkak të respektit dhe konsideratës që njerëzit kanë ndaj tyre, pasi ata kanë një kuptim të thellë të madhështisë hyjnore. Sepse ata vetë as nuk i duan, as nuk i pëlqejnë veprimet e tilla.

Madje edhe Krenaria e Gjithësisë, Krijesa më e Ndeuruar, i Dashuri i Zotit, Hz. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i mësonte dhe i deklaronte ato që i thoshte Allahu i Madhëruar dhe nuk fliste për ato që nuk e informonte Ai.

Ngaqë murshidët e përsosur janë trashëgimtarë të profetëve, disave prej tyre u jepet fuqi e gjerë disponimi, kurse disa të tjerëve u jepet e kufizuar. Çdo gjë është me urdhër të Allahut të Madhëruar.

Shkurtimisht, nëse Zoti i Madhëruar nuk ia mundëson, robi nuk mund të bëjë asgjë, pavarësisht se në çfarë grade është. Ka shumë pak murshidë të përsosur në botë, madje jashtëzakonisht shumë pak. Autoriteti i tyre është në masën që u ka dhënë Allahu i Madhëruar. Kur një murshid viziton një të sëmure apo kur lutet për shërimin e një të sëmuri, ky i fundit nuk duhet të presë një shërim qind për qind. Vetëm Allahu është i gjithëfuqishëm. Çdo gjë që kërkohet, duhet të kërkohet nga Allahu. (Sadik Dana, Sufizmi dhe Marifetullahu, fq. 24. Botimet Erkam.)

TË DASHURUAR PAS XHENETIT

— Altin Torba —

PËRKUFIZIMI I XHENETIT

Xheneti është streha dhe vendbanimi i atyre që adhurojnë vetëm Allahun dhe nuk i shoqërojnë Atij asgjë dhe askënd; që kanë frikë vetëm Allahun dhe që i luten drejtpërsëdrejti vetëm Atij, sepse e dinë se Allahu i Plotfuqishëm që është Zotëruesi i cilësive të përsosura dhe absolute nuk ka nevojë për ndërmjetësues dhe as për ortak apo ndihmues.

Është vendbanimi i atyre që e besuan Kuranin, fjalën e Allahut dhe e besuan Muhamedin (a.s.), të Dërguarin e Allahut, e përqaftuan Islamin, bindjen e vetme të pranueshme tek Allahu dhe duke iu nënshtruar Allahut me zemrën, gjuhën dhe gjymtyrët e tyre shpresuan në Xhenetin, shpërblimin kulmor të Allahut, Zotit të tyre.

Është vendqëndrimi i besimtarëve të vërtetë dhe të devotshëm, që zbatojnë urdhrat e Allahut dhe të Profetit të Tij, si dhe qëndrojnë larg ndalesave që ua ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Është vendshpërblimi i robërve dhe adhuruesve të pastër dhe të singertë të Allahut.

Është streha e prehjes dhe e drejtësisë për ata që, duke qenë se kanë frikë drejtësinë e Allahut, u binden urdhrave dhe kushtetutës së drejtë hyjnore të Allahut.

Është streha e denjë e shpërblimit për besnikët që iu betuan dhe ia dhanë besën Allahut, në rrugën e Tij dhe për të fituar kënaqësinë e Tij.

Është shpërblimi i garantuar për ata që sakrifikuan me pasurinë, jetën e tyre dhe gjithçka patën, që fjala Allah të zinte vendin e vet të merituar në botën e njerëzve, ashtu siç e ka zënë në mbarë universin.

Është vendprehja e atyre që pendohen dhe kthehen singërisht te Zoti i tyre pas gabimit.

Është vendshpërblimi për ata që me zemrat, gjuhët dhe veprat e tyre e falënderojnë Allahun e Lartësuar për mirësitë e panumërta, të cilat ia dedikojnë vetëm mëshirës së pakufi të Allahut, Zotit të tyre.

Është shpërblimi që iu premtua atyre që ballin e tyre fisnik dhe të ndershëm e përlulën në tokë duke madhëruar vetëm Allahun.

Është vendi për të cilin punuan dhe u shpërblyen ata që urdhëruan në të mirë dhe ndaluan nga e keqja.

Allahu i Lartësuar flet në mënyrë të hollësishtme në librin e Tij, në Kuranin Fisnik për Xhenetin, lumturinë në të, lumenjtë e tij, kopshtet dhe pemët plot fruta, ushqimin e tij, pijet, veshjet, banesat e mrekullueshme, stolitë e tij, vashat e tij dhe përmend se lumturia e banorëve të Xhenetit as që mund të gjejë një shkallë sado të vogël krahasimi me lumturinë e më të pasurve dhe më të lumturve të kësaj bote.

Në lidhje me ligjësitë e mrekullueshme me të cilat Allahu i Lartësuar e ka pajisur Xhenetin, për të kënaqur dhe lumturuar në të robërit e Tij të singertë, ashtu siç i ka hije Krijuesit të Drejtë dhe të Plotfuqishëm, në lidhje me këtë Kurani, fjala e Allahut të Lartësuar, thotë:

“Askush nuk di (nuk imagjinoi dot) për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që u është përgatitur atyre (banorëve të Xhenetit) në shpërblim të asaj çka ata punuan (në dynja).” (Sexhde,17)

Ndërsa i Dërguari i Allahut, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, transmeton se Allahu i Lartësuar në një thënie të shenjtë thotë:

“Kam përgatitur (në Xhenet) për robërit e Mi të singertë çka syri nuk e ka parë, as veshi s’e ka dëgjuar dhe as zemra s’e ka ndjerë (imagjinuar dhe përjetuar prej mrekullive, bukurive, fjalëve dhe emocioneve të pashlyeshme)”. (Transmetim i Bushariut dhe Muslimit)

Të nderuarit e mi!

Njohja e përkufizimit të diçkaje është shumë e rëndësishme, pasi sa më shumë njohje të kemi për diçka, aq më tepër do të qartësohet ideja dhe vlerësimi për të...

E pra:

Le të përpiqemi ta njohim sa më mirë Xhenetin dhe të eksplorojmë sa më shumë rreth tij... të mendojmë sa më shumë për të dhe të jemi sa më në kontakt me informacionin e besueshëm që hedh dritë rreth çdo detaji lidhur me të... me qëllim që zemra jonë të lidhet sa më ngushtë me të, të ideojë dhe projektojë për të... dhe për të argumentuar dhe konkretizuar me vepra, aspiratën tonë që një ditë të jemi prej banorëve të tij...

TRYEZA PARAJSCORE

Profeti Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, nëpërmjet ëndrrës profetike përcjell se është gjendur në mesin e një grupi engjëjsh, ndër

të cilët Xhebrailin që i rrinte nga ana e kokës dhe Mikailin nga këmbët dhe njëri prej këtyre të dyve i ka thënë tjetrit: “Jepi atij një shembull!” Me këtë rast i është thënë:

“Shembulli yt dhe shembulli i kombit tënd është si shembulli i një mbreti që ka bërë të tijën një qendër, ku ka ndërtuar një rezidencë dhe në të ka shtruar një tryezë; ka nisur tek njerëzit edhe një lajmës. Pati prej njerëzve që e pranuan ftesën, e pati që e lanë atë. Sa për mbretin, ai është Allahu; qendra është Islami; rezidenca është Parajsa ndërsa ti je Lajmësi. Kush të bindet ty, ka hyrë në Islam; kush hyn në Islam, hyn në Parajsë dhe kush hyn në Parajsë, ha nga çfarë ka në të... Kush i bindet Muhamedit, i është bindur Allahut dhe kush i kundërvihet Muhamedit i është kundërvënë Allahut... Kush të pason ty, hyn në Parajsë dhe kush nuk të pason ndëshkohet me një ndëshkim të rreptë...”

Të nderuar vëllezër dhe motra! Siç u pa qartë nga Zbulesa Hyjnore në fjalë, dynjaja është lënë jashtë suazave të këtij aforizmi dhe kjo, sepse njeriu nuk u krijua për dynjanë, por siç janë shprehur të parët tanë të singertë:

Dynjaja u krijua për njeriun, teksa njeriu u krijua për Amëshimin.

PRIORITETI SUPERIOR

Njeriu i mençur i vendos prioritetet e tij duke pasur parasysh realitetet dhe vlerat reale të synuara...

Kështu, njeriu midis dy punëve që i ofrohen, patjetër që zgjedh atë më të vlerësuarën dhe më të shpërblyerën, edhe nëse ajo do kërkojë mund më të madh; aq më tepër kur bëhet fjalë për realitete që janë vërtet në disproporcion dhe disvlerësim të pakrahasueshëm...

Prioriteti për të cilin po duam të bëjmë fjalë është ai **“dynja-amëshim”**;

dhe për të hedhur dritë mbi të, vëllezër dhe motra, le të reflektojmë së bashku.

REALITETI DHE VLERA E DYNJASË KARSHI XHENETIT:

Ky realitet vlerash na zbulohet nga më Eminentit dhe më i Predispozuari për të folur mbi një gjë të tillë, nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, që pikërisht lidhur me këtë fakt thotë:

“Sillet në ditën e gjykimit njeriu që ka pasur më shumë mirësi në dynja e që është nga banorët e Zjarrit (të Xhehenemit). Zhytet tej e tej në

Zjarr. Pastaj i thuhet: ‘O biri i Ademit! A ke parë ndonjëherë mirë? A të ka ndodhur ndonjë mirësi ndonjëherë prej herësh?’ Thotë: ‘Jo betohem për Allahun (betohem në Ty) o Zoti im.’

Dhe sillet njeriu që ka pasur më shumë vuajtje, (mundime apo dhimbje) në dynja e që është nga banorët e Xhenetit. E futet tej e tej në Xhenet. E i thuhet: ‘O biri i Ademit! A ke parë ndonjë herë vuajtje, (mundime apo dhimbje)? A të ka ndodhur ndonjë fatkeqësi a vështirësi ndonjë herë prej herësh?’ Thotë: ‘Jo betohem për Allahun (betohem në Ty) o Zoti im. Nuk më kanë ndodhur vuajtje (mundime apo dhimbje) kurrë, dhe kurrë nuk kam parë fatkeqësi a vështirësi.’ (Transmetim i imam Muslimit)

Ky është Prioriteti Superior që na fton të mendojmë më thellë...

Një moment, vetëm një moment, dhe mirësitë më të mëdha të dynjasë apo të këqijat më të skajshme të saj harrohen, për t’u lënë vendin atyre të Amëshimit...

RRUGËTIMI PËR NË PARAJSË

Të nderuarit e mi!

Të gjithë e dimë se që të duash diçka, nuk mjafton për ta arritur atë.

Për të arritur në destinacion, duhet zbatuar pikë për pikë udhëzimi i të Dërguarit...

Askush nuk është më kompetent se kurora e profetëve, Profeti Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, për të na orientuar dhe treguar lidhur me Itinerarin madhështor që ka për destinacion Parajsën e Begatë...

Pikërisht mbi **Itinerarin për në Parajsë** Muadh ibn Xhebel e pyet Profetin Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, duke i thënë:

- O i Dërguar i Allahut! Tregomë për një punë që më fut në Xhenet dhe më largon nga Zjarri?!

I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, iu përgjigj:

“Ke ardhur të pyesësh për një çështje madhore, porse që është vërtet e lehtë për kë ia lehtëson Allahu i Lartësuar.”

Profeti (Paqja qoftë mbi të!) vijoi: *“Përgjigjja për pyetjen tënde është: Ta adhurosh Allahun duke mos i bërë shok, ta kryesh Namazin, ta japësh Zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe ta bësh Haxhin në Qabe.”*

Profeti (Paqja qoftë mbi të!), vijoi: *“A do që të të orientoj për dyert e mirësisë?! Agjërimi (vullnetar)*

është mburojë; lëmosha e shuan mëkatin ashtu si uji zjarrin; është edhe namazi i natës, - pastaj lexoi fjalën e Allahut të Madhëruar: “Trupat e tyre i ngrenë nga shtratet (për t’u falur gjatë natës), duke e lutur Zotin e tyre me frikë dhe shpresë e nga ajo (pasuria) që Ne u kemi dhënë, ata japin. Askush nuk di për kënaqësinë pamore (që mrekullon zemrën dhe shpirtin) e cila u është surprizuar atyre si shpërblim për atë që punuan.” (Sexhde, 16-17)

Profeti (Paqja qoftë mbi të!), vijoi: *“A do të të tregoj mbi kreun e çështjes, themelin e saj dhe kulmin e ngrehinës së saj?!”*

I thashë: “Si jo, o i Dërguari i Allahut!”

Tha: *“Kreu i çështjes është Islami, themeli i saj është namazi dhe kulmi i ngrehinës së saj është Xhihadi”.*

Profeti (Paqja qoftë mbi të!), vijoi: *“A do të të tregoj se si arrihet e gjithë kjo?!”*

I thashë: “Si jo, o i Dërguari i Allahut!”

Kapi gjuhën e tij dhe tha: *“Përmbaje këtë!”*

I thashë: “O i Dërguari i Allahut, a do na merret për bazë ajo çfarë flasim?”

Tha: *“Mjerë për nënën tënde kur të jetë në zi për ty! A ka për t’i përmbysur njerëzit në zjarr mbi fytyrat e mbi hundët e tyre gjë tjetër veç të vjelave të gjuhëve të tyre.”* Transmeton Tirmidhiu (Hadith i saktë, *hasen sahih*)

Itinerari për Parajsë është i qartë.

Rruga fillon me obligimet: adhurimi i kulluar e i distancuar nga çdo trajtë mikro dhe makro shokbërje Allahut, falje e përqendruar, pasuri e pastruar me zekat, agjërim i përkushtuar, Qabja duhet vizituar jo vetëm nga trupi, por ç’është më e rëndësishme nga shpirti yt.

dhe vijon me: korsitë e mirësive, që të fusin në radhët e adhuresve vullnetarë, që jo vetëm agjërojnë Ramazanin, jo vetëm nga Zekati japin lëmoshë, por edhe që kur të tjerët flenë, ata Allahun e Madhëruar e kujtojnë me lot në sy e për mirësitë e tij nuk pushojnë së falënderuari e dëlirësuar Atë.

Kreu i këtij Itinerari mban emrin Islam, themeli i tij është namazi dhe kulmi i ngrehinës dhe finishit të tij është sakrifikimi i jetës në rrugë të Allahut.

Nga shenjat e të suksesshmit në këtë Itinerar është se ai e ka gjuhën e tij totalisht nën kontroll, pasi e di se fshehtësitë që gjenden thellë në zemër gjuha i reflekton.

Ky ishte Itinerari i Rrugëtimi për në Parajsë....

E lusim Allahun të jemi prej atyre që do e arrijmë Finishin e tij me sukses...

A KA DERMAN PËR HALLIN E KËRKIMIT

— Idris Arpat —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Andaj, ti (o Muhamed) largohu prej atij, që i kthen kurrizin Kuranit dhe që dëshiron vetëm jetën e kësaj bote! Kaq arrin gjithë dija e tyre! Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij dhe ata që ndjekin rrugën e drejtë.” (Nexhm, 29-30.)

Nëse njeriu arrin mënyrën e jetës së përshtatshme me qëllimin e krijimit, të paktën, nëse e ka një mall të tillë, lumturia e kësaj bote dhe e botës tjetër do t’i vijë vetvetiu. Njeriu e ka kusht që të mos bëjë gabim në zgjedhje dhe të arrijë një mënyrë jetese të pavarur. Kjo nuk është një punë e lehtë dhe realizohet shkallë-shkallë. Në fillim duhet një kokë që ka aftësinë hetuese dhe dalluese.

Kur oficeri i ra me pëllëmbë një ushtari që e prishi rreshtin, Tolstoi iu nxeh kolegut të tij dhe i tha:

“A nuk ke turp? A trajtohet kështu njeriu? A nuk e ke lexuar Biblën?” Ai iu përgjigj:

“Mua nuk më intereson Bibla, por rregullorja e ushtrisë.”¹

Kjo sjellje është plotësisht një nënshttrim, që do të thotë se jam gati të bëj çfarëdo që urdhëron sistemi në funksion. Një njeri që frenon mendjen dhe e bën ndërgjegjen të heshtë, është robotizuar. Ai tashmë është një lodër, një armë dhe një terminator

i pashpirt në duart e autoriteteve. Një njeri që nuk e heton atë që bën dhe përjeton, nuk dyshon nga përpikëria e jetës dhe kështu robotizohet. Kjo është ajo gjë që duan më shumë ata që kanë dëshirë të të përdorin. Le të bëjë pa hezituar çdo gjë që i urdhërohet dhe ta ndjejë kënaqësinë e kryerjes së detyrës.

Kureshtja që ia hap derën njeriut për te vetëdijësimi dhe sjelljet njerëzore, vazhdimisht i shqetëson ata që duan t’i përdorin njerëzit si skllëvër.

“Jeta e të pasurve, zengjinëve dhe e të kulturuarve tanë, tashmë, jo vetëm që më dukej e pështirë, por mbi të gjitha nuk kishte asnjë lloj kuptimi për mua. Të gjitha sjelljet, mendimet, shkencat, artet dhe çdo gjë për mua fituan një kuptim të ri. E kuptova se të gjitha këto nuk janë gjë tjetër përveçse lodra. Nga këto nuk mund të gjendet ndonjë kuptim. Ndërsa vlera e vërtetë e jetës së popullit që punon, ishte përpara meje. E kuptova se jeta ishte vetë kjo. Kuptimi që mund t’i jepet kësaj jete është e vërteta. Kështu që e pranova atë.”²

Çfarë gjeti Tolstoi në jetën e popullit që punonte? A ishte e vërteta ajo që gjeti? Këtë nuk e dimë. Ajo që dimë ne, është kjo:

Tolstoi kishte parë se jeta që jetonin njerëzit

1. Xhemil Meriç, *Magaradakiler*, fq. 374, *Botimet Ötüken*.

2. Tolstoi, *Pohimet e mia*, fq. 63, *botimet Kum Saati*.



që e rrethonin, nuk ishte jeta e drejtë. Gjërat që ndodhnin, nuk ia pranonte ndërgjegjja. Në këtë mënyrë, e kuptoi se nuk është kjo jeta që duhet të jetohet dhe filloi të kërkojë rrugët e shpëtimit nga kjo jetë. Kjo ndjeshmëri e tij është e pamundur të mos vlerësohet. Kjo ndjesi mund ta mbartë njeriun drejt një jete profetike, sepse një ndërgjegje që bërtet kur jeton këto gabime, nuk e pranon një jetë të pafrytshme, të parëndësishme dhe të shuar. Atëherë, çfarë do të bëjë? Do të bëjë këtë pyetje:

“Me cilën lloj jetese është më i kënaqur Allahu?” Jeta do të vazhdojë. Ndoshta rehatia jo, por kjo është rruga e arritjes së qetësisë.

“Njeriu është një krijesë kërkuese. Dikush kërkon të bukurën dhe dikush kërkon të shëmtuarën. Dikush kërkon imoralitetin me nefsën dhe dikush kërkon virtytin me besimin e shpirtin. Struktura e njeriut është e predispozuar për të kërkuar. Edhe baza në themelin e kësaj strukture është shpirti, që Allahu Teala thotë në Kuran:

“I fryva prej shpirtit Tim...” (Hixhr, 29; es-Sad, 72.)

Ky shpirt është i predispozuar për të kërkuar të vërtetën. Ai kërkon tërësinë që i përket.”³

Njeriu që kërkon virtytin me besimin dhe shpirtin e tij, duhet respektuar. Ose më saktë, ne ia kemi borxh adhurimin Allahut Teala, i cili e ka programuar natyrshmërinë tonë për të kërkuar.

“Tregtari i kishte përgatitur një jetë shumë luksoze princeshës me të cilën ishte martuar, por princesha nuk ishte bërë e lumtur, sepse ajo vinte nga një familje mbretërore.

Edhe shpirti kështu është. Sido që të jenë mundësitë, atë gjithmonë do ta marrë malli për origjinën e vet.”⁴

Përderisa gjendja është kështu, do të thotë se nuk ka derman për hallin e mallëngjimit dhe kërkimit. Kjo do të thotë se njeriu do ta përjetojë pikëllimin e mosgjetjes., por kjo do ta bëjë atë të lëviz vazhdimisht. Le të realizojë çfarë të dojë, le

të arrijë çfarëdo grade që të synojë, prapëseprapë do të ndjejë se diçka ka ngelur mangut. Kjo do të vazhdojë derisa të arrijë te Allahu i Madhëruar. Njeriu ka një natyrshmëri, që qetësohet vetëm me Allahun (xh.xh.). Asgjë tjetër s’do ta ndalojë atë së kërkuari.

Edhe ky pohim është i Tolstoit:

“U përpëlita edhe një herë ndërmjet jetës dhe vdekjes. Atyrë që i kisha brenda fillova t’u hedh edhe një sy. Befasisht e kuptova se jetoja vetëm në kohën kur besoja bindshëm Zotin. Madje, duke menduar Atë, gufoheshin dallgët e jetës. Çdo gjë përreth meje ndriçohej dhe fitonte një kuptim. Ndërsa, kur e harroja dhe largohesha nga Ai, më shkëputej lidhja që kisha me jetën dhe jeta ndalonte. Një zë nga brenda më tha:

‘Atëherë, çfarë po kërkon tjetër? Që nga ajo ditë, kjo dritë nuk më la më.”⁵

“Në këtë botë ka shumë fatkeqësi. Si mund të rezistojmë kundrejt të gjithave? Çfarë lloj shoku apo çfarë lloj rruge të gjejmë, që ta jetojmë jetën pa frikë? Ku duhet të drejtohem? Ka vetëm një përgjigje, ka vetëm një mik të vërtetë. Ai është Zoti.

Nëse e mbani në zemër Zotin në çdo vend, do të jeni larg fatkeqësive. Si t’ia dalim mbanë me këtë? Duke i kuptuar dhe zbatuar ligjet e Zotit.”⁶

Ja, kjo është mënyra e duhur për kërkimin. Shkallë-shkallë arrihet te Miku i vërtetë dhe duke kuptuar ligjet e Tij jepet vendimi për të bërë një jetë në përputhje me to. Ky është besim ndaj Allahut dhe nënshtrim ndaj Tij. Kjo është formula e shndërrimit të dynjasë dhe botës tjetër në xhenet.

Le t’ia vëmë veshim kësaj lutjeje:

“O Zot! Nëse jam fajtor, më fal! M’i dërgo përsëri gjërat që më pëlqejnë ose më mëso si të jetoj dhe çfarë të bëj këtej e tutje.”⁷

Si do na mësojë?

Allahu i Madhëruar do na mësojë si të jetojmë nëpërmjet mesazheve nga Kurani dhe krijesat.

3. Mustafa Islamogllu, *Sëjleshiler*, fq. 103, Tetor 1993, Stamboll.

4. Ditari i Tolstoit, fq. 56.

5. Ali Ural, *Gazeta Zaman*, 23.07.2006.

6. Nga Epikteti, fq. 74.

7. Lev Tolstoi, *Lumturia Familjare*, fq. 116.

Përderisa atributi “Kelam” vazhdon, do të thotë se vazhdon edhe të folurit e Allahut Teala. Kjo do të thotë:

“Fjala e Kuranit zbret një herë, ndërsa kuptimi i saj zbret njëmijë herë.” Nëse robi është kthyer nga Allahu dhe pyet: “O Zot! Çfarë jete dëshiron që të bëj?” – kjo pyetje nuk do të ngelet pa përgjigje. Allahu i Lartësuar do të krijojë shkaqe për atë që dëshiron udhëzimin dhe do ta kapë për dore “njeriun e kërkimit”.

Në një gazete lexova këtë reportazh të bërë me Latife Tekin:

Latife Tekin:

“Nëse mund të harrojmë çdo gjë derisa të mos ngelë gjë për t’u harruar, do të takohemi me Zotin, por ne nuk ia dalim mbanë që të harrojmë deri atje.”

Nuriye Akman:

“Më pëlqeu shumë ky mendim. Unë këtë e kuptova kështu: Vetëm Zoti është gjëja e vetme që ia vlen të kujtohet.”

Latife Tekin:

“Befasisht ndjeva se kjo botë ishte shndërruar në një tablo. Ndërsa unë isha e vetmuar përballë saj. Dëshira për ta dërguar në pafundësi atë gjënë që e patëm bërë duke shkruar, ndoshta ishte përpjekja për ta shëruar këtë vetmi.”

“Unë them se njeriu nuk mund ta bëjë të lumtur njeriun. Sepse, në të vërtetë, as ai nuk e ka atë lumturi të përhershme. Ka vetëm një iluzion të përkohshëm. Njeriu nuk mund t’ia japë njeriut atë gjë të përhershme, lumturinë. Ka dashuri, por kjo nuk është diçka që vjen nga njeriu përballë.”

(Le të supozojmë se Allahu i flet njeriut kështu)

“Nëse ma kthen shpinën Mua, nuk do gjesh dikë tjetër që të ta mbushë vendim Tim. Mos pandeh se do të këshillohesh me dikë tjetër përveç Meje. Askush nuk mund të të bëjë të mos kesh nevojë për Mua.”⁸

“Ah sikur të të ishin verbuar sytë kur të ngelën në bukuritë e të tjerëve! Sa shumë u vulgarizove duke qëndruar gati në dyert e diku tjetër përveç Allahut. Ata të kanë poshtëruar dhe nënçmuar, ndërsa ti akoma nuk mendon të kthehesh te Zoti.”⁹

Kësaj i thonë të kërkosh ngushëllimin në vende që s’ka qetësi dhe lumturi. Njeriu nuk mund t’i shtojë diçka në kuptimin pozitiv botës shpirtërore të diku tjetër. Përkundrazi, njeriu e shfrytëzon njeriun, i hap plagë shpirtërore dhe e përdor si skllav. Si duhet t’ua shpjegojmë këtë të vërtetë vëllezërve tanë që janë mbytur në “detin e njerëzve”? Miku ynë i vetëm është Allahu i Lartësuar. Ai gjithmonë sillet miqësisht me ne. Fuqia e Tij është e pafundme. Ai ka dijeni për çdo gjendje tonën. Të drejtohesh nga xixëllonja, ndërkohë që është dielli, është një konsumim i plotë i njeriut.

“Një njeri që largohet nga Zoti i Madhëruar dhe nuk e kërkon Atë, me të vërtetë e ka të pamundur ta gjejë hakikatin dhe lumturinë.”¹⁰

Nëse nuk do të shkosh te Allahu, xhelle xhelaluh, do të shkosh nëpër mejhane dhe tek të droguarit. Atëherë, do të përmallohesh për një buzëqeshje dhe një gjumë të thellë. Edhe pse e di se do konsumohesh, po vrapon drejt konsumimit. “Ose do të falësh namaz, ose do përdorësh drogë.” Rrugë të tretë nuk ka miku im.

Le të pranojmë se, “rregulli më i rëndësishëm i jetës sonë është kënaqësia e Allahut të Madhëruar.” Nisur nga ky aspekt, vazhdimisht duhet t’i drejtohemi Allahut Teala. Nëse ne e harrojmë Allahun (xh.xh.) edhe Ai do na lërë në harresë ne. Në këtë mënyrë, poshtërohemi me vështirësitë e kësaj bote.

Dynjaja që kërkojmë, është një botë ku përqafohet dashuria me mendjen. Nuk mund ta neglizhojmë as lartësimin dhe as ngritjen. Në këtë dynja të vdekshme, jetojmë me trupin dhe shpirtin tonë.

Në një botë të drejtë dhe normale, duhet të gjejmë me qetësi një rrugë për t’u bërë kërkues i kënaqësisë së Allahut Teala.

9. A.G.E. fq. 41.

10. Nga Pascali, M. A. Shengyl, *Malli për Pranverën*, fq. 90, Qershor – 2002.

8. Ataullah Iskenderi, *Taxhu'l-Arus*, fq. 123, Përkth. Osman Arpaçukuru, *Botimi i parë, Botimet Yskydar*.



FJALA, PASQYRË E SHPIRTIT

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Fjala është mjeti kryesor i komunikimit njerëzor. Njeriu i shpreh ndjenjat dhe mendimet ndaj të tjerëve përmes fjalës. Prandaj fjala zë një vend të rëndësishëm në historinë e njerëzimit.

Në komunikimin verbal ekzistojnë tre elementë: dhënësi, mesazhi dhe marrësi. Mesazhi, pra fjala, merr vlerë si nga aftësia e dhënësit për ta përcjellë qartë, por edhe nga aftësia e marrësit për ta kuptuar saktë. Lutja e Musait (a.s.), drejtuar Allahut për t'i dhënë fuqi shprehëse dhe Harunin si ndihmës për këtë është shumë domethënëse.

Për të shprehur diçka, për të treguar një ngjarje, për të trajtuar një problem dhe për të hedhur një teori, së pari personi mbështetet te fjala, pastaj kërkon një person që t'i kuptojë ato. Sepse vlerën e fjalës e rrit personi që e kupton saktë dhe drejt atë. Prandaj, të gjithë pejgamberët dhe mendimtarët, krahas preokupimit për ta shprehur saktë dhe drejt fjalën, kanë qenë të preokupuar edhe për gjetjen e njerëzve të aftë për t'i kuptuar drejt fjalët e tyre. Thirrja e Isait (a.s.): **“Kush janë ndihmësit e mi në rrugën e Allahut?”** (Al ‘Imran, 52.), së pari është një thirrje për të mbështetur dhe përforcuar fjalën, mesazhin e Tij. Kurse Mevlana, duke iu drejtuar Hysamedin Çelebiut i thotë: “Unë flas sipas aftësisë tënde të të kuptuarit dhe po largohem nga kjo botë me mallin për të gjetur një njeri që kupton më shumë.”

Vlera e fjalës është e fshehur në thellësitë e botës së zemrës, sepse gjuha është pasqyra e zemrës. Zemra si vatër e ndjenjave dhe gjuha si pasqyrë e saj, përcaktojnë vlerën e fjalës. Këtë raport të ngushtë midis zemrës dhe gjuhës e shpreh shumë bukur ndodhia mbresëlënëse midis Davudit (a.s.) dhe Lokman Hekimit. Davudi (a.s.), i kërkon Lokmanit t'i sjellë dy pjesët

më të mira të mishit të një deleje të prerë. Lokmani i sjell gjuhën dhe zemrën. Mbas disa ditësh, Davudi (a.s.), i kërkon Lokmanit të presë përsëri një dele, por kësaj radhe e porositi që t'i sjellë dy pjesët më të këqija. Lokman Hekimi përsëri i sjell zemrën dhe gjuhën. Kur e pyeti për urtësinë e kësaj, Lokman Hekimi iu përgjigj: “Nëse këto të dyja janë të mira, nuk gjen më të mira dhe, nëse janë të këqija, nuk gjen më të këqija se këto.”

Fjala i drejtohet personit që kupton, madje thuhet që fjala e gjatë është për të marrin. Nëse doni të flisni shkurt, duhet të gjeni njerëz që të kuptojnë. Të urtit i mjafton një shenjë, një mimikë për të kuptuar.

Është shumë i vështirë komunikimi dhe krijimi i marrëdhënieve normale me një pëson që nuk kupton apo i kupton fjalët gabim. Gjithë çështja qëndron në gjetjen e njerëzve që flasin dhe kuptojnë drejt.

Tregohet një ngjarje shumë interesante, që i ka ndodhur në burg poetit të famshëm turk Namik Kemalit me shokun e qelisë. Namiku ia recitonte poezitë e shkruara shokut të qelisë. Ai i dëgjonte me lot në sy. I sugjestionuar nga kjo gjendje, Namik Kemali gjithmonë thoshte me vete: “Sa njeri i ndjeshëm!” Në një letër dërguar një shoku, i shkruante kështu: “Jam në burg, por jam shumë i lumtur, sepse në qeli gjeta një shok burgu që më kupton, unë recitoj ai loton, ai loton unë recitoj.”

Një ditë Namiku i drejtohet shokut të qelisë me këto fjalë: “Çfarë ndjen që qan kaq shumë kur dëgjon poezitë e mia?” Shoku i përgjigjet: “Kur ti lexon poezitë, të dridhet mjekra dhe kjo gjë më kujton kecin në fshat që e doja aq shumë”. Namiku dërmohet përballë kësaj përgjigjeje, sepse pritshmëria nuk përputhej gjëkund me realen.

Për të kuptuar fjalën, më tepër se shikim dhe dëgjim duhet zemër. Aliu (r.a.), thotë: “Fjala që del nga zemra shkon në zemër, kurse fjala që del nga goja nuk e kalon veshin.” Një fjalë që del nga zemra arrin në adresën e duhur. Ndikimi i fjalës mbi njerëzit është i lidhur ngushtë edhe me të qenit model në karakter, personalitet dhe moral i personit që flet.

Njeriu, ashtu si një veten pandeh edhe tjetrin. Fjalën e kupton dhe interpreton sipas gjendjes shpirtërore. Prandaj është e këshillueshme t’u flasësh njerëzve sipas aftësisë së tyre të të kuptuarit.

Madje, Allahu e urdhëron Musain (a.s.), që edhe Faraonit t’i flasë me urtësi dhe mirësjellje. **“Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë! Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!”** (Taha, 42.)

Fjala e ëmbël ka një ndikim të jashtëzakonshëm në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Nuk ka gjë më mbresëlënëse për zemrat sesa fjala e ëmbël. Fjala e ëmbël shuan zemërimin dhe hidhërimin në zemrat e njerëzve.

Lektorin e bën të flasë auditori. Fjala e urtë “shes, sa të blesh” shpreh pikërisht këtë. Interesi për të dëgjuar rritet kur fjala e lektorit zbret në zemrat e auditorit. Interesi për të dëgjuar e entuziazmon lektorin. Prandaj është shumë e rëndësishme që të dyja palët të jenë të gatshëm dhe të aftë për komunikim.

Fjala është për atë që kupton. Komunikimi me një person që nuk kupton, është shumë i vështirë. Prandaj është e nevojshme që midis dy palëve si mjet komunikimi të përdoret një gjuhë që e flasin dhe kuptojnë të dyja palët. Në Mesnevinë e famshme të Rumiut, në lidhje me këtë tregohet:

Një turk, një arab, një persian dhe një bizantin po udhëtonin së bashku. Njëri prej tyre nxjerr disa mone-dha dhe i thotë tjetrit të shkojë në treg, të blejë diçka. Por, ngaqë gjuha e të katërtve ishte e ndryshme, ranë në mosmarrëveshje.

Njëri nga ata tha: “Me këtë para, engur të blejmë...”

Tjetri, që ishte arab, tha: “La, jo! Unë dua ineb, s’dua engur, ore!..”

I treti ishte turk; ai tha: “Unë s’dua ineb, por yzym!..”

I katërti ishte bizantin, ai tha: “Lërimi këto, unë dua istafil!..”

Pastaj filluan të grindeshin me njëri-tjetrin, sepse s’e njihnin tek emrat të fshehtën...

E grushtonin njëri-tjetrin për marrëzi, se ishin këmbosh e plot padituri...

Më në fund, takojnë një njeri të urtë dhe i tregojnë për problemin. Kur i pyet të katërt një e nga një, u thotë: “Në fakt, ju të katërt dëshironi të njëjtën gjë. Por, ngaqë nuk flisni të njëjtën gjuhë, nuk kuptoheni me njëri-tjetrin. Nëse do të flisnit të njëjtën gjuhë, do të merreshit vesh shumë mirë.”

Gjuha e kryen funksionin e saj komunikues, kur është e kuptueshme nga të dyja palët, përndryshe ajo nuk mund ta kryejë funksionin e saj të komunikimit. Nëse një person zotëron disa gjuhë, kur personi përballë nuk njeh asnjërën nga këto, atëherë komunikimi bëhet i pamundur.

Këtë të vërtetë e ilustron shumë bukur kjo anekdotë popullore turke. Temeli dhe Dursuni ishin ulur në oborrin e Xhamisë Blu. Në këto momente u vjen pranë një grup turistësh dhe i pyesin nëse dinë anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht apo spanjisht. Temeli dhe Dursuni krejt natyrshëm u përgjigjën se nuk dinin asnjërën nga ato gjuhë. Përballë kësaj gjendjeje, Dursuni i thotë Temelit: “Jemi në shekullin XXI dhe nuk dimë akoma një gjuhë të huaj. Ka ardhur koha të mësojmë një gjuhë të huaj.” Temeli, gjithë qetësi i përgjigjet: “Zotnia dinte pesë gjuhë dhe nuk mundi të merrej vesh, kurse ti dëshiron që me një gjuhë të huaj të merresh vesh. Nëse nuk di edhe personi me të cilin do të flisni, nuk ka kuptim të dini vetëm ju.”

Në të vërtetë, fjala, krahas rolit si mjet komunikimi nxjerr në pah aftësitë dhe dobësitë tona. Përmes fjalës mund të kuptohet shumë lehtë urtësia apo injoranca e personit. Prandaj të urtët gjithmonë kanë këshilluar heshtjen për ata që nuk kanë dituri. Fjala e urtë thotë: “Nëse di, fol që të marrin mësim njerëzit, nëse nuk di, hesht që të të pandehin njeri.” Kjo është një këshillë shumë e bukur për të diturit, që të ndajnë diturinë dhe njohuritë me të tjerët dhe për të paditurit, që të ruajnë dinjitetin e tyre. Oratoria është e lidhur ngushtë me heshtjen. Për të dëgjuar shumë, Zoti na ka dhënë dy veshë dhe për të folur pak na ka dhënë një gjuhë.

Fjala nuk është për gjithëkënd. Sepse fjala është si shigjeta, që kur del nga harku, nuk kthehet më. Njeriu është zotëruar i fjalës deri sa nuk e ka nxjerrë nga goja, në momentin që fjala del nga goja, atëherë njeriu nuk është më zotëruar, por skllavi i saj.

Është shumë e rëndësishme të dihet koha dhe vendi ku do të thuhet fjala. Përveç aftësisë për të thurur bukur fjalët, është shumë i rëndësishëm përdorimi në vendin dhe kohën e duhur.

E rëndësishme është që fjala të thuhet atje ku kuptohet. Në një vend ku nuk të kuptojnë, fjala më e mirë është heshtja. Rritja e nivelit të gjuhës duhet të shoqërohet me rritjen e nivelit të folësit dhe dëgjuesit. Gjuha e pasur e një njeriu tregon kulturën e madhe, kurse gjuha e varfër tregon nivelin e dobët të tij. Pasurimi i gjuhës sjell zhvillimin e kulturës personale.

Cilësia dhe thelbi i njeriut është i fshehur nën gjuhë. Gjuha e ëmbël dhe e bukur shpreh botën e pasur shpirtërore të personit. Mbrujtja e jetës me mesimet kuranore sjell rritjen e vlerës së fjalës dhe botës së brendshme. Mbërrirja shpirtërore sjell përsosmërinë e fjalës, sepse fjala është pasqyrë e shpirtit.

PARALAJMËRIMI HYJNOR

— Xhafer Durmush —

Inzar do të thotë: “Paralajmërimi i atyre që nuk i zbatojnë urdhrat hyjnorë, duke ua bërë të qartë se i pret një e ardhme e hidhur.” Sjelljet e njeriut kanë nevojë të rregullohen me frikësim ose inkurajim. Shpjegimet më të qarta dhe shembujt më të kup-tueshëm, që i përgjigjen nevojës së paralajmërimit, janë fjalët e Allahut të Madhëruar.

“Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpër-mjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!”¹

Në ajetin e mësipërm, Allahu Teala shprehet se ky Libër i Lartë, është një “deklaratë paralajmëruese”. Në Kuranin Fisnik thuhet se pejgamberët, (prej jetës së të cilëve jepen shembuj), janë “paralajmërues dhe përgëzues”.² Në ajetin fisnik, në të cilin njoftohet profetësia e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), së pari përmendet cilësia përgëzues.³

I Dërguari i Allahut, ((a.s.)), e përkufizon veten duke e përngjasuar me një njeri që njofton popullin e tij se po vjen një ushtri armike dhe i paralajmëron për rrezikun që po afrohet.⁴

Megjithëse paralajmërimi është detyrë e profetëve, në Kuranin Fisnik emri “mundhir” është njëri prej emrave të Allahut Teala.⁵ Kjo tregon se Allahu Teala është në dijeni për çdo gjë që bëjmë dhe se ka krijuar çdo lloj mundësie për të na shpënë në rrugë të drejtë.

Feja jonë sublime, gjithmonë kërkon nga ne që në çdo fushë të drejtohem nga gjërat e mira dhe të dobishme. Po ashtu, kërkon që të jetojmë brenda kornizave të urdhrave hyjnorë duke u larguar nga çdo gjë e keqe dhe e shëmtuar. Për këtë arsye, siç shprehet qartë se askush nuk mund të imponohet në çështjen e pranimit të Islamit,⁶ po ashtu, bëhet fjalë edhe për orientimin e sjelljeve në drejtimin e duhur dhe për paralajmërimin e besimtarëve me mënyra të ndryshme pasi kanë hyrë në fenë Islame.

Nisur nga kjo, mund të themi se inzari (paralajmërimi hyjnor) është metodë efikase që mund të përdoret për ta tërhequr njeriun drejt sjelljeve të përshtatshme ndaj synimeve të fesë së tij duke ngjallur frikë te ai dhe për të hequr disa pengesa psikologjike.

Në ajetin fisnik, thuhet: **“Ne i frikësojmë ata (në mënyra të ndryshme).”**⁷ Krahës kësaj, shprehet se paralajmërimi hyjnor, për të cilin po flasim, nuk ka dhënë ndonjë ndikim për mirë te mohuesit, por përkundrazi, ua ka shtuar atyre humbjen. Nga kjo, kuptohet se ndikimi i paralajmërimit hyjnor, vërehet më shumë te njerëzit besimtarë. Një paralajmërim, baza e të cilit mbështetet në besim, e forcon dëshirën e njeriut për t’i zhvilluar sjelljet e tij në anën e mirë.⁸

Për këtë arsye, besimtarët janë grupi që së pari synohen në qindra ajete në të cilat kalojnë foljet “hauf”, “inzar” dhe “ittika”, në historitë që tregojnë për humbjet që kanë pësuar popujt të cilët nuk

1. Sureja Ibrahim, 14/52.

2. Sureja Nuh, 11/2. el-Hixhr, 15/89, etj.

3. Sureja el-Bakara, 2/119. el-Isra, 17/105.

4. Buhari, rikak, 26.

5. Sureja ed-Duhan, 44/3.

6. Sureja el-Bakara, 2/257.

7. Sureja el-Isra, 17/60.

8. Shik. T.D.V. Islam Ansiklopedisi, Inzar Maddesi, Hayati Hökelekli.

ia kanë vënë veshin paralajmërimeve hyjnore. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që ata të mos mposhten ndaj vetes dhe shejtanit të mallkuar, sepse shejtani bën dredhi të ndryshme e ngre kurthe, duke ndryshuar gjithmonë petk dhe përpiket ta vjedhë besimin, duke penguar nga rruga e drejtë.

Nëse nuk mund ta bëjë këtë, përpiket ta zbrazë brendësinë e punëve të mira dhe t'i largojë besimtarët nga sinqeriteti. Faktikisht, kjo është natyra e tij. Ndërsa natyra e vetes është dembelizmi. Nisur nga kjo, ajo duhet të paralajmërohet shpeshherë për shkak të këtij dembelizmi që ka në strukturën e saj.

Allahu i Madhëruar e urdhëron kështu të Dërguarin e Tij të dashur, (a.s.): **“Këshilloji me Kuran ata që frikësohen nga kërcënimi Im!”**⁹ Ky ajet duhet të ketë një kuptim të veçantë në syrin e besimtarëve që ndjejnë se lëviz diçka nga brendësia e tyre kur lexohet Kuran...

Edhe njëra prej çështjeve që na bën të falënderojmë sa herë që lexojmë fjalën hyjnore, është kjo: Allahu Teala na paralajmëron me këtë dhe qindra ajete të tjera fisnike. Nganjëherë na fton për t'u zgjuar, duke na përkujtuar momentet e tmerrshme të ditës së takimit, nganjëherë duke folur për ndëshkimin përvëlues që do të rrethojë jobesimtarët¹⁰ dhe nganjëherë duke na treguar historitë mësimdhënëse të popujve të kaluar...

Ja, në këtë çështje, një dimension i ndryshëm i paralajmërimit hyjnor, na tërheq vëmendjen: Në Kuranin Fisnik njoftohet se edhe shejtani i frikëson miqtë e tij dhe në fjalinë e fundit të ajetit në fjalë, thuhet:

“Nëse keni besuar, mos kini frikë prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje.”¹¹

I lartësuar është Allahu! Paralajmërimet e Allahut të Madhëruar, nuk janë paralajmërime të thata e të mbështetura në dyshime si frikësimet e shejtanit të mallkuar. Allahu i paralajmëron robërit e tij për rreziqet që do të ndodhin. Po ashtu, i urdhëron që të largohen nga sjelljet e shëmtuara. Në këtë mënyrë, frikësimi i Tij kthehet vetëm në mëshirë...

Nisur nga aspekti i këtyre shpjegimeve, njerëzit nuk duhet të pandehin se Islami është fe e frikës. Përkundrazi, Islami është një strukturë e përkryer që përmbledh të gjitha specifikat e zhvillimit të një personaliteti psikologjik, ekuilibruar dhe të shëndoshë që dëshiron të nxjerrë në pah. Në këtë mënyrë,

Islami i jep përparësi përfitimit sipas nevojës nga motivet që e vendosin në lëvizje dashurinë dhe frikën në edukim.

Nëse dëshirojmë të bëjmë një jetë sipas Islamit, ku frika dhe shpresa janë në masat ideale dhe nëse dëshirojmë që në jetën e amshueshme të arrijmë ato që shpresojmë, atëherë duhet të qëndrojmë larg gjërave të këqija prej të cilave paralajmërohem.

SË PARI, PASTRIMI SHPIRTËROR

Në ajetin fisnik, thuhet:

“Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë. Ndërsa, kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”¹²

Kur e lexojmë këtë ajet fisnik, mendoj se gjithmonë duhet ta kemi parasysh pastrimin shpirtëror...

E di se sëmundjet që i ngjiten trupit, më së shumti e privojnë njeriun nga disa mirësi. Ndërsa sëmundjet që i ngjiten zemrës, bëhen shkak për humbjen e përhershme, nëse nuk bëhet ndërhyrje në kohën e duhur...

Njerëzit e urtë kanë thënë: “Sëmundjet që zënë shpirtin janë shtatë llojesh. Ato korrespondojnë me shtatë dyert e xhehenemit. Për këtë arsye, përderisa njeriu të mos i shkulë nga shpirti këto shtatë sëmundje dhe t'i hedhë, dyert e xhehenemit nuk konsiderohen të mbyllura për të.”

Sëmundjet për të cilat po flasim, i kanë radhitur kështu: “Pëlqimi i vetes, shtirja, mendjemadhësia, zemërimi, smira, dashuria ndaj pasurisë dhe dashuria ndaj pozitës.”

Për t'u hapur vend në zemër cilësive të bukura që janë të pëlqyeshme te Allahu Teala, së pari duhet të shkulen nga aty cilësitë e këqija dhe të padëshirueshme. Për të realizuar pastrimin shpirtëror, i cili do t'u japë sinqeritet dhe ndershmëri veprave tona, këto dy cilësi duhet t'i kemi primare në jetë.

Nëse synojmë të arrijmë suksesin në provimin e jetës, atëherë jemi të detyruar t'i planifikojmë punët dhe kohën e tyre në një mënyrë serioze. Siç thonë edhe të vjetrit: “Patjetër duhet të respektohet radha nga më e rëndësishmja te e rëndësishmja”...

9. Sureja Kaf, 50/45.

10. Sureja ez-Zumer, 39/71; Sureja Ibrahim, 14/44, etj.

11. Sureja Ali Imran, 3/175.

12. Sureja esh-Shems, 91/7-10.



SHOQËRIA E EPOKËS SË LUMTURISË NË EDUKIMIN E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

NUK KA NEVOJË PËR MREKULLI TJETËR

Kanë ardhur mrekulli të panumërta. Qoftë edhe heshtja e tij përhap mrekulli. Çdo gjendje e tij dhe çdo gjë që bëri fitoi një vlerë mrekullie. Për këtë arsye, për këtë qenie të ndritur;

Karafi, i cili është njëra prej figurave më të rëndësishme të usulu'l-fikhut, domethënë të metodologjisë së jurisprudencës islame, ka thënë:

“Po të mos kishte asnjë mrekulli tjetër i Dërguari i Allahut (a.s.), përveç sahabëve, sahabët e nderuar ishin të mjaftueshëm për ta vërtetuar profecinë e Pejgamberit tonë të Nderuar.”

Me të vërtetë;

Nëse e shohim me kujdes historinë e njerëzimit, do të vëmë re se, edukuesi dhe mësuesi më i madh që ka pasur njerëzimi ishte i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.). Në edukimin e tij plot frymëzim dhe përsëritshmëri u edukuan personalitete aq të larta saqë u quajtën sahabë të nderuar. Civilizimi i virtyteve që ndërtuan ata nuk ka të ngjashëm.

Ndërkohë kjo shoqëri para se të vinte Krenaria e Gjithësisë, i Nderuar ynë (a.s.), ishte e varrosur në padrejtësitë e injorancës dhe zullum. Për shekuj me radhë kjo shoqëri nuk shfaqti dot ekzistencë individuale apo sociale në asnjë fushë.

Por;

Ajo mori një frymëzim të atillë nga gjendja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ishte Kuran

i gjallë, dhe arriti një përsosmëri të atillë në edukimin e tij saqë pothuajse doli nga fundi i oqeanit Indian dhe arriti pikën kulmore në qiell.

Shoqëria e dashurisë dhe njohjes së Zotit, singëritetit dhe devotshmërisë, fshehtësisë dhe urtësisë...

“Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), ishte si një shi i begatë që bie në një tokë që s’ka parë shi me shekuj me radhë për njerëzimin që kishte nevojë për udhëzim.”

Vallë, çfarë ka mësuar ajo shoqëri prej Pejgamberit tonë të Nderuar (a.s.), që arriti një pozitë të pashoqe në historinë e njerëzimit?





Çfarë mori prej tij ajo shoqëria e mëshirës?

Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve së pari le të shprehim këtë:

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), ishte si një shi i begatë që bie në një tokë që s'ka parë shi me shekuj me radhë për shoqërinë që ishte dërguar. Ishte një mëshirë që, sa më shumë të binte i shndërronte shkretëtirat në bahçe trëndafilash. Ishte një mëshirë që iu dërgua një shoqërie të cilës kishte shekuj që nuk i ishte dërguar Pejgamber dhe e cila kishte mbetur në injorancë, ishte zhytur në shirk e idhujtari dhe ishte bërë skllave e tiranëve zemërgurë. Ishte një burim mëshire që i mësoi (asaj shoqërie) adhurimin e vërtetë. Nisur nga këto që thamë më sipër, gjëja e parë që ai ua mësoi njerëzve ishte kjo:

“Pejgamberi ynë ishte një mëshirë e cila sa më shumë të binte aq më shumë i shndërronte shkretëtirat në bahçe trëndafilash. Ishte një burim mëshire që i mësoi (asaj shoqërie) adhurimin e vërtetë.”



VETËDIJA PËR ADHURIMIN

I Nderuari ynë (a.s.), së pari u mësoi sahabëve të qenët rob ndaj Allahut sipas orientimit të ajetit fisnik në të cilin thuhet:

“Unë i kam krijuar xhindët dhe njerëzit vetëm për të më adhuruar Mua!” (Dhariat, 56)

Edhe ata e përvetësuan më gjithë shpirt adhurimin e vërtetë sipas edukimit të tij. Zemrat e tyre u mbushën me besim dhe urtësi. Balli i tyre shkëlqeu me sexhde. Kelimetu't-Tevhid (shehadeti) u bë burimi më i madh i prehjes për ta. Shpëtuan nga humbja e përhershme dhe arritën xhenetin e dorëzimit ndaj Zotit (xh. xh.). Ata e kuptuan plotësisht se çdo të thotë adhurim vetëm ndaj Allahut.

Në këtë mënyrë shpëtuan nga të gjithë kularët dhe prangat.

Në këtë mënyrë jetuan me respekt të pafund ndaj urdhrit të Allahut Teala siç përmblihet te shprehja “ta’dhim li emril-lah”.

Në këtë mënyrë ata mësuuan nga i Dërguari i Allahut (a.s.), edhe vetëdijen dhe perceptimin e ibadeteve që i interesojnë individit, edhe bazat e marrëdhënieve njerëzore që i interesojnë shoqërisë.

Më parë;

I ndiqnin verbërisht etërit e tyre si një arsye për t'u mburrur. Ata shpëtuan edhe nga kjo. Bashkëshortet dhe fëmijët i konsideronin si një pikë mbështetjeje mashtroese. Shpëtuan edhe nga kjo. Gruan e konsideronin vetëm si një mall që blihet dhe shihet. Shpëtuan edhe nga kjo.

Sepse ata;

Mësuuan mirësinë e parajsës në këtë botë nga shtëpia e Resulullahut (a.s.), që të kujtonte kopshtet e xhenetit.

Domethënë, çështja e dytë që e mësuuan nga

Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), pas adhurimit ndaj Allahut (xh.xh.), ishte kjo:

LUMTURIA FAMILJARE

Ata shpëtuan nga jetesa imorale, e paturpshme dhe e paedukatë e xhahilijetit. Gjithashtu shpëtuan edhe nga besimet e devijuara dhe besëtytnitë e asaj periudhe të errët. Pastaj mësuam jetën familjare e cila është burimi i lumturisë, nga familja e lumtur e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe ezvaxhi tahirat, domethënë bashkëshortet e pastra të tij të cilat janë nënat e besimtarëve.

“Sahabët e nderuar me paralajmërimin dhe sugjerimin e të Nderuarit tonë në formën: “Jeta e vërtetë është jeta e ahiretit!”, u bënë një shoqëri që u pasurua me vetëmjaftim kundrejt kësaj bote dhe që kishte uri ta pafundme kundrejt kënaqësive të ahiretit.”

Sahabët e rinj që u edukuan në ato shtëpi të bekuara, brezi që edukuan ata dhe vazhdimësia e atij brezi që i ndoqi ata me mirësi dhe sinqeritet, në çdo anë të botës përhapën dashurinë që kishin marrë nga Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.).

“Sahabët e nderuar jetuan në një gjendje pehrizi të natyrshme. Konsumi i tepërt, grykësia, luksi dhe shtirja ishin mënyra jetese që ata kurrë nuk i njihnin.”

Suksesi i atyre nuk ishte vetëm në dije dhe çlirime. Ata gjendeshin edhe në pikën kulmore të moralit. Ata arritën cilësi aq të larta sa që lapsat nuk mund t'i shkruajnë dhe gjuhët nuk mund t'i shpjegojnë. Me gjendjen që kishin u bënë shembull për ata që vinin pas tyre. Thelbi i veprimeve të tyre ishte dhembshuri ndaj krijesave.

Thënë me një shprehje tjetër;

HORIZONTI I MËSHIRËS SË PAFUNDME

Kjo mëshirë dhe dhembshuri u thellua në shoqërinë e dashurisë e cila u edukua nga fjalimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për botët. Ndërgjegjja arriti mundësinë për të jetuar në prehje.

Njerëzit e egër që e shkëpusnin vajzën nga zemra e nënës dhe e çonin për ta varrosur të gjallë, pas Islamit u shndërruan në engjëj dhembshurie dhe njerëz modestë që derdhnin lot. Zemrat u bënë vendstrehime në të cilat gjenin prehje dhe ngushëllim njerëzit e përvuajtur. Zemrat u bënë vendstrehime për gratë e veja, jetimët dhe të vetmuarit.

Omeri me zemër të ashpër para Islamit, pas Islamit u bë Hazreti Omeri me zemër të butë. Te ai u shfaq një gjendje e cila e bënte të thoshte:

“Nëse një dele që po kalon në Eufrat bie në ujë dhe mbytet, Allahu do ta kërkojë llogarinë e saj nga Omeri.”

Sepse ata e patën mësuar nga Resulullahu, alejhi's-salam, se çdo gjë është një amanet që i është dhënë njeriut për ta ruajtur dhe për t'u sprovuar.

Sepse ata e patën mësuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.), se kjo botë është si një stacion pushimi i një udhëtimi drejt botës së përherëshme për njeriun dhe se ky kapital i përkohshëm është dhënë për t'u investuar për ahiretin.

Sepse ai, Krenaria e Gjithësisë, i Dërguari i Allahut (a.s.), thoshte edhe në ditët më të vështira që u përjetuan në luftën e Ahzabit (Hendekut) kur durimi pothuajse u konsumua, edhe në ditët më madhështore dhe të lumtura përgjatë çlirimit të Mekës, në mënyrë që nga njëra anë të ishte ngushëllim dhe nga ana tjetër që sukseset të mos shndërroheshin në mendjemadhësi e mburrje:

“JETA E VËRTETË ËSHTË JETA E AHIRETIT!”

Sahabët e nderuar me këtë paralajmërim, sugjerim dhe ngushëllim u bënë një shoqëri që u pasurua me vetëmjaftim kundrejt kësaj bote dhe që kishte uri ta pafundme kundrejt kënaqësive të ahiretit. Ata jetuan në një gjendje pehrizi të natyrshme. Konsumi i tepërt, grykësia, luksi dhe shtirja ishin mënyra jetese që ata kurrë nuk i njihnin.”

Sepse botëkuptimi i tyre ishte: “Nesër vendi i nefsit do të jetë varri.”

“Sahabët e nderuar i përdorën bashkërisht dhe në harmoni funksionet e mendjes dhe të zemrës të cilat e shpien njeriun në përsosmëri. Ata i mbajtën aktivë faktorët e entuziazmit dhe dashurisë dhe u thelluan në meditim.”

Ata e perceptonin se kjo botë ishte një shkollë sprove. Andaj u përpoqën me dashuri, entuziazëm dhe vendosmëri jo për veten e tyre, por për kauzën e vërtetë dhe për të lartësuar emrin e Allahut (xh.xh.). Lodhja dhe mërzitja u fshinë nga fjalori i tyre.

Shteti i vogël i Medines i cili u formua me një mijë e pesëqind vetë, pas dhjetë vjetësh arriti të bëhej pesëdhjetë mijë vetë. Kufijtë e shtetit të vogël një kilometër katror arritën deri në Palestinë dhe Irak.

“Sahabët e nderuar të cilët i perceptuan rrymat e madhështisë dhe fuqisë hyjnore, filluan të lexonin të fshehtat dhe urtësitë. Universi u shndërrua në një libër për ta. Ndërsa Libri (Kurani), u shndërrua në një univers...”

Ata shkuan deri në Kinë, Semerkand, Kaukaz dhe Afrikë për el-emru bi'l-ma'ruf ve'n-nehj ani'l-munker (urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja). Edhe ata që erdhën pas tyre shkuan deri në Andaluzi. Ebu Ejjub el-Ensariu (r.a.), shkoi deri në Stamboll në moshën tetëdhjetë e disa vjeçare për ta zbatuar el-emru bi'l-ma'rufin me ndikimin nga ajeti fisnik në të cilin thuhet: **“Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja!”** (Bekare, 195) Trupi i përkohshëm i tij u bë një kujtim sublim dhe begati e madhe për Stambollin.

Ky entuziazëm i sahabëve nuk gjendej vetëm te ata që kishin arritur moshën madhore, por gjendej shumë aktiv në formë ashiqare edhe te ata që ishin në moshë të vogël. Ja;

ENTUZIAZMI I NJË TË RIU NË MOSHËN 16 VJEÇARE

Ishte viti i dytë i hixhretit dhe data dymbëdhjetë e muajit të Ramazanit. I Dërguari i Allahut (a.s.), e la si zëvendës në Medine Abdullah ibn Ummi Mektumin për të falur namazet dhe doli nga qyteti me një ushtri prej 313 vetash. Gjashtëdhjetë e katër prej këtyre ishin muhaxhirë. Kurse të tjerët ishin prej ensarëve. Tre ishin kalorës, shtatëdhjetë ishin me deve dhe të tjerët ishin këmbësorë.

Pejgamberi ynë i Nderuar i ndaloi luftëtarët në Bujutu's-Sukja që gjendej një milje larg Medines. Ata që ishin në moshë të vogël i ktheu pas. Sa'd ibn Ebi Vakkasi (r.a.), tregon:

“Para se i Dërguari i Allahut (a.s.), t'i kthente pas ata që ishin në moshë të vogël, pashë vëllain tim Umejrin i cili po përpiquej të fshihej. Atij i thashë:

“Çfarë të ka ndodhur vëlla?” Ai më tha

“Kam frikë se i Dërguari i Allahut do të më konsiderojë të vogël dhe do të më kthejë pas! Ndërkohë unë dëshiroj shumë të marr pjesë në luftë dhe shpresoj që Allahu të ma mundësojë të bie dëshmor!” Me të vërtetë kur vëllai im doli para Resulullahut (a.s.), ai e konsideroi të vogël dhe i tha:

“Kthehu pas!” Umejri filloi të qante. Për këtë arsye, Pejgamberi ynë i Nderuar e lejoi të merrte pjesë në luftë. Për shkak se Umejri ishte i vogël në moshë, shpatën ia lidhja unë. Kur ra dëshmor në Bedr ishte në moshën 16 vjeçare.” (Vakidi, I, 21; Ibn Sa'd, III, 149-150.)

“Abdullah ibn Zejdi (r.a.), duke e ndjerë se sytë e kishin humbur funksionin e tyre pasi ndërroi jetë Resulullahu (a.s.), u lut duke thënë: “O Zot! Ma merr shikimin!” Ky përgjërëm i sinqertë i tij u pranua menjëherë dhe ai në atë moment u bë i verbër.”



Sahabët e nderuar e flijonin çdo gjë për hir të të Dashurit të Allahut. Atë e donin më shumë se jetën dhe fëmijët e tyre. Ja vetëm një shembull nga mijëra të tillë:

AI KANDODHUR GJË ATIJ?

Ditën e Uhudit Medina po tronditej nga një lajm që u përhap:

“Muhamedi (a.s.), është vrarë!”

Në qytet kishin filluar britmat dhe klithmat lartësoheshin deri në Arsh (qiell). Të gjithë ishin dyndur rrugëve dhe përpiqeshin për të marrë ndonjë lajm prej atyre që vinin. Një prej atyre ishte edhe Sumejra (r.anha), e cila ishte prej ensarëve. Ajo pati marrë lajmin se në atë luftë të tmerrshme dhe mësimdhënëse i kishin rënë dëshmorë dy djemtë, babai, bashkëshorti dhe vëllai. Ajo kishte humbur pesë të afërm të saj njëherësh. Por kjo sahabe e bekuar nuk shqetësohej për këtë. Çështja që e shqetësonte atë ishte gjendja e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Andaj vazhdimisht thoshte:

“Aman të mos i ndodhë gjë atij!” Sahabët e nderuar i thanë:

“Falënderimi i takon Allahut! Resulullahu është mirë. Ai është në jetë, siç dëshiron ti!”

Sumejrës (r.anha), nuk i qetësohej zemra me këtë lajm përgëzues. Andaj u përgjerohej atyre:

“Zemra nuk do të më qetësohet pa e parë atë. Ju përgjerohem ma tregoni të Dërguarin e Allahut.”

Kur ia treguan, shkoi menjëherë, i kapi majën e rrobës dhe i tha:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Pasi ti të jesh gjallë, asgjë tjetër nuk më lëndon!” (Vakidi, I, 292.)

“Hazreti Osmanit iu pre gjuha dhe nuk foli dot në hytbe pasi ndërroi jetë Resulullahu (a.s.). Bilal el-Habeshiu nuk e thirri dot ezanin ngaqë nuk e shihte të Dërguarin e Allahut në mihrab.”

Kjo vetëdije mund të arrihej vetëm me dijen absolute se jeta e vërtetë është jeta e ahiretit.

Ata e mësuan këtë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Në çdo gjë që bënë kishin këtë parim:

T'I NGJAJ ATIJ...

Brezi i sahabëve ishte i entuziazmuar dhe mendonte:

“Çfarë kërkon Allahu prej nesh? Si dëshiron të na shohë Resulullahu?”

Sahabët fituan një botë-kuptim të ri për Allahun, universin dhe nefsin. Qëllimi i vetëm i tyre ishte t'i ngjanin Resulullahut (a.s.), sikur po vështronin diellin në një pasqyrë të vogël.

Ata u përpoqën me gjithë shpirt për t'i ngjarë të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Sahabët e nderuar i përdorën bashkërisht dhe në harmoni funksionet e me-

ndjes dhe të zemrës të cilat e shpien

njeriun në përsosmëri. Ata i mbajtën aktivë faktorët e entuziazmit dhe dashurisë dhe u thelluan në meditim. Ata i perceptuan rrymat e madhështisë dhe fuqisë hyjnore, filluan të lexonin të fshehtat dhe urtësitë. Universi u shndërrua në një libër për ta. Ndërsa Libri (Kurani), u shndërrua në një univers...

Netët u shndërruan në ditë. Dimrat u bënë pranvera. Meditimi u zhvillua. Filluan medi-

time shumë të thella rreth ardhjes së trupit të njeriut nga një pikë uji, ardhjes së zogut nga një vezë e thjeshtë, ardhjes së pemëve dhe frutave nga disa fara jashtëzakonisht të vogla dhe mbi shembuj të tjerë të ngjashëm me këta... Jeta u indeksua te arritja e kënaqësisë së Allahut (xh.xh.). Përhapja e mëshirës, butësisë dhe të drejtës arriti pikën kulmore. Shkurtimisht, në çdo aspekt përvetësuan moralin e lartë të Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut (a.s.). Në këtë mënyrë, kënaqësia më e madhe e tyre ishte kjo:

TA DËGJONIN ATË DHE TË THELLOHESHIN TE AI...

Sahabët e nderuar shfaqnin një përpikëri kulmore për t'i mësuar sunetin dhe mënyrën e jetesës së të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe për t'i praktikuar ata në jetë. Një shembull i veçantë prej atyre ishte biri i Hazreti Omerit, Abdullah ibn Omeri (r.a.).

"Abdullah ibn Omeri (r.a.), për shkak të dashurisë që kishte ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), i mësonte vendet ku kishte falur namazi ai dhe falte namaz aty. Ecte në rrugët që kishte ecur ai, ulej nën pemët ku ishte ulur ai dhe i vadiste ato, në mënyrë që të mos thaheshin."

Abdullah ibn Omeri (r.a.), pasi ndërroi jetë Resulullahu (a.s.), për shkak të dashurisë që kishte ndaj tij, i mësonte vende ku kishte falur namazi ai dhe falte namaz aty. Ecte në rrugët që kishte ecur ai, ulej nën pemët ku ishte ulur ai dhe i vadiste ato, në mënyrë që të mos thaheshin. Kur ecte në rrugë, ndiqte rrugën në të cilën kishte ecur dhe e kishte parë Resulullahu (a.s.). Kafshën e kthente në vendet ku e kishte kthyer edhe ai. Veçanërisht vepronte me shumë përpikëri në lidhje me çështjen e zbatimit të urdhrave të të Nderuarit tonë rreth dhënies së selamit. Edhe kur nuk kishte asnjë punë, dilte në rrugë për t'u dhënë selam myslimanëve (me entuziazmin për të përjetuar vëllazërinë islame). Ai u jepte selam të gjithë atyre që i takonte qofshin të mëdhenj apo të vegjël. (Ibn Sa'd, IV, 156; Ibn Haxher, el-Isabe, II, 349; Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, III, 341.)

"Sahabët e nderuar i eliminuan të gjitha dëshirat e përkohshme vetjake, nuk u mashtruan nga lodrat e kësaj bote dhe u bënë një shoqëri dashurie. U bënë një shoqëri që mbartte entuziazmin për t'i ngjarë atij, domethënë, Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut (a.s.)."

Resulullahu, alejhi's-selam, tha në lidhje me një derë të xhamisë:

"Sikur ta linim për gratë këtë derë..."

Nafi (r.a.), thotë:

"Ibn Omeri (r.a.), nuk hyri asnjëherë nga ajo derë derisa ndërroi jetë." (Ebu Davud, Salat, 53/571.)

Kjo besnikëri e singertë ka me qindra shembuj në jetën e Abdullah ibn Omerit (r.a.). Kjo përpikëri e atyre plot dashuri ishte një pasqyrë për të Nderuarin tonë. Falë faktit se ata ishin kaq shumë të përkushtuar ndaj atij Diellit të Udhëzimit, jeta e Resulullahut (a.s.), pothuajse rresht për rresht iu transmetua umetit që do të vijë deri në kiamet, në mënyrë që të përfitojë.

Sepse sahabët ishin të vetëdijshëm për vlerën e reflektimeve që kishin marrë nga i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili i nxori ata nga batakët e injorancës për në kopshtet e xhenetit, nga errësitat e zullumit dhe femohimit në dritën e drejtësisë dhe besimit. Ata e dinin se falënderimi për këtë mirësi ishte predikimi i Islamit, el-emru bi'l-ma'ruf ve'n-nehj ani'l-munker dhe shërbimi.

AJO SHOQËRI PRODUKTIVE

I eliminoi të gjitha dëshirat e përkohshme vetjake, nuk u mashtrua nga lodrat e kësaj bote dhe u bë një shoqëri dashurie. U bë një shoqëri që mbartte entuziazmin për t'i ngjarë atij, domethënë, Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut (a.s.)."

Sepse;

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte çdo gjë për ata. Kuptimi i jetës dhe qëllimi i përpjekjeve të tyre ishte Ai (a.s.). Për këtë arsye, shpërngulja

e tij për te “Miku i Lartë” ndikoi thellë te ata.

“Ne kemi ardhur në këtë botë 14 shekuj pas të Dërguarit të Allahut. Por nëse mund ta njohim atë me dashurinë e sahabëve, nëse mund ta zbatojmë sunetin e tij me dëshirë dhe entuziazëm, edhe ne do t'i arrijmë ato përgëzime.”

Abdullah ibn Zejdi (r.a.), duke e ndjerë se sytë e kishin humbur funksionin e tyre pasi ndërroi jetë Resulullahu (a.s.), u lut duke thënë:

“O Zot! Ma merr shikimin!” Ky përgjërim i sinqertë i tij u pranua menjëherë dhe ai në atë moment u bë i verbër.

Hazreti Osmanit iu preguha dhe nuk foli dot në hytbe pasi ndërroi jetë Resulullahu (a.s.).

Bilal el-Habeshiu nuk e thirri dot ezanin ngaqë nuk e shihte të Dërguarin e Allahut në mihrab. Ai nuk u rezistoi dot kujtimeve që e rrethonin nga çdo anë dhe shkoj në Sham. Edhe ezanin që filloi ta thërriste pas disa vitesh për të mos ua thyer zemrën nipërve të të Dërguarit të Allahut, përsëri nuk e përfundoi dot për shkak të qarjes me ngashërim.

Sahabët e nderuar, të cilët ishin fatlumët e Epokës së Lumturisë, bënë një jetë të mbushur plot me përgëzime dhe shfaqje dashurie. Ndërsa ne kemi ardhur në këtë botë 14 shekuj pas të Dërguarit të Allahut. Epoka e Lumturisë u bënë 1400 vite që ka kaluar. Por përgëzimet që ka dhënë Resulullahu (a.s.), sigurisht që nuk i përkasin vetëm asaj periudhe. Nëse mund ta njohim atë me dashurinë e sahabëve, nëse mund ta zbatojmë Sunetin e tij me dëshirë dhe entuziazëm, edhe ne do t'i arrijmë ato përgëzime.”

“Njerëzit më të afërt ndaj meje janë të devotshmit të cilët e kanë frikë Allahun kudo që të ndodhen.” (Ahmed, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)”

Muadh ibn Xhebeli (r.a.), tregon:

“Kur Resulullahu (a.s.), më dërgoi si prefekt në Jemen, erdhi me mua deri jashtë Medines për të më përcjellë. Unë isha mbi kafshë, ndërsa ai po ecte në këmbë. Pasi më dha disa këshilla, më tha:

“O Muadh! Ndoshta pas këtij vitit nuk do të më shohësh më! Me shumë mundësi do të vish te kjo xhamia dhe varri im!”

Kur i dëgjova këto fjalë, fillova të qaja prej pikëllimit që më shkaktoi ndarja nga miku, domethënë nga i Dërguari i Allahut. I Nderuari ynë më tha:

“Mos qaj, o Muadh!” Pastaj më tha duke e kthyer fytyrën drejt Medines:


“Njerëzit më të afërt ndaj meje janë të devotshmit të cilët e kanë frikë Allahun kudo që të ndodhen.” (Ahmed, V, 235; Hejsemi, IX, 22.)

Allahu Teala na bëftë prej atyre të devotshmëve!

Allahu (xh.xh.), na bëftë prej atyre që ndjekin rrugën e sahabëve të zgjedhur që i edukoi Hazreti Pejgamberi, alejhi's-salam! Na e mundësoftë që t'i zbatojmë urdhrat dhe ndalesat e të Nderuarit tonë si ata! Na e mundësoftë që të bëhemi vëllezërit e tij në këtë kohë të fundit (të kësaj bote)!

Amin!..

“Sahabët e nderuar i eliminuan të gjitha dëshirat e përkohshme vetjake, nuk u mashtruan nga lodrat e kësaj bote dhe u bënë një shoqëri dashurie. U bënë një shoqëri që mbartte entuziazmin për t'i ngjarë atij, domethënë, Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut (a.s.).”



HUAJA E MIRË

— Ahmet Basher —

Në kuptimin leksikor, fjala karzi hasen do të thotë hua e mirë, pra, borxh pa kamatë. Domethënë, një mysliman që e ka gjendjen materiale të mirë, të përpiket të nxjerrë nga vështirësia vëllain mysliman duke i dhënë borxh pa kamatë. Ky është njëri prej urdhrave të Allahut Teala që duhet kryer dhe një ibadet që ka shumë sevap. Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik: **“Kush është ai, që do t’i japë vullnetarisht Allahut një hua të mirë, që Ai pastaj t’ia kthejë shumëfish?! (Veç kësaj), për atë do të ketë shpërblim fisnik.”** (Hadid, 11) **“Kush do t’i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t’ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron. Tek Ai do të ktheheni.”** (Bakara, 245) Edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë në lidhje me këtë çështje: *“Kush e shpëton vëllain e tij mysliman nga një vështirësi e kësaj bote edhe Allahu do ta shpëtojë atë nga vështirësia e Ahiretit.”*

Në ditët e sotshme, për fat të keq, bankat zënë ndërtesat më kryesore në rrugët më funksionale të qyteteve myslimane, sepse bankat po fitojnë më shumë se njerëzit që bëjnë reklama për të inkurajuar konsumin e tepërt dhe që prodhojnë e shesin mall me dëshirën për t’u bërë sa më të pasur në sistemin kapitalist, duke u kapluar nga lakmia e kësaj bote. Njëri prej shkaqeve më kryesore që kanë detyruar njerëzit të përfundojnë në banka dhe i ndyrjes së tyre me kamatë në mënyrë të pavetëdijshme, është mosnjohja e rregullave të marrjes së borxhit.

I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk ua falte namazin e xhenazes atyre që vdisnin dhe kishin borxh, derisa të shlyhej borxhi. Edhe njëri prej shkaqeve që myslimanët drejtohen te bankat, është harrimi i ibadetit të dhënies borxh pa kamatë ndërmjet myslimanëve. Them ibadet, sepse, sipas ajeteve dhe hadithit të mësipërm, nxjerrja e një myslimani nga vështirësia ka më shumë sevape se të gjitha ibadetet nafie pas ibadeteve farz. Në lidhje me këtë çështje, mund të përmendim edhe lënien e itikafit nga ana e Ibn Abbasit (r.a.), në muajin e Ramazanit dhe në Xhaminë e Pejgamberit, për të nxjerrë një vëlla mysliman nga vështirësia. Ky është njëri prej shembujve që duhet të mendohet seriozisht për sa i përket temës sonë.

Myslimanët nuk i besojnë njëri-tjetrit në lidhje me borxhet pa kamatë që mund të marrin ndërmjet tyre, sepse borxhet që jepen për një kohë të caktuar, nuk

paguhen në kohë dhe nuk respektohen rregullat e borxhit që shprehen qartazi në ajetin e dyqindetëdhjetëditë të sures el-Bakara dhe i cili është ajeti më i gjatë i Kuranit Fisnik, si përcaktimi i sasisë së borxhit kur merret dhe kur jepet, të shkruarit e tij dhe dëshmia nga dy dëshmitarë burra etj. Ne i dimë shumë mirë pasojat e trishtueshme të atyre që nuk e respektojnë ditën e fundit të pagesës që duhet të bëjnë në bankë. Përse myslimanët nuk ua paguajnë borxhin në kohën e duhur vëllezërve të tyre në fe, ndërkohë që shfaqin kujdes dhe përpjekje të madhe për të mos u ikur dita e fundit të pagesës në bankë? Kjo është e pakuptueshme. Rindërtimi i vakëfeve të parave, që gjyshërit tanë kanë formuar në të kaluarën, për t’i bashkuar fort myslimanët njëri me tjetrin dhe për t’u dhënë borxh atyre që ishin në vështirësi e që kishin nevoja urgjente për ndonjë aksident apo sëmundje, është shumë i domosdoshëm, në mënyrë që njerëzit të shpëtojnë nga fatkeqësia e borxhit.

Shumë myslimanë nuk shpëtojnë dot nga bataku i kamatës dhe e humbasin kështu shtëpinë, makinën, dyqanin dhe çdo gjë të tyre, madje edhe jetën. Në këtë çështje kanë përgjegjësi myslimanët e pasur, që nuk u ndihmojnë vëllezërve të tyre në vështirësi dhe ata që e shkatërrojnë ndjenjën e besimit në shoqërinë myslimane, duke mos e paguar borxhin që kanë marrë.

Pa u tharë bataku i kamatës, nuk mund të ketë bujqësi frytdhënëse, tregti fitimprurëse, ushqim hallall dhe ekonomi dinamike. Tregtarët myslimanë, që shtrëngohen në dyqane disa metra katrorësh, duhet ta lënë mentalitetin “pak, ama e imja”, të bashkohen me njëri-tjetrin dhe të hapin punishte apo markete më të mëdha. Nëse bashkohen punishtet apo marketet, mund të hapin edhe fabrika më të mëdha. Po ashtu, tre-katër shokë mund të bashkohen dhe të blejnë makinë pa u futur në kamatë. Në këtë mënyrë, mendoj se mund të shpëtojmë nga shtypja e çarqeve të kapitalizmit të pamëshirshëm dhe nga rënia në vepra haram, siç është kamata. Të gjitha këto që thamë, kanë lidhje me zbatimin e përpiktë të ibadetit të huasë së mirë.

Allahu i Madhëruar na mundësoftë të jetojmë të bashkuar e të fortë dhe të bëjmë një jetë të qetë, duke fituar pëlqimin e Tij. Po ashtu, na mbrojtë nga kundërshtimi i urdhrave të Tij! Amin!



MËSIMET E KORONËS

— Doç. dr. Fërat Erdoan —

Në fakt, është një temë që gjendet në rendin e ditës që nga janari: Epidemia e njohur. Megjithatë, të gjitha llojet e mediave, kanaleve të lajmeve dhe komenteve kanë shkruar aq shumë për këtë temë, sa që ne vendosëm të mos përfshihemi në deklarata që nuk e kalojnë nivelin e zhurmës.

Konkluzioni: Dëgjuam një zë nga çdo kokë, dhjetëra parashikime nga çdo gojë dhe një epidemi që qeshte me këto.

Kujtuam gjithashtu historitë epidemike që rrënuan botën një herë çdo shekull. Shpresoj që jo, por nëse një gjë e tillë do t'u ndodhë nipërve tanë njëqind vjet më vonë, le të kemi parasysh atë që na mbetet në mendje që ata të kenë një ide për këtë çështje.

Duke qenë se jeta e vërtetë është ahireti (jeta tjetër), është e nevojshme të merren mësim për ahiretin. Le të kthehemi në fushën tonë, duke ua lënë në dorë specialistëve çështjet e tilla si pafuqia jonë, dobësitë tona në përgatitje dhe paaftësinë tonë.

Sipas mendimit tim modest, mesazhi më i rëndësishëm është se informacioni «jo autentik dhe i pabazë» nuk duhet të besohet. Kush ka folur në televizor nga mëngjesi deri në mbrëmje?

Në fillim mjekët e pakualifikuar që nuk kishin asnjë cilësi tjetër përveç popullaritetit. Le të fillojmë

me mjekët që nuk kanë arsim tjetër përveç specializimit të kardiologjisë, por që japin këshilla ushqimore dhe u japin përfitime të tjerëve me çdo fjalim, dhe nga mjekët që kanë punuar në shkencat bazë gjatë gjithë jetës së tyre e që nuk e kanë prekur pacientin, por që kanë profetizuar në lidhje me racat, në mënyrë që të mos i thumbojmë kolegët tanë dhe t'i fusim të gjithë në një thes.

Për fat të mirë, këta kolegë dhe paralelet e tyre, tregtarët e barishteve, rrënjëve dhe prodhimeve të detit, u rrëzuan shumë shpejt.

Meqenëse mjekët e lidhur me këtë temë punonin sinqerisht, këtë herë u shfaqën miq pjesërisht të lidhur që ndoqën thirrjen «Lërinë ata që flasin». Nuk kishte asgjë negative në ato që thanë, por ajo që ne nuk mund të kuptonim ishte se si këta miq e dinin për një virus «të ri», të mutuar, edhe kur sistemi ynë i mrekullueshëm imunitar nuk e njihte atë.

Mësimi i parë që morëm: Nëse ka sëmundje/shpërthim mikrobial, le të flasin infektologët dhe ekspertët e sistemit të prekur nga mikrobi. Duhet të zgjidhen ata që janë vendas dhe kombëtarë dhe që nuk kanë marrëdhënie sekrete apo të hapura me industrinë farmaceutike.

Ne jemi një umet që e kemi nisur rrugën me urdhër për t'u konsultuar me njerëzit e ditur.

Gjëja që duhet të bëjë natyrshëm umeti ynë, zakoni i të cilit është konsultimi dhe këshillimi, është krijimi i një komiteti shkencor.

Ashtu ndodhi, shumë mirë u bë, faleminderit Zotit. Për shkak se njohja e mikrobit nuk mjafton, është e nevojshme të njihen/parashikohen lloji dhe modelet e tij të veprimit. Ndonjëherë kur libri thotë tre, duhet të thuash pesë. Sepse njerëzit pyesin: «Zotëri, a nuk ka ndonjë pjesë pazarrllëku kjo periudha e karantinës?..»

Mësimi i dytë; duhet të jetë rikujtimi përsëri i disa përkufizimeve.

Në vendin tonë, kur praktikatat e mjekësisë moderne ishin të pamjaftueshme ose mendohej se ishin të papërshtatshme, u bë i famshëm një koncept: “Mjekësia Alternative”. Fjala alternativë, që do të thotë «opsion, mundësi», ishte një zgjedhje e gabuar në çdo kuptim. Në pacienten tonë me presion të lartë të gjakut, pirja e ujit me limon perceptohej si një opsion përveç rregullimit të stilit të jetesës dhe përmirësimit me ilaçe, kështu që teza jonë, e cila ishte shumë dembele për të marrë ilaçe, duhej të shkonte në urgjencë me një hemorragji cerebrale për shkak të presionit të gjakut pasi kishte pirë 1 litër lëng limoni.

Çfarë ishte e drejtë? Mjekësia plotësuese. She-mbull: Nëse keni pneumoni (nëse është e nevojshme), përdorni antibiotikë, hapës të frymëmarrjes, qetësues dhimbjesh dhe shijoni mjaltin tuaj me xhenxhefil. Lërinë të dy të plotësojnë njëri-tjetrin, inshallah do të ketë shërim. Por nëse thua se mora opsionin e manaferrës së zezë, jo opsionin e ilaçit, dhe kështu formoni një «alternativë», do të përfundoni në njësinë e kujdesit intensiv (urgjencë).

Kur njerëzit që preferonin mjekësinë alternativë (disa janë mjekë, disa janë çirakë të barishteve) kaploheshin nga temperatura e lartë, zgjidhnin mjekët e vërtetë në spitale dhe ilaçet që janë një mirësi dhe bekim i Zotit tonë Shërues. Këshilla jonë për

nipërit tanë të ardhshëm është që: “Ta lënë mjekrën në kohën e duhur.”

Mësimi i tretë: Është një tjetër manifestim i dispozitës “Kurani është shërues”. Ajeti i 59-të i sures Nisa thotë: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni Pejgamberit dhe prijësve nga mesi juaj!”** Në përkthimin e ajetit thuhet se “Ulu’l-Emri» është një term që përshkruan administratorët më të lartë dhe njerëzit me autoritet shoqëror në shoqërinë islame. Ne i dëgjuam fjalët e drejtuesve që mendo-nim se ishin prej nesh dhe u rehatuam e u bëmë të lakmueshëm. Në fakt, kemi vërejtur se do të shohim ditë më të mira kur të shpëtojmë nga kjo situatë dhe të kthehemi te thelbi ynë në çdo çështje.

Ne gjetëm një dispozitë të lidhur indirekt me aspektin e shëndetit nga surja Huxhurat. A janë të sakta lajmet dhe mesazhet që na vijnë? A është i saktë dërguesi? A shikuar nëse qëllimi është i mirë. Ne nuk i përhapëm lajmet që shkaktojnë ankth dhe panik, që mund të ishin shumë më shkatërrues se virusi, dhe kështu gjetëm pagën.

Feja jonë na urdhëron të përqendrohemi në «zarurati aslije – nevojat themelore». Dy prej tyre nënkuptojnë investime në shërbimet shëndetësore, në çdo kuptim. Ata që e dëgjuan këtë, u mjaftuan shtretërit e spitalit. Fatkeqësisht, situata e atyre që shfrytëzonin mundësitë e tyre për prioritete të tjera, ishte e mjerueshme.

Fatkeqësisht, nuk mundëm t’i merrnim disa më-sime pavarësisht nga kjo fatkeqësi. Ndërsa një grup mendoi për një “vaksinë të re” sapo dëgjuan emrin e sëmundjes apo mikrobit të ri, një grup tjetër nuk mundi ta pranonte përdorimin e barnave të reja kundër virusit “të ri” korona.

Zoti (xh.xh.), na ruajtë nga përsëritja e kësaj sëmundjeje! I mëshiroftë ata që kanë ndërruar jetë, u dhëntë durim të tjerëve që jetojnë dhe u dhëntë mend atyre që ende nuk kanë marrë mësim!

Mirë mbetshi!



TË PENGOSH NGA RRUGA E ALLAHUT

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Duke u nisur nga ajeti fisnik, në të cilin thuhet: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Dharijat, 56), theksohet se dinjiteti i njeriut buron nga pozita e tij si rob ndaj Allahut Teala. Dinjiteti i njerëzimit është dinjiteti që merret nga adhurimi ndaj Zotit (xh. sh.). Për këtë arsye, del në pah se respekti i vërtetë ndaj dinjitetit njerëzor është që njeriut t’i jepet mundësia për ta zbatuar obligimin e adhurimit ndaj Allahut Teala dhe asnjëherë të mos i vendoset atij ndonjë pengesë në lidhje me këtë çështje. Duhet të përpiqemi të tregojmë se çdo lloj përpjekjeje për ndërhyrje te dinjiteti njerëzor është “pengim në rrugë të Allahut”

dhe krim shumë i madh. Këtë do përpiqemi ta bëjmë duke paraqitur edhe ajetet fisnike në lidhje me këtë çështje. Por duke marrë parasysh vëllimin e shkrimit, do përpiqemi ta shtjellojmë temën në dy shkrime të ndara si Natyra e “Saddun an sebilillah” dhe “të pengosh nga rruga e Allahut”.

NATYRA E “SADDUN AN SEBILILLAH”

Para së gjithash, do të ishte shumë e dobishme që të nxjerrim në pah karakteristikën kryesore të krimit “Të pengosh nga rruga e Allahut”. Ajetin fisnik në lidhje me temën e gjejmë ndërmjet përgjigjeve që i Dërguari i Allahut (a.s.), ur-

dhërohet t'i japë një pyetjeje e cila i bëhet atij rreth praktikimit të "muajve haram / muajve të shenjtë" që ishin të praktikueshëm edhe në shoqërinë e in-jorancës para ardhjes së Islamit.

Në vitin e parë të periudhës së Medines, i Dërguari i Allahut, (a.s.), përgatiti një njësi ushtarake nën komandën e Hz. Abdullah b. Xhahshit dhe e dërgoi në anët e Mekës. Kjo njësi ushtarake rastisi në rrugë me një karvan tregtie prej tre vetash që i përkiste mekasve. Në ditën e parë të muajit Rexhep, i cili është njëri prej muajve haram / të shenjtë, Vakid b. Abdullah et-Tejmi vrau me shigjetë përgjegjësin e karvanit, Amr b. El-Hadramin, i cili ishte prej fisit Kurejsh. Pasi e vranë përgjegjësin e karvanit, dy njerëzit e tjerë dhe karvanin i morën dhe i çuan në Medinë. Në të vërtetë, detyra e kësaj njësie ushtarake ishte të vështrojnë mekasit, të mbledhë informacion dhe të njoftonte Medinën. Por ja që ndodhi edhe një ngjarje e tillë.

Nisur nga kjo, politeistët mekas filluan të bënin propagandë duke thënë: "Myslimanët kanë vranë një njeri në muajin e shenjtë." Disa prej myslimanëve që vunë re se nuk u takonte gjë nga plaçka e luftës që iu soll Hz. Pejgamberit, filluan t'u thoshin myslimanëve që ishin me detyrë në atë njësi ushtarake: "Ju keni bërë një punë për të cilën nuk ishit urdhëruar dhe keni vranë një njeri në muajin haram." Ja, pikërisht pas kësaj zbriti ky ajet fisnik:

"Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: "Luftimi në atë kohë është gjynah i madh, por pengimi i njerëzve prej udhës së Allahut, mohimi i Tij, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynah më i madh tek Allahu. Kurse adhurimi i idhujve është gjynah më i madh se vrasja." Ata vazhdimisht do të luftojnë kundër jush, që të mund t'ju kthejnë nga besimi juaj. Ata që e mohojnë fenë dhe vdesin si mohues, - veprat e tyre (të mira) do të humbasin në këtë botë dhe në tjetrën. Ata do të jenë banorë të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë." (Bakara, 217)

Në këtë ajet fisnik bëhet e qartë se pengimi i njerëzve në përgjithësi dhe i besimtarëve në veçanti nga rruga e Allahut Teala është mëkat /padrejtësi më e madhe se **"mohimi i Allahut, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë, dëbimi i banorëve të saj nga ajo dhe dëbimi i njerëzve nga vendet**

e tyre". Ndërsa e vërteta bazë është shpjeguar në këtë mënyrë: "Sepse fitneja (padrejtësia, anarkia, disfatizmi, shtypja dhe tortura) është mëkat më i madh se vrasja." (Përveç të tjerash shik. Bakara, 191.)

Mbi të gjitha, shprehja **"...Kurse fitneja është gjynah më i madh/më i tmerrshëm se vrasja..."** që përmendet në ajetin fisnik, nxjerr në pah se të gjitha veprat negative që ceken në ajet janë nga një shkak për fitne më të tmerrshme se vrasja e njeriut në shoqëri.

"Pa dyshim, ata që nuk besojnë, (i) pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe vdesin si jobesimtarë, Allahu kurrësi nuk do t'i falë." (Muhamed, 34)

Nga ana tjetër urdhërohet në veçanti që kjo fitne / padrejtësi / mosbesim i rëndë të zhduket nga faqja e dheut: **"Luftojini ata derisa të zhduket mosbesimi dhe derisa të mbretërojë besimi vetëm për Allahun! Por, në qoftë se ata heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë s'ka armiqësi, përveçse kundër keqbërësve."** (Bakara, 193)

Nisur nga kjo që thamë më lart, mund të nxjerrim në pah se fitneja e pengimit të njerëzve në përgjithësi dhe besimtarëve në veçanti nga rruga e Allahut të Lartësuar është një mëkat dhe gjynah më i madh dhe më i rëndë se vrasja e njeriut. Ja, kjo është natyra bazë e të penguarit të njerëzve nga rruga e Allahut.

Ndërkohë që Allahu i Madhëruar e njofton Hazreti Pejgamberin për përgjigjen e nevojshme që duhet t'i jepte propagandës të cilën po e bënin politeistët mekas, edhe mushrikëve, të cilët bërtisnin me të madhe duke thënë kundër myslimanëve se ata kanë vranë në muajin e shenjtë, ua bënë të qartë se krimet që kanë bërë ata janë më të mëdha se kjo. Në të njëjtën kohë, na mëson edhe neve metodën e debatimit, e cila është: Atyre, të cilët nuk flasin për mbrapshtitë që bëjnë vetë, por bëjnë propagandë kundër cilitdo mysliman që bën ndonjë gabim duke ia nxjerrë në pah me shkrim, me fjalë apo me pamje, duhet t'ua kujtojmë në të njëjtën mënyrë gabimet e tyre dhe t'ua nxjerrim përballë.

Në mjedisin e zënkave kulturore të sotme, duhet të zgjedhim metodën e predikimit dhe të mbrojtjes kundër rrymave të brendshme apo të jashtme duke ua nxjerrë në pah mbrapshtitë që kanë bërë ata. Për

ta bërë këtë, sigurisht se duhet të kemi të njëjtat mjete komunikimi dhe korrespondimi.

DIMENSIONI I INVESTIMIT DHE FINANCËS SË “SADDUN AN SEBILILLAH”

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Në të vërtetë, jobesimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për t’i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur. Ata që nuk besojnë do të tubohen në xhehenem.” (Enfal, 36)

Në këtë ajet fisnik, përveç të tjerash, nxirret në pah se veprimi për “të penguar nga rruga e Allahut” është një fushë në të cilën do të “investojnë” qafirët. Shprehja: **“Ata do ta shpenzojnë atë”** pasuri, tregon se në çdo kohë dhe periudhë do të ketë jobesimtarë që do të investojnë përsëri në këtë fushë, edhe pse nuk do të marrin rezultat. Pikërisht në këtë pikë kryqëzohen të vërtetat e djeshme me të vërtetat e sotme, edhe nëse kanë ndërruar emër apo formë. Siç rezultuan me pishmanllëk dhe pendim paratë dhe investimet që të parët e politeistëve mekas dje bënë për armatimin, ushqyerjen dhe strehimin e ushtrisë politeiste në luftën e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut, është e qartë se edhe qafirët e sotëm apo të nesërm, që ndjekin të njëjtën rrugë, nuk do të arrijnë gjë tjetër përveçse pendim dhe dështim. Atëherë, të gjithë duhet të kenë shumë kujdes në çështjen se kujt i ndihmojnë, kë mbështesin, në cilën fushë bëjnë investime dhe financimin e kujt kanë marrë përsipër. Kjo është shumë e rëndësishme për të mos u bërë pjesë e investimit të mohuesve të Zotit.

NJË THIRRJE PËR TË GJITHË SHEKUJT

Ajeti fisnik i mëposhtëm që zë vend ndërmjet fjalive paralajmëruese të cilat ia tha popullit të tij Hz. Shuajbi, i cili ishte i dërguar si Pejgamber për popullin e Medjenit, është një thirrje për të gjithë shekujt kundrejt atyre që tentojnë t’i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut Teala. Ngaqë kjo thirrje përmendet në Kuranin Fisnik, është e vlefshme njësoj edhe në periudhën e Islamit, sepse rregullat e vlefshme për popujt e mëparshëm janë të vlefshëm edhe për ne

kur të përmenden dhe aprovohen nga Allahu apo i Dërguari i Tij. (Sher’u men kablena sherr’un lena idha kassahu’llahu ve resuluh.)

Allahu Teala thotë: **“Mos zini pusi në çdo rrugë, duke frikësuar dhe penguar nga rruga e Allahut ata që besojnë tek Ai dhe duke kërkuar shtrembërimin e saj! Kujtoni atëherë kur ishit të paktë në numër e Ai ju shumoi. Shikoni si përfundojnë ngatërrestarët!”** (A’raf, 86)

“Mos u bëni si ata (jobesimtarët e Mekës) **që dolën nga shtëpitë e tyre me mendjemadhësi e për sy e faqe të botës, duke dashur t’i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut. Allahu e di mirë çfarë punojnë ata.”** (Enfal, 47)

Thirrja: “Mos zini pusi në çdo rrugë...”, sigurisht se nuk është vetëm për pusitë materiale, por është një thirrje që përfshin edhe pusitë autoritare, administrative, materiale dhe shpirtërore që japin mundësinë e ndikimit në shoqëri.

DIMENSIONI I NDËSHKIMIT TË “SADDUN AN SEBILILLAH”

Krimi i pengimit të njerëzve nga rruga e Allahut Teala sigurisht se ka një ndëshkim.

Ndëshkimet në këtë botë radhiten si pishmanllëk, mosarritje e synimit, dështim i plotë dhe devijim i thellë. Edhe në dy ajetet fisnike të mëposhtme, veçanërisht për ndëshkimet në ahiret, njoftohet se do të jenë “mosfalje” dhe “ndëshkim mbi ndëshkim”.

“Pa dyshim, ata që nuk besojnë, (i) pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe vdesin si jobesimtarë, Allahu kurrsesi nuk do t’i falë.” (Muhamed, 34)

“Atyre që mohojnë dhe i pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut, Ne do t’u shtojmë dënim mbi dënim, sepse kanë bërë ngatërresa.” (Nahl, 88)

Këto ndëshkime që përmenden në ajetet fisnike tregojnë padrejtësinë e madhe të cilën e bën ai person apo ato grupe që tentojnë t’i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut me çfarëdo metode qoftë.

Për këtë arsye, ata të cilët tentojnë t’i pengojnë nga rruga e Allahut Teala besimtarët në veçanti dhe njerëzit në përgjithësi, duhet t’i rishikojnë edhe një herë ato që bëjnë vetë, duke i marrë parasysh jo vetëm ndëshkimet në këtë botë, por edhe ato në botën tjetër dhe duhet të heqin dorë menjëherë nga veprimet e tyre. Në të kundërt, pendimi i tyre kur të dalin në audiencën e Allahut, absolutisht nuk do t’u bëjë dobi.

“Atyre që mohojnë dhe i pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut, Ne do t’u shtojmë dënim mbi dënim, sepse kanë bërë ngatërresa.”
(Nahl, 88)

SAHABIU I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

ABDURRAHMAN IBN XHEBRI

— Mustafa Erish —

Abdurrahman ibni Xhebri, (r.a.), ishte prej sahabëve që i Dërguari i Allahut, (a.s.), u pati dhënë detyra të veçanta.

Ai ishte njëri prej heronjve që pati detyrë në çështjen e ekzekutimit të njërit prej poetëve të njohur çifutë, Ka'b ibni Eshrefit, i cili ofendonte myslimanët dhe në veçanti të Dërguarin e Allahut, alejhi's-salatu ve's-salam.

Ai ishte prej njerëzve të rrallë dhe që dinin këndim e lexim që para Islamit.

Lindi dhe u rrit në Medine. U përkiste Beni Harithëve prej fisit Evs. Para ardhjes së Islamit, emrin e kishte Abdu'l-Uzza. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ia ndërroi në Abdurrahman. (Usdu'l-Gabe, III, 428.)

Ai ishte prej sahabëve që përmendej më shumë me llogarin se sa me emrin e tij. Llagapi i tij është Ebu Abs.

Pasi Abdurrahman ibni Xhebri, (r.a.), pranoi Islamin, u përpoq shumë që edhe fisi i tij të bëhej mysliman. Atyre u tha se mendimet që kishin në kokë, ishin të gabuara. Ua shpjegoi se adhurimi i verbër i idhujve, nuk ka ndonjë dobi. U përpoq t'u tregonte paaftësinë e idhujve.

Për këtë arsye, bashkëpunoi me shokun e tij më të ngushtë Ebu Burden, (r.a.). I theu idhujt natën, i hodhi në vende të papastrat dhe e tronditi besimin e popullit ndaj tyre.

Beni Harithët e panë se sa të dobët dhe të paftë ishin idhujt që u besonin. Ata dëshmuan se idhujt nuk mund të ndalonin as dëmin që mund t'u ndodhte atyre vetë.

Ata kuptuan se rruga që ndiqnin ishte e gabuar. Pastaj filluan të bëheshin myslimanë një nga një e dy nga dy. (Isabe, VII, 222.)

Ebu Abs Abdurrahman ibni Xhebri, (r.a.), nuk u largua asnjëherë nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), në mënyrë që të përfitonte sa më shumë prej Tij. Për një kohë, qëndroi në xhami bashkë me as'habu's-suffe.

Ai ishte prej heronjve të patrembur. Mori pjesë në të gjitha betejat, si Bedri, Uhudi, Hendeku etj. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pa trimërinë e guximin e tij dhe i dha detyrë të veçantë bashkë me Muhamed ibni Mesleme, (r.a.). E futi në grupin prej katër vetash, i cili u formua për të vranë Ka'b ibni Eshrefin.

Ka'b ibni Eshrefi ishte poeti i çifutëve Beni Kurejdha. Ai shkruante poezi plot ofendime për të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe për myslimanët. I ndihmonte politeistët kundër myslimanëve. Qau për politeistët e vranë në luftën e Bedrit dhe shkroi poezi për ta. Pastaj shkoi në Mekë dhe i organizoi politeistët kundër myslimanëve duke i nxitur.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u mërzit shumë kur dëgjoi për ofendimet dhe fjalët e këqija që Ka'b ibni Eshrefi kishte shkruar për Të. U mërzit aq shumë, sa që i tha Hasan ibni Thabitit:

“Çfarë i kemi bërë ne këtij çifuti? Shiko se çfarë po na bën, o Hasan.” (Vakidi, Megazi, I, 187.)

Allahu Teala dha leje për vrasjen e këtij çifuti, i cili e lëndonte shumë të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Deri atë kohë, akoma nuk ishte shpallur sureja et-Teube. (Istiab, II, 827.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, tek po qëndronte me sahabët, e shprehu përsëri shqetësimin e Tij dhe pyeti: *“Kush do të më shpëtojë mua nga gjuha e Ka'bit?”* Muhamed ibni Mesleme u ngrit menjëherë nga vendi dhe tha: *“Unë, o i Dërguari i Allahut!”*

Pasi Muhamed ibni Seleme, (r.a.), e mori këtë detyrë, mendoi dhe bëri plane për ditë të tëra, sepse çifuti Ka'b ibni Eshref jetonte brenda një kalaje të sigurt. Nuk ishte shumë e lehtë për të depërtuar deri te ai. Formoi një grup prej katër vetash. Bashkë me ta hyri në kala dhe e vranë Ka'b ibni Eshrefin. (Muslim, Xhihad, 119.)

Ebu Abs Abdurrahman ibni Xhebri, (r.a.), ishte i varfër. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i kishte urdhëruar sahabët të përgatiteshin për luftën e Hajberit. Ebu Absi filloi të mendohej thellë. Si do të dilte në xhihad? Sigurimi i të ardhurave të familjes ishte detyrë e tij. Familjen e kishte në gjendje të vështirë. Shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tregoi për gjendjen dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Nuk kam ushqim, nuk kam rroba dhe asgjë prej gjëje që t’ia lë familjes, në mënyrë që të dal në luftë.”

I Dërguari i Allahut, sallallahu elbi ve sellem, i dha atij një rrobë. Ebu Absi menjëherë shkoi në treg. Rrobën e shiti për tetë dirhemë. Me gjysmën e tyre bleu një rrobë tjetër. Dy dirhemë ia la familjes si para, ndërsa me pjesën tjetër bleu ushqim. Pastaj i hipi kalit dhe iu bashkua ushtrisë.

Në errësirën e natës, kishte kaluar para ushtrisë.

Të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i kishte rënë në sy. Menjëherë kishte pyetur sahabët që kishte pranë:

“Kush është ky që ecën përpara?”

I thanë: “Është Ebu Abs ibni Xhebri.” I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salatu ve’s-salam, u tha: *“Shkoni dhe ndalojeni!”*

Vazhdimin e ngjarjes e tregon vetë Ebu Absi, (r.a.):

“Kur më arritën nga prapa dhe më ndaluan, u frikësova dhe thashë në vetvete: Mos vallë kam bërë ndonjë gabim pa e ditur? A thua ka zbritur ndonjë ajet për mua? Menjëherë i hodha një sy jetës sime. Pas pak erdhi i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe më pyeti:

“Përse ec para ushtrisë dhe nuk ec bashkë me të?”

Unë iu përgjigja:

“O i Dërguari i Allahut! Kali im është një kalë i shpejtë. Kështu që s’po mundem ta ndaloj.”


Ai, (a.s.), më pyeti përsëri:

“Ku e ke rrobën që ta dhashë?”

Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! E shita për tetë dirhemë. Me katër dirhemë bleva këtë rrobë, ndërsa me dy dirhemë të tjerë bleva ushqim për rrugën. Dy dirhemët që ngelën ia lashë familjes si para.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), buzëqeshi dhe e shprehu kështu kënaqësinë e Tij:



“O Eba Abs! Për Zotin, unë e di gjendjen tënde dhe të familjes tënde. Jeni të varfër dhe keni nevojë. Por betohem për Allahun në dorën e të cilit është jeta ime se, nëse e ruan këtë gjendje dhe jeton duke u mjaftuar me pak, do të të shtohet ushqimi dhe do të ketë begati ajo që ke lënë te familja.”

Pastaj Pejgamberi (a.s.), vazhdoi: *“Do t’ju shtohen dirhemët dhe shërbëtorët, por kjo nuk është e mirë për ju.”*

Ebu Absi tha: *“Çdo gjë ndodhi ashtu siç pati thënë i Dërguari i Allahut, (a.s.).”* (Vakidi, Magazi, II, 635-636.)

Shtëpia e Ebu Absit, (r.a.), ishte shumë larg xhamisë. Megjithatë, ai i falte namazet me xhemat në Xhaminë e Profetit (a.s.). Në fund të jetës së tij, sytë iu verbuan dhe u plak shumë.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), e pa se ai kishte shumë vështirësi për të ardhur dhe për t’u larguar nga xhamia, i dhuroi një shkop dhe i tha: *“Gjeje rrugën me këtë.”* (Isabe, VII, 222.)

Hadithet e Ebu Absit, (r.a.), janë transmetuar në librat e Buharit, Tirmidhiut dhe Nesaiut. Një hadith i transmetuar në “Rijadu’s-Salihin” është kështu:

Sipas transmetimit të Ebu Abs Abdurrahman ibni Xhebr, (r.a.), i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Zjarri i xhehenemit nuk e prek një rob, të cilit i janë pluhurosur këmbët në rrugë të Allahut.” (Buhari, Xhihad, 16. Veçanërisht shih. Tirmidhi, Fedailu’l-Xhihad, 7; Nesai, Xhihad, 9.)

Përparimi në çdo rrugë që hyhet me dëshirën për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala, ka një shpërblim të madh tek Ai.

Kjo rrugë mund të jetë një rrugë për të mësuar dije, për të falur namaz me xhemat, për të vizituar të sëmurët apo për të varrosur xhenazen. Kjo është e vërtetuar me tekste autentike se secila prej këtyre ka sevap të madh. Por kur në arabisht thuhet “ecje në rrugë të Allahut”, pa ndonjë gjë që e shpjegon, kuptohet si shkuarje në xhihad.

Pluhurosja e këmbëve është një mënyrë shpjegimi figurative, që shpreh ecjen në një rrugë dhe lodhjen për hir të një pune. Sigurisht se udhëtimi për në xhihad për të përhapur fenë e Allahut dhe për lartësimin e fjalës së Tij, është më i rëndësishmi.

Ebu Abs Abdurrahman ibni Xhebr, (r.a.), ndërroi jetë në moshën shtatëdhjetëvjeçare, në vitin 34 (634) dhe u varros në varrezat Baki. Namazin e xhenazes së tij e fali Halifja Umer ibn el-Hattabi, (r.a.).

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu na mundësoftë të gjithëve të marrim mësim dhe të përfitojmë sa më shumë nga jeta e këtij sahabiu të nderuar! Amin!





A ËSHTË FËMIJA JUAJ GATI PËR TË FILLUAR SHKOLLËN?

— Psig. Tuba Sokmen —

Mosha në të cilën fëmija e fillon shkollën është shumë e rëndësishme. Të gjithë ne jemi dëshmitarë të familjeve që nuk janë të vendosur për moshën në të cilën do ta dërgojnë fëmijën në shkollë. Problemi më të madh e jetojnë fëmijët e lindur në mes muajve mars dhe shtator. Prindërit e këtyre fëmijëve e kanë shumë të vështirë të vendosin për moshën në të cilën fëmija duhet të fillojë shkollën. Prindi nga njëra anë ka frikë se mos do ta vonoj pa arsye fëmijën, duke e lënë të pres edhe një vit por nga ana tjetër ka frikë se mos fëmijë nuk është akoma gati për të filluar shkollën. Për t'i dhënë një zgjidhje sa më të saktë këtij problemi prindërit duhet të kenë njohuri të thelluara në lidhje me atë që quhet: “pjekuria shkollore”.

Nuk duhet të harrojmë për asnjë moment që siguria me të cilën e fillon shkollën fëmija, do të ketë një rol shumë të rëndësishëm në të gjithë jetën e tij akademike. Prandaj duhet bërë shumë kujdes në

zgjedhjen e moshës në të cilën fëmija fillon klasën e parë.

“Pjekuria shkollore” llogaritet me mjaftueshmërinë që tregon fëmija në fusha të ndryshme. Këto fusha kanë të bëjnë me zhvillimin e gjuhës, ndjenjave, mendjes dhe fizikut... Një mënyrë tjetër për të kuptuar pjekurinë e fëmijës është edhe konsultimi me njerëz profesionistë.

Një fëmijë që pretendohet se ka mbërritur moshën e pjekurisë shkollore duhet të jetë në gjendje që të shpjegojë me fjalë nevojat dhe dëshirat e veta. Gjithashtu ky fëmijë duhet të arrijë t'i kuptojë gjërat që i thuhet. Fëmija duhet të di përmendësh disa këngë për fëmijë dhe të jetë në gjendje që t'i artikulojë fjalët pa problem. Ai duhet të jetë në gjendje që të tregojë një histori të shkurtër me fjali të renditura me rregull dhe duhet të jetë i zoti të shpjegojë funksionin e një sendi me fjalë. Fëmija duhet të jetë i

mësuar që të dëgjojë bashkëbiseduesin teksa i flet dhe të pres radhën për të folur.

Fëmija që ka arritur pjekurinë e të lexuarit duhet të filloj të ketë interes për shkronjat. Ai duhet ta njoh emrin e vet të shkruar ose të mundohet që ta shkruajë atë. Ai duhet të ketë interes për librat e fëmijëve dhe të dijë disa gjëra elementare si: fillimin e librit nga e majta, numrat e faqeve dhe rreshtimin e fjalëve nga e majta në të djathtë. Fëmija duhet të jetë në gjendje që të formojë një histori të shkurtër duke shikuar figurat e librit.

Zhvillimi i mendjes është shumë i rëndësishëm për pjekurinë shkollore. Fëmija duhet t'i njohë ngjyrat dhe konceptet kryesore. Ai duhet të jetë në gjendje që t'i rreshtojë gjërat duke u bazuar tek madhësia e tyre, duhet t'i dijë konceptet e kundërta. Fëmija duhet të dijë që t'i përdor saktë fjalët e vendit dhe të kohës si: poshtë, lart, brenda, jashtë, sot, nesër, etj. Ai duhet ta kuptojë lidhjen që ekziston mes pjesëve dhe të tërës, duhet të di që të plotësojë një puzzle (mozaik enigme) të vogël. Fëmija duhet t'i njohë figurat gjeometrike si rrethi, katrori, trekëndëshi; dhe duhet të ketë aftësinë që t'i riprodhoj ato me shkrim. Fëmija duhet të jetë në gjendje që të përqendrohet në momentin kur përballet me një pengesë në punën që është duke bërë. Ai duhet të plotësojë një kërkesë të përbërë nga të paktën tre pika, për shembull: 'mbylle dritaren, vendose lapsin në vend dhe më sjell një gotë ujë'. Fëmija duhet të jetë kurioz në lidhje me gjërat që nuk i di dhe duhet të ketë dëshirë për të mësuar gjëra të reja.

Dëshira për socializim është po aq e rëndësishme sa zhvillimi i mendjes. Fëmija duhet të mësohet që t'i përshëndes njerëzit e njohur. Ai duhet të dijë rregullat themelore të sjelljes me njerëzit më të mëdhenj dhe më të vegjël se vetë ai. Fëmija duhet të dijë të kërkojë ndihmë në një çast nevojë dhe duhet të dijë se ku të drejtohet për të marrë një ndihmë sa më efikase. Ai duhet të jetë i gatshëm për t'i ndarë gjërat e veta me të tjerët dhe duhet të jetë i gëzuar kur kalon kohë me moshatarët e vet. Fëmija duhet të jetë në gjendje që të qëndroj i qetë edhe larg nënës dhe babait. Ai duhet të dijë të përgjigjet kur e pyesin për emrin, moshën apo emrin e lagjes ku banon. Fëmija duhet të jetë i mësuar me lëvizjet në grup dhe me të folurit me zë normal, pa bërtitur.

Një fëmijë që do të filloj shkollën duhet të jetë në gjendje që t'i kryejë vetë nevojat personale, pa

kërkuar ndihmë prej të rriturve. Ai duhet të shkojë vetëm në banjo, të lajë duart dhe dhëmbët, të përdor pirunin dhe thikën për të ngrënë. Fëmija duhet të di si të vesh këpucët dhe rrobat e veta pa marrë ndihmë nga prindërit.

Aftësia e tij manuale duhet të jetë në atë pikë sa të jetë në gjendje ta mbajë gërshërën dhe lapsin në mënyrë të duhur. Ai duhet të dijë që t'i koordinoj gishtat e veta në momentin që mban lapsin në dorë. Fëmija duhet ta pres topin që i hidhet ngadalë. Ai duhet të ketë aftësinë për të qëndruar me një këmbë për të paktën 5 minuta, për të mbërritur në një vend

të afërt duke kërcyer me një këmbë, për të përdorur të dyja këmbët me rregull teksa ngjitet ose zbret shkallët.

Aftësia e tij manuale duhet të jetë në atë pikë sa të jetë në gjendje ta mbajë gërshërën dhe lapsin në mënyrë të duhur. Ai duhet të dijë që t'i koordinoj gishtat e veta në momentin që mban lapsin në dorë.

Fëmija që ka arritur një nivel të pjekurisë emocionale duhet të dijë të përballojë humbjen me durim dhe të mos llastohet. Ai duhet të jetë i hapur ndaj kritikave dhe qortimeve. Ai duhet t'i njohë ndjenjat e veta dhe të mundohet që t'i kuptojë edhe ndjenjat e të tjerëve. Fëmija duhet t'i ndihmojë njerëzit që i kërkojnë ndihmë dhe duhet t'i pranoj përgjegjësitë e veta. Punën që i jepet duhet ta kryejë i vetëm dhe me dëshirë. Fëmija duhet të mësoj që jo çdo kërkesë i plotësohet në moment. Për shembull ai duhet të mësoj që të pastroj dhomën e vet nëse ka dëshirë që të shikoj një film vizatimor.

Të gjitha këto fusha mund të duken shumë të ndryshme me njëra-tjetrën por në fakt duhen shikuar si një e tërë. Fëmija duhet të ketë arritur pjekurinë në të gjitha këto fusha për t'u ndjerë i gatshëm për të filluar shkollën. Pjekuria e pjesshme nuk është e mjaftueshme për të ndihmuar fëmijën në vitin e parë të shkollës. Çdo prind duhet ta studiojë mirë fëmijën e vet përpara se të marr vendimin për ta dërguar në klasë të parë. Në rastin kur fëmija e ka kaluar moshën normale të fillimit të shkollës por nuk i plotëson kushtet e sipërpërmendura, është mirë që të kontrollohet nga një specialist i fushës. Nëse profesionisti gjykon që fëmija nuk është i gatshëm që të filloj shkollën, është në të mirën e fëmijës që të bëhet një shtyrje një vjeçare.

Urojmë që hapat e para shkollore të fëmijëve tonë të jenë të mirë-peshuar dhe të suksesshëm...

TAKVAJA ËSHTË SISTEMI IMUNITAR I SHPIRTIT

— Fatma H. Saëm —

Të mos i ndyesh rrugët apo xhamitë është “**tak-va**”, pra devotshmëri. Mbajtja pastër e tyre është “**vepër devotshmërie**”.

Të mos u thuash prindërve as “uf” është “**tak-va**”. T’ua fitosh zemrën duke u thënë atyre fjalë të bukura, është “**vepër devotshmërie**”.

Të mos flasësh për njerëzit e tjerë dhe të mos shpifësh është “**takva**” (devotshmëri); t’u flasësh njerëzve fjalë të bukura siç e kërkon feja, është “**vepër devotshmërie**”.

Kur bëhet fjalë për “**takvanë**”, përballemi me një rrëmujë konceptesh. Ka nga ata që të tepruarit në praktikimin e fesë e pandehin takva (devotshmëri). Ka nga ata që takvanë e pandehin të kaluarit e gjithë natës me adhurim, ditës me agjërim, lexim Kurani dhe dhikër, si dhe të qëndruarit larg bashkësorëve për të edukuar nefsën e tyre. Në të vërtetë asgjë më pak apo më tepër nga syneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nuk është takva. Takva është ndjekja e synetit ashtu siç është, sepse në lidhje me këtë Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

*“Unë e njoh më mirë se të gjithë
Allahun dhe i frikësohem më
shumë Atij; megjithatë natën
fle, por një në një pjesë të
saj bëj edhe adhurim.*

*Martohem dhe
p e r m -*

bush detyrat ndaj bashkësorës; përveç kësaj ka edhe ditë që agjëroj. Kush vepron ndryshe nga unë në këtë çështje, nuk është prej meje.” (Shik: Buhari, Nikah, 1.) Për këtë arsye takva (devotshmëria) nuk është ibadet i tepërt.

Gruaja nuk e fal namazin me shaminë që ka vënë kur ka dalë jashtë shtëpisë duke menduar “Këtë shami e kanë parë sy të huaj”, por e fal namazin me një shami të cilën nuk e ka parë asnjë burrë dhe këtë e quan takva. Gratë sahabije dhe bashkësorët e Pejgamberit nuk kishin shami të markave ashtu siç kemi ne, madje nganjëherë kishin vetëm një veshje. Këtë sjellje të cilën sahabet e nderuara dhe gratë e Pejgamberit (a.s.) nuk e kanë praktikuar si vepër devotshmërie, nuk është e drejtë që ne ta shohim sitë tillë.

Ka edhe nga ata që e konsiderojnë takva drejtimin e gishtit të madh të këmbës drejt kibles gjatë namazit.

Disa e konsiderojnë takva vetëm të frikësuarit ndaj Allahut. Këtu mund të themi se koncepti nuk është gabim, por është i mangët. Nuk mund ta përmbledhim çështjen “vetëm me ndjenjën e frikës”, sepse nëse do të shqyrtonim se nga kush frikësohemi, tabloja me të cilën do të përballemi, është e frikshme. Nëse mendojmë, ne frikësohemi nga hajdutët, nga vrasësit, nga përdhunuesit, mizorët, shpifësit. Njerëzit, ata të cilët i kanë frikë, në të njëjtën kohë edhe i urrejnë. Gjërat që veprojnë, i bëjnë vetëm nga frika e personit dhe kur ngelin

vetëm për vetëm me vullnetin e tyre, bëjnë krejt të kundërtën. Njeriu në të njëjtën mënyrë dëshiron që personi të cilin ka frikë, të zhduket. Ndërsa gjërat që kërkon ai të cilin e do do, i zbaton me shumë dëshirë dhe ka frikë se mos humbet dashurinë e tij. Ja pra, takva është më afër kësaj “frike”.

Ne e dimë shumë mirë se as në “Esmā-i Husnā”, as në cilësitë e Allahut nuk ekzistojnë veçori të tilla që bartin urrejtje. Allahu, xhelle xhelaluh, është Vetë i drejtë. Një Zot emrat dhe cilësitë e të Cilit janë të përsosura, nuk ngjall frikë, por siguri. Prandaj, ta zbresësh takvanë në kuptimin e “Frikës nga Allahu”, është një konceptim i papranueshëm nga Allahu.

Njeriu ka frikë nga ai që e do, ose thënë më drejtë frikësohet se mos e humb e atë që do, se mos e lëndon atë. Personin që duam nuk mund ta gënjejmë. Kur e mërzhisim, nuk mund ta shohim në sy. Brenda këtij konceptimi është edhe përkufizimi i vërtetë i takvasë. Të shqetësohesh se mos nuk do ta shohësh bukurinë e Allahut Teala. Takva është të frikësohesh me mendimin: “*Nëse Allahu nuk më thotë “Robi im!”, si do të më shkojë shkojë halli?*” Në këtë kuptim takva do të thotë “Të frikësohesh dhe të shqetësohesh se mos humb dashurinë dhe faljen e Allahut Teala”.

Nga burimet Islamike thuhet se fjala “takva” e ka prejardhjen nga folja “veka”. Veka do të thotë “*Të mbrosh veten nga gjërat e dëmshme.*” Takva do të thotë të mbrosh veten nga gjërat që e frikësojnë atë. Si koncept është të mbështetesh në një forcë të madhe për t’u mbrojtur dhe të mbrosh veten nga mëkatet. Kjo ndodh vetëm duke u larguar nga harami. Lënia e haramit mund të realizohet edhe duke lënë të paktën gjërat e dyshimta. Pejgamberi, (a.s.), në një hadith fisnik thotë:

“*Hallali është i qartë, edhe harami po ashtu. Por mes tyre ka edhe gjëra të dyshimta. Prandaj, ai që e mbron veten nga këto dyshime, ka mbajtur të pastër fenë dhe nderin e tij. Ai që nuk bën kujdes ndaj gjërave të dyshimta, ka bërë haram. Ashtu siç delet e një çobani në çdo moment mund të hyjnë në korijen pranë së cilës kullosin... Ta dini se çdo mbret ka një korijë. Korija e Allahut janë haramet.*” (Buhari, Iman, 39; Muslim, Musakat, 107.)

Kam lexuar një përkufizim për takvanë ku thuhet: “**Takva është sistemi imunitar i shpirtit.**” Dhe mendoj se është një konkluzion shumë i drejtë, sepse, nëse prishet sistemi imunitar, trupi kapet nga lloj-

lloj sëmundjesh deri te kanceri... Nëse njeriu humbet sistemin imunitar të shpirtit, mund të bëjë mëkate dhe të bie në çdo lloj veprë të shëmtuar.

Në këtë çështje takvaja është shpëtimtarja e praktikimit të fesë. Nëse njeriu nuk e pastron tokën nga gurët dhe nga barërat e këqij, sikur të mbjellë farën më të mirë, ajo nuk mund të rritet. Nëse një njeri i kryen të gjitha adhurimet pa pasur takva, është si të ketë mbjellë farën më të mirë në tokën shterpë. Nëse veprën e devotshme e mendojmë si një farë prodhimtare, takva është kopshti i mrekullueshëm i përgatitur për mbjelljen e kësaj fare.

Transmeton Hz Ali (r.a.), ka thënë:

“*Mos i kushtoni shumë rëndësi numrit të shumtë të veprave, por pranueshmërisë së tyre, sepse, nëse një vepër kryhet me takva, ajo nuk quhet pak. Të gjitha veprat janë të pranueshme dhe të dashura (te Allahu) kur bëhen me takva.*”

Ndërsa Abdullah ibn-i Mesud ka thënë:

“*Dy rekatë namaz që fal një njeri i devotshëm i cili nuk i jep rëndësi jetës së kësaj bote, janë më të dashura te Allahu (xh.xh), se adhurimet që do të kryejë deri në ditën e kiametit një njeri pa takva dhe që është i dhënë pas jetës së kësaj bote.*”

Namazi i pakët i personit të devotshëm i cili “jo vetëm nuk e pi alkolin, por ka frikë edhe ta prekë me dorë, që qëndron larg vendeve ku shitet alkoli



dhe që nuk shkon në vendet ku argëtohen burrat dhe gratë bashkë duke i ditur dispozitat fetare”, është më i pranueshëm se qindra rekatë namaz që fal një person pa takva, i cili nuk i frikësohet Allahut dhe merr pjesë në një ambjente ku përdoret alkool e ku gratë dhe burrat argëtohen së bashku.

Takva do të kuptohej më mirë nëse dihen cilësitë e të devotshmëve. Cilësitë janë veçoritë që nxjerrin në pah personalitetin e njeriut. Domethënë njerëzit të cilët i cilësojmë si “të devotshëm”, kanë këto veçori që bëjnë të ditur se ata janë robërit më të dashur te Allahu Teala...

Një cilësi e rëndësishme që kanë të devotshmit është mbrojtja dhe pastrimi i gjuhës nga përgojimi, thashethemet, gënjeshttrat dhe fjalët e kota e të pakuptimta. Ndërsa zbulurimi i gjuhës me leximin e Kuranit dhe diskutimin e dijes, është vepër e devotshmërisë. Leximi i Kuranit është më i lehtë pasi e mëson atë, por mbrojtja e gjuhës nga thashethemet, përgojimi e gënjeshttra, është shumë e vështirë. Kjo është e mundur vetëm me një edukim serioz të vullnetit. Njeriu nuk mund ta praktikojë çdo gjë që mëson.

Sidomos e vështirë është të bësh vepra që demonstrojnë takva, sepse kjo kërkon një vullnet të fortë. Veprat e një personi pa takva që nuk ka marrë edukim intensiv të vullnetit dhe nuk ka mundur ta komandojë si duhet dorën, gjuhën dhe trupin e tij, nuk bartin vlerë tjetër përveç formës. Këto janë adhurime të mangëta. Madje askush nuk dëshiron ta dëgjojë leximin e Kuranit nga një njeri që përgojon dhe që nuk e komandon si duhet gjuhën e tij. E kush mund t’i marrë për bazë atëherë këshillat e këtij njeriu?

Njeriu i devotshëm mendon më shumë të marrë një pagë hallall sesa për sasinë e saj. Ai nuk afrohet te lojërat e fatit dhe nuk punon në punë të cilat Allahu Teala nuk i pëlqen. Përpiqet që riskun e tij ta

fitojë në rrugë hallall. Nuk e ha bukën e atij personi që i fiton të ardhurat vetëm nga kamata, sikur ky njeri të jetë edhe babai i tij. I frikësohet haramit. Nëse në rrugë gjen një çantë mbushur plot me para, nuk mendon kurrë ta çojë në shtëpi, por e dorëzon atë menjëherë te autoritetet përkatëse.

Njeriu i devotshëm nuk shikon haram... Kurrë nuk shikon çdo cep të shtëpisë së personit të cilit shkon ta vizitojë. Nuk shikon me vëmendje as veshjen e tij, sepse ato shikime janë shikimet e atyre që bartin në zemër dashurinë për këtë botë.

Njerëzve të devotshëm nuk u shkel këmba në vende ku mohohet Allahu... Atyre nuk u pëlqen të shëtisin nëpër qendra tregtare apo pazare të ndryshme vetëm kur e kanë të nevojshme. Të devotshmit nuk blejnë pa qenë nevoja shumë rroba të reja, por zgjedhin t’ua japin ato para nevojtarëve.

U tmerrova kur pashë një zonjë e cila e konsideronte veten të devotshme, por që gjatë një programi në xhami qëndroi e ulur në karrige dhe mbante veshur këpucë me taka. Allahu Teala, kur e ftoi Hz. Musanë (a.s.) në malin Tur-i Sina, i tha **“Hiqi këpucët!”**. Si mund të hyhet në shtëpinë e Allahut me lëpucë ndërkohë që ajo është e shtruar me tapetë dhe ngrohja funksionon? Më vjen keq edhe për gratë që mbajnë me këpucë me taka gjatë mbledhjeve që bëhen nëpër shtëpi. Meqë kjo qenka “modë”, ne duhet të bëhemi vulgarë? Të veshurit e këpucëve jashtë e kuptoj, po me cilën takva mund ta shpjegoji veshjen e tyre brenda shtëpisë?

Një grua e devotshme nuk mund të dalë nga shtëpia me një shami të rregulluar në parukeri, sepse i vjen turp nga Allahu. Si mundet një grua të zbulurojë shaminë e të tregojë linjat e trupit nëpër sallone dasmash ndërkohë që synimi i vendosjes së shamisë është të mos tërheqësh vëmendjen?! Prindërit e devotshëm kurrë nuk e veshin vajzën e tyre të vogël me rroba të papërshtatshme dhe nuk



e lejojnë të kërcejë nëpër sallonet e dasmave, sepse ata e dinë se, ndonëse i vogël, trupi i fëmijës ngjan me trupin e të rriturit.

Cilësia më e rëndësishme e robërve të devotshëm është pastrimi i zemrës nga çdo sëmundje. Ata nuk ushqejnë urrejtje për besimtarët dhe nuk zemërohen kurrë me prindërit, vëllezërit, motrat dhe me askënd tjetër. Nuk ushqejnë smirë dhe armiqësi. Kurrë nuk priren nga mendjemadhësia, mburrja, dashuria për pasurinë e kësaj bote dhe ambicia për pozitë. Robërit e devotshëm ua lënë këtë botë njerëzve që e duan atë...

Kur i mendojmë të gjitha këto, mund të themi se takva është me të vërtetë punë e vullnetit. Për këtë arsye është edhe cilësia më e lartë e myslimanit. Në suren Huxurat Allahu bën të ditur se takva është grada më e lartë:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (el-Huxhurat, 13.)

Takva do të thotë të mendosh para se të hedhësh një hap. Do të thotë ta përmbash veten nga mëkatet. Kur Umer bin Hattab (r.a.), e pyeti Ubej bin Kabin:

“Ç’është takva?” Ubej iu përgjigj duke i thënë:

“A ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?”

“Po.”, tha Umeri.

“Çfarë ke bërë?”, e pyeti sërish Ubeji.

“Kam ngritur rrobën dhe jam munduar që të mos lëndohem nga gjembat.”

Atëherë Ubeji i tha:

“Ja pra, kjo është takva.”

Në suren et-Tegabun, ajeti 16 thuhet:

“Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni...” (et-Tegabun, 16.)

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë! Të gjithë mbahuni fort për litarit të Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani!..” (Al-i Imran, 102-103.)

Nga ky ajet fisnik del në pah e vërteta se të jesh rob i devotshëm është një nga shkaqet e të vdekurit si mysliman.

Premtimet dhe përgëzimet e Allahut për robërit e devotshëm janë nga më të vyerat. Kështu në Kuranin famëlartë Allahu Teala thotë:

“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tua dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.” (Enfal, 29)

“O Besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tua dhe do t’jua falë mëkatet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.” (el-Ahzab, 70-71.)

Tregon Ebu Zer (r.a.):

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Unë di një ajet të cilin, nëse të gjithë njerëzit do ta mbanin, do t’u mjaftonte të gjithëve.”

Sahabët e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, cili është ky ajet?”

Pejgamberi, (a.s.), lexoi ajetet fisnike 2-3 të sures et-Talak:

“...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t’i japë atij risk nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet te Ai.” (et-Talak, 2-3.) (Ibn-i Maxhe, Zuht, 24.)



MARRËDHËNIET BESIM-MORAL NË ISLAM

— Prof. dr. Iljas Çelebi —

Qëllimi i fesë islame është sigurimi i lumturisë së njeriut në të dyja botët dhe Allahu përmes pejgamberëve ka treguar rrugën e realizimit të këtij qëllimi. Pejgamberët na kanë mësuar parimet e fesë, na kanë shpjeguar karakterin e marrëdhënies sonë me Zotin, me veten, me shoqërinë dhe me natyrën. Parimet e fesë shprehin pozicionin tonë ndaj Allahut dhe kozmosit.

Në të njëjtën kohë, pejgamberët na kanë mësuar se çfarë duhet të bëjmë, si duhet të sillemi dhe si duhet të jetojmë për të fituar lumturi në të dy botëve. Të gjitha këto, në Kuran shprehen me termin “Salih amel” (vepër e mirë).

Me “Salih amel” nënkuptohet çdo veprim dhe sjellje e mirë, e dobishme dhe që është në harmoni me urdhëresat fetare. Veprat që këshillon dhe urdhëron feja përfshihen në termin “salih amel”. E kundërta e kësaj janë veprat e ndaluara, të dëmshme dhe të dënueshme nga ana fetare.

Vepra dhe sjellja e mirë që mund të demonstrojë njeriu, ose ka lidhje me Zotin dhe në këtë rast quhet ibadet, ose ka lidhje me njeriun dhe në këtë rast

quhet moral. Tre parimet e fesë janë përmbledhur në hadithin e famshëm të Xhebrailit përmes tri fjallëve: “iman”, “islam” dhe “ihsan”. “Imani” shpreh pjesën teorike, atë çfarë duhet të besojmë, “Islami” shpreh atë çfarë duhet të bëjmë dhe “Ihsani” shpreh sjelljet e mira dhe të hijshme. Sipas kësaj, morali përbën njërin nga tri pjesët që formojnë parimet e fesë islame. Tri shtyllat në fjalë janë prekur përmbledhtazi në suren Asr në formën “iman, vepër e mirë dhe këshillë në të vërtetë dhe durim”. Morali shpreh tërësinë e sjelljeve që shfaq një person.

Feja islame e konsideron njeriun me besimin, mendimin, ndjenjat dhe sjelljet e tij si të tërë. Besimi është produkt i zemrës, mendimi i trurit, ndjenja e ndërgjegjes dhe sjelljet produkt i organeve. Për mirëfunksionimin e jetës së njeriut, të gjithë këta elementë duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin.

Shembulli më i mirë i shprehjes së kësaj tërësie dhe harmonie është Pejgamberi (a.s.).

Një botëkuptim është kuptimplotë, kur ai përcaktohet nga mendime, ndjenja, ideale, qëllime të larta dhe sistem besimi fetar gjithëpërfshirës. Sipas këtij këndvështrimi e ka përcaktuar Kurani dhe Suneti botëkuptimin e myslimanit dhe për këtë e ka bërë obligim besimin dhe veprimin si të pandashëm nga njëri-tjetri.

Kurani, siç trajton parimet e besimit, në mënyrë sistematike trajton edhe temat morale dhe i ofron njeriut materialin e duhur për të krijuar një sistem moral të përsosur. “Salih amel” nuk përfshin vetëm veprim, adhurime që kanë lidhje me Allahun, si: namazi, agjërimi, haxhi etj., por përfshin të gjitha sjelljet e mira kundrejt njerëzve, si: bamirësinë, devotshmërinë, besnikërinë, përgjegjësinë. Ajeti: **“Vërtet, ata që i përulen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”** shpreh dy anët e veprës së mirë. Kurse në një vend tjetër, në mënyrë figurative fenë e përngjason me një pemë, rrënjët e së cilës simbolizojnë besimin, trungu vepër kurse frutat moralin.

Të gjitha mësimet, këshillat, sjelljet dhe veprimet e Profetit (a.s.), synojnë arritjen e dashurisë hyjnore. Si shembull mund të përmendim: **“Besimtar i vërtetë është ai që kur bën një vepër të mirë gëzohet dhe kur bën një vepër të keqe trishtohet.”** (Ahmet ibn Hanbel, Musned, I, 398.)

Një ditë, një sahabi vjen tek Pejgamberi (a.s.) dhe e pyet: “Kush është myslimani më i mirë?” Pej-

gamberi (a.s.), i thotë: **“Mysliman më i mirë është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit myslimanët janë të sigurt.”** (Buhari, Iman, 4-5.) Kurse një herë tjetër, kur e pyetën cili është islami më i mirë, tha: **“Të ushqesh njerëzit dhe të përshëndesësh me selam atë që njëh dhe atë që nuk e njëh”** (Buhari, Iman, 6.)

Kurse porosi profetike që tregojnë raportin e ngushtë besim-moral mund të numërojmë: **“Nuk mund të jesh besimtar i vërtetë, përderisa nuk dëshiron për vëllain mysliman atë që dëshiron për veten tënde.”** (Buhari, Iman, 7) **“Ruajtja nga intrigat është pjesë e fesë.”** (Buhari, iman, 12) **“Turpi është pjesë e besimit.”** (Buhari, iman, 16) **“Xhihadi (përpjekja) është prej besimit.”** (Buhari, iman, 26)

Siç theksohet në Kuran dhe Hadith, midis moralit dhe besimit ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Nëse Islamin e përngjasojmë me një pemë, atëherë rrënjët janë besimi, degët vepër e mira dhe frutat morali i mirë. Nga kjo kuptohet lehtë që qëllimi përfundimtar dhe kryesor i pemës janë frutat. Prandaj, njeriu vetëm në këtë mënyrë mund t'i realizojë pritshmëritë. Hadithi profetik **“Unë kam ardhur për të përsosur moralin”** shpreh qëllimin përfundimtar të të gjithë sistemit.

Megjithëse pjesa teorike është shumë e qartë, për shkak të kushteve historike, koniunkturës dhe dallimeve kulturore, më vonë janë shfaqur rryma me pikëpamje të ndryshme për sa i përket marrëdhënies mes besimit dhe moralit.

Morali nga pikëpamja e sjelljes përfshihet tek vepër e mira, kurse nga pikëpamja e ndjenjave dhe vlerave përfshihet te besimi. Prandaj, me marrëdhënien besim-moral nënkuptojmë gërshetimin midis këtyre tri shtyllave kryesore. Fatkeqësisht, morali është shkëputur nga shkencat bazike islame, duke iu bashkëngjitur filozofisë. Por morali në kulturën islame nuk ekziston thjesht si një teori, ai së pari është gjendje që jetohet dhe shijohet.



Perspektiva neutrale gjinore dhe familja nën sulm

KRIJIMI VAZHDON PËRMES DY GJINIVE TË NDRYSHME. JETA E RACËS NJERËZORE, RACËS SHTAZORE APO E BIMËVE VAZHDON DUKE U PËRBËRË NGA NJË MASHKULL DHE NJË FEMËR. PRANDAJ, ËSHTË E NEVOJSHME TË VLERËSOHET ÇËSHTJA JO NË KONTEKSTIN E 'BARAZISË', POR NË BAZË TË KËRKESAVE TË NATYRSHMËRISË.

— Salih Zeki Meriç —

Familja është elementi bazë që përbën dinamizmin kryesor të shoqërisë. Dobësimi i familjes shkakton dobësimin e dinamikës së shoqërisë dhe formimin e individëve të pashëndetshëm mendërisht dhe shpirtërisht. Familja është një institucion i shenjtë në shoqëritë si ne që e marrim referencën tonë nga Islami në përgjithësi. Është një mjedis ku njeriu më së shumti duhet të silltet me ndjenjën e vetëflijimit, sakrificës dhe përgjegjësisë morale sesa me unitetin e interesave. Është një institucion në të cilin nëna ka detyra ndaj babait, fëmija ndaj nënës, vëllai ndaj vëllait e motrës dhe në të cilin ka qëndrime që mbajnë refleksë fetare në bazë. Prandaj, nuk do të ishte një vlerësim i saktë ta shpjegojmë konceptin dhe botëkuptimin tonë për familjen me kuptimin e degjeneruar, të ashtuquajtur të bazuar në liri, të perëndimit.

Kur themi familje, kuptojmë një strukturë që është e lidhur ngushtë me njëra-tjetrën dhe kjo lidhje e ngushtë i imponon disa përgjegjësi. Një botëkuptim individualist i nxjerrë në pah nga botëkuptimi modern, nuk ekziston në strukturën tonë familjare dhe shoqërore. Disa institucione të mbështetura nga perëndimi, të cilat e konsiderojnë si detyrë inxhinierinë sociale, institucioni i parë ku ata operojnë në shoqëritë që sipas tyre nuk kanë përparuar, është familja. Në vendin tonë, ku dikur bëhej planifikimi i popullsisë dhe që ende vazhdon të bëhet, po përpiqen të realizojnë qëllimet e tyre dashakeqe nën

emrin e disa kontratave me referenca perëndimore. Nën titujt e «barazisë midis burrave dhe grave» ose «diskriminim pozitiv ndaj grave», «kundërshtimi i shoqërisë së dominuar nga meshkujt», zhvillohen aktivitete për të tronditur themelet e familjes gjoja me qëllime të mira për «mbrojtjen e të drejtave të grave».

Vitet e fundit, idetë që janë ngritur për diskutim në të gjitha llojet e mjedisve dhe të paraqitura në bazë të gjinisë duhet të filtrohen përmes një filtri të fortë. Para së gjithash, është e nevojshme të përdoren drejt konceptet dhe të perceptohen drejt kuptimet që u atribuojmë atyre koncepteve. Përveç të tjerash, barazia e 'gjinisë' është kundër krijimit/natyrshtëmërisë së burrave dhe grave. Nëse do të duhej të kishte barazi, atëherë nuk do të kishte nevojë për dallim gjinor. Krijimi vazhdon përmes dy gjinive të ndryshme. Jeta e racës njerëzore, racës shtazore apo e bimëve vazhdon duke u përbërë nga një mashkull dhe një femër. Prandaj, është e nevojshme të vlerësohet çështja jo në kontekstin e 'barazisë', por në bazë të kërkesave të natyrshtëmërisë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj teme, ekziston një realitet që është thelbësor, dhe kjo është natyra e njeriut. Është një e vërtetë që duhet të jetë në natyrën e krijimit. Fitrati/natyrshtëmëria është si një ujë që rrjedh në shtratin e tij. Edhe nëse vendosni një pengesë, ai do të rrjedhë dhe do të përcaktojë rrugën e tij. Rolet që na imponohen për shkak të natyrës sonë,

në fakt përbëjnë identitetin tonë që nga lindja. Me fjalë të tjera, dallimet si gjinia tregojnë se edhe rolet tona duhet të jenë të ndryshme. Është e nevojshme të dihet se injorimi i këtij dallimi dhe përpjekja për të luajtur një rol apo përjetimi i konfuzionit të roleve është një situatë e rrezikshme për harmoninë e njerëzimit. Ne nuk mund t'i ndryshojmë rolet tona natyrore. Allahu e ka krijuar seksin mashkull dhe seksin femër si elemente plotësuese. Njëri nuk është e kundërta apo rivali i tjetrit. Kjo ndjenjë e kompletimit qëndron në esencë të martesave. Gjatë gjithë historisë njerëzit janë shumuar duke u martuar, martesën e kanë konsideruar si një vatër, një vend paqeje dhe e kanë vlerësuar si një bashkim të natyrshëm për qetësinë shpirtërore dhe fizike të të dy gjinive. Ndaj, ndërhyrja në institucionin e familjes, pasiguria se kush çfarë do të bëjë dhe përpjekja për të dominuar gjininë, çon gjithashtu në një konflikt rolesh. Në këtë drejtim, secili duhet të besojë se vendi ku është dhe ku qëndron është i respektueshëm, secila gjini duhet të tregojë respekt të thellë për faktin e krijimit të tjetres dhe të besojë në dobësinë e çdo këndvështrimi që është në kundërshtim me natyrshmërinë. Vetëm atëherë do të përparohet në një terren më të shëndetshëm.

Qasja e jetës moderne për të vlerësuar në të njëjtin nivel çështjen e barazisë gjinore apo të të drejtave të bashkëshortëve në familje, ka sjellë shumë probleme. Mendja moderne thekson se pavarësia ekonomike e gruas së lirë është shumë e rëndësishme, pasi ajo i jep gruas të njëjtin kuptim që i jep burrit dhe i ngarkon gruas të njëjtat përgjegjësi që i ka ngarkuar burrit dhe si rrjedhojë ka të njëjtën pritshmëri prej saj. Ajo dëshiron të nxjerrë në pah llojin e bashkëshortëve që nuk kanë nevojë për njëri-tjetrin pothuajse në asgjë dhe që veprojnë vetëm me një ndjenjë interesi për çështje të caktuara. Si rezultat i një qasjeje të tillë, zhduket edhe vetëflirimi dhe dinjiteti që kërkohen. Kjo nxjerr një konfuzion të rëndësishëm të rolit në shoqëri. Ndryshimi apo konflikti i roleve lind më shumë nga dëshira për liri ekonomike. Mirëpo, në botëkuptimin e Islamit, burrat marrin përsipër sigurimin e jetesës dhe shtëpisë. Përgjegjësia kryesore i takon burrit. Babai është përgjegjës për t'u kujdesur për gruan e tij dhe për të siguruar mirëmbajtjen e fëmijëve të tij. Nga ana tjetër, gruaja është përgjegjëse për mbrojtjen e nderit të saj, dinjitetin e burrit të saj, kryerjen e përgjegjësiave për fëmijët e saj dhe koordinimin e punëve të tjera të shtëpisë. Kur të dyja palët kanë të njëjtën pritshmëri, veçanërisht nëse 'liria ekonomike' është me idenë e dominimit të tjetrit ose të krijimit të një

hapësire private, atëherë nuk do të ishte e drejtë ta quanim martesë atë bashkim.

Në pikën që kemi arritur sot, theksohet një 'botë pa burra', veçanërisht përmes grave. Fatkeqësisht, kjo qasje, e cila është në kundërshtim me natyrën, të kaluarën dhe realitetin e njerëzimit, vazhdimisht e sjellin në rendin e ditës shumë organizata kombëtare apo ndërkombëtare të krijuara për të ashtu-quajturën mbrojtja e të drejtave të grave. Sjelljet e pahijshme individuale ndaj gruas dhe vrasjet me përmbajtje të panjohur në shumë aspekte, shfaqen si ide e «demonizimit të burrave» dhe zhvlerësimit të burrave. Si rrjedhojë në shoqëri po rritet vazhdimisht «armiqësia ndaj burrave». Kjo është një çështje në të cilën nuk dihet se kush ka të drejtë apo gabim, pra, si një litar që i ka ikur filli.

Prandaj, është e nevojshme të dihet se të gjitha mendimet dhe idetë e nxjerra në pah në bazë të gjinisë nuk mund të japin një rezultat. Sepse, siç e kemi thënë edhe më lart, burrat dhe gratë nuk janë rivalë apo të kundërt të njëri-tjetrit, ata janë plotësues të njëri-tjetrit. Në shprehjen kuranore ata janë quajtur si amanet ndaj njëri-tjetrit. Ajo që është amanet gjithmonë mbrohet dhe vëzhgohet. Andaj nuk mund ta gjejmë të drejtën dhe atë që na përshtatet duke u ekspozuar ndaj imperializmit kulturor dhe duke i parë çështjet tona me syzet e të tjerëve. Ne mund të arrijmë një rezultat më të saktë duke zhvilluar një perspektivë për çështjet brenda kornizës së kulturës së lashtë të gjeografisë sonë dhe parimeve që na ka mësuar Islami. Të jetosh sipas natyrës, jo lirisë, e bën njeriun të qetë. Çlirimi individual i gruas gjithashtu ka të metat e veta dhe një perspektivë e dominuar nga meshkujt gjithashtu ka problemet e veta. Prandaj, nocioni i familjes, i cili është i domosdoshëm për një shoqëri të shëndoshë, duhet të jetë fusha jonë më e ndjeshme. Sepse kur përmendet familja, kuptohet se ajo është një fenomen në të cilin përjetohen së bashku konceptet e privatësisë, nderit, të ardhmes, lumturisë, vetëbesimit dhe shpresës. Në themel të mashtrimit të barazimit të gjinive qëndron ideja e dënimit të një shoqërie me zhdukje deri në rrënjë.





URTËSIA DHE VETËPËRMBAJTJA

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh.) i drejtohet Profetit (a.s.) në Kur'anin Famëlartë, duke i thënë: “**Sepse Zoti të dha mëshirë, prandaj ti ishe i butë me ta. Sikur të tregoheshe fjalërrëndë dhe zemërgur, ata do të iknin prej teje**”. (Ali Imran, 159).

Jeta e përplas njeriun me probleme nga më të ndryshmet, do apo nuk do ai. Jeta e përplas njeriun me dikë, që ka dy gramë mend në kokë, por edhe me njerëz që e kanë kokën bosh, me njerëz të urtë, por edhe me arrogantë, e përplas me njerëz injorantë dhe mendjelehtë, saqë njeriu nuk di nga t'ia mbajë e çfarë të thotë.

Njeriu kalon probleme e kriza nga më të ndryshmet. Kalon situata aq delikate, në të cilat duhet të mendohet mirë para se të vendosë, sepse me një fjalë fiton apo humb gjithçka.

Koha që po jetojmë, është e mbushur me të tilla situata dhe fjala më e mirë që më vjen ndër mend për të gjitha këto është **sprovë**. Ka rrezik të përçahet i gjithë populli, prandaj lum ai njeri që ulet dhe mendon, lum ai njeri që i lutet Allahut (xh.sh) që ta udhëzojë tek rruga më e mirë, t'i japë urtësi e butësi, ta ruajë nga nxitimi dhe mos përmbajtja e vetes.

Kapitali më i madh që ka njeriu në këto kohë, nuk është as pasuria dhe as mençuria, por është morali i tij. Ky moral e bën njeriun që të përmbajë veten. Morali ka dy cilësi kryesore: **URTËSINË** dhe **VETËPËRMBAJTJEN**.

Këto cilësi i do Zoti i gjithësisë, i deshi Profeti (a.s) dhe çdo njeri i dëshiron për veten e tij. Profeti (a.s), i tha njërit prej shokëve të tij: “Ti ke dy cilësi që i do shumë Allahu (xh.sh) dhe profeti i Tij. Ti je i urtë dhe i vetëpërmbajtur”.¹ Atëherë ky njeri falënderoi Allahun (xh.sh), që ia kishte dhënë këto dy cilësi.

Njeriu ka nevojë për urtësi, për butësi dhe vetë-

përmbajtje. Këto cilësi nevojiten sidomos në ato situata, kur njerëzit çoroditen dhe bëhet rrëmujë e madhe.

Për këto cilësi ka nevojë besimtari, sepse **urtësia** dhe **vetëpërmbajtja** janë cilësi hyjnore. Një nga emrat e Zotit tonë është **EL-HALIM (I URTI)**. Allahu (xh.sh.), nuk nxitohet me krijesat e Tij, nuk nxitohet me atë njeri që bën mëkate, por pret që ai të pendohet. Dënimi i Allahut (xh.sh.), vonon dhe mëshira e Tij pret. Sikur Allahu (xh.sh.), t'i jepte çdo njeriu hakun pasi ka bërë punën, vallahi ne do të shkatërroheshim nga mëkatet që bëjmë. Kjo është drejtësia e Zotit. Kush është ai që nuk bën mëkate?! Të gjithë ne jemi mëkatarë. Thuhet se të gjitha krijesat e lusin Allahun (xh.sh.), që t'i shkatërrojë këta njerëz, por Zoti e vonon dënimin e Tij, sepse është i Urtë, i Butë, i Vetëpërmbajtur. Për çdo ditë që lind, deti i lutet Zotit: “O Zot më jep leje t'i mbys mëkatarët, që bredhin nga njëri breg në tjetrin e nuk të kanë frikë Ty”. Toka nga ana e saj i lutet Zotit çdo ditë: “O Zot më jep leje t'i fundos në barkun tim të gjithë ata njerëz, që nuk e njohin Madhësitinë Tënde”. Po ashtu edhe qielli i lutet Zotit të gjithësisë: “O Zot, më jep leje t'i shkatërroj të gjithë mëkatarët, që nuk duan t'ia dinë, se Ti i shikon në çdo moment”. Por Allahu (xh.sh) nuk i jep leje askujt, që t'i zhdukë gjynahqarët. Ai është i Butë, është Mëshirues dhe Falës i madh.

Sa njerëz sot lundrojnë në barkun e detit?! Sikur Allahu (xh.sh) të jepte leje, që gjynahqarët dhe mëkatarët të shkatërroheshin në këto momente, sa mendoni se do të ishin vallë?

Sa njerëz ecin me makinat e tyre mbi shpinën e tokës? Janë miliona e miliona njerëz. Sikur të dënoheshin menjëherë për gjynahet që kanë bërë, e mendoni sa vetë do të përpinte toka?!

Sa njerëz fluturojnë në zemër të qiellit? Sikur t'i dënonte Allahu (xh.sh), asnjë nuk do të mbetej i gjallë, por Zoti pret, se është i Butë, është Bujar, është i Mëshirshëm. Allahu (xh.sh) i thotë detit, qie-

1. Muslimi (25).

llit edhe tokës: **“Ju nuk i krijuat njerëzit, prandaj doni të hakmerreni ndaj tyre. Ata janë krijesat e Mia, Unë i kam krijuar e Unë i mëshiroj. Sikur t’i kishit krijuar ju njerëzit, s’do të thoshit fjalë të tilla”.**

Vetëpërmbytja është cilësi e Zotit të gjithësisë. Është cilësi, për të cilën na fton vetë Zoti i gjithësisë. Cilësinë e butësisë dhe vetëpërmbytjes e pati pejgamberi Muhamed (a.s), sepse atë e edukoi vetë Allahu (xh.xh) dhe Zoti i tha: **“Sepse Zoti të dha mëshirë, prandaj ti ishe i butë me ta. Sikur të tregoheshe fjalërrëndë dhe zemërgur, ata do të iknin prej teje”.** (Ali Imran, 159) Profeti (a.s) ishte i butë, i mëshirshëm dhe nuk u hakmor kurrë për veten, prandaj dhe armiqtë u nënshtruan përpara tij. Meditoni pak për historinë e Profetit (a.s). Këtë Profet e ofenduan, i thanë: “Budalla, i çmendur, magjistar, poet”, por ai kurrë nuk u nevrikos, kurrë nuk i mallkoi këta njerëz. Ky Profet i Zotit u dëbua si mos më keq, pa asnjë gabim, pa asnjë faj dhe u keqtrajtua nga banorët e Taifit. Ai nuk mori hak ndaj tyre, por tha: “O Zot, fali se ata nuk e dinë se çfarë bëjnë! O Zot nxirr nga pasardhësit e tyre, besimtarë që do të të madhërojnë Ty!”.²

Njëherë kur po ndante plaçkën e luftës, dikush me paturpësinë më të madhe i tha: “Pasha Zotin nuk e ndave drejt o Profet i Zotit”. Profeti (a.s.), ia ktheu: “Zoti të faltë ty dhe të gjithë të tjerët. Nëse unë nuk e ndaj drejt, kush do ta ndajë më mirë se unë”.³

Ky profet i Zotit nuk mori hak edhe kur i urinuan në xhami, por me butësinë më të madhe dhe me një vetëpërmbytje të admirueshme, diti si të sillte me këta njerëz dhe arriti t’i hapte zemrat e tyre. Prandaj këta njerëz nga armiq, u bënë miq, nga beduinë që ishin, u bënë njerëzit më të civilizuar.

Profeti (a.s) nuk u nxitua edhe në punët, që janë krejtësisht fetare. Pak kohë përpara se të ndërronte jetë, ai (a.s) i tha bashkëshortes së tij: “O Aishe! A e di ti se xhamia e Qabes nuk është në themelet e saj origjinale”? Pasha Zotin, sikur të mos kisha frikë se njerëzit përçahen, unë do e prishja Qaben, do ta ndërtoja në themelet e saj origjinale dhe do t’i bëja dy dyer”.⁴ Profeti (a.s) preferonte që më mirë ta linte Qaben aty ku është, sesa të përçante njerëzit. Ky është Profeti (a.s), kjo është butësia e tij, kjo është vetëpërmbytja e tij.

Profeti (a.s) i mësoi shokët e tij, të mos nxitohen në asnjë situatë, as atëherë kur provokohen e as atëherë kur janë të qetë. Ai (a.s) i ftoi shokët e tij, të mos nxitohen edhe në punët e mira. Prandaj Islami nuk e preferon, që namazin ta falim me nxitim. Pse duhet të nxitohesh? Kush po të sulmon nga pas? Mos u nxito, por përqendrohu në namazin tënd dhe mundohu ta përjetosh atë.

Kur Profeti (a.s.), bëri haxhin e lamtumirës, u thoshte njerëzve: “Qetësohuni, qetësohuni o robër të Zotit, mos u nxitoni”.⁵ Në atë kohë ishin vetëm 100 mijë vetë. Po sot që mblidhen me miliona njerëz në haxh?! A nuk duhet të jemi të kujdesshëm e të mos nxitohemi. Për fat të keq ka njerëz, që mund të pësojnë aksidente gjatë haxhit, brenda në Qabe, në vendin më të mirë që ka bërë Zoti për njerëzit dhe kjo vjen, ngaqë njerëzit nuk e përfillin porosinë e Profetit (a.s). Nxitimi nuk sjell asnjëherë punë të mira.

Profeti (a.s.) i mësoi shokët e tij, na mësoi edhe ne me dy fjalë shumë të shkurtra: “Nxitimi është prej shejtanit, ndërsa vetëpërmbytja është prej Rahmanit”.⁶

Nëse vetëpërmbytja dhe butësia i duhen njeriut në çdo situatë, unë mendoj se më shumë se kurrë i duhen myslimanit sot. Atëherë kur kjo fe akuzohet padrejtësisht nga mëngjesi deri më mbrëmje, ne duhet ta kontrollojmë veten tonë. Në një kohë kur provokohemi padrejtësisht me lloj – lloj termash e lloj – lloj veprimesh, vetëm që ne të bëjmë veprime të pahijshme, duhet ta kontrollojmë veten tonë. Është koha e thashethemeve e njeriu duhet ta përmbyjë veten e tij. Çdokush le t’i lutet Allahut (xh. sh), që t’i japë butësi e urtësi në zemër.

Sot më shumë se kurrë duhet ta edukojmë veten tonë, që të mos bëjmë veprime, të cilat nuk i bëjnë dobi myslimanëve. Sot më shumë se kurrë duhet t’i masim fjalët tona, t’i masim punët tona, t’i edukojmë mirë fëmijët tanë, që të jenë të urtë e të vetëpërmbytur.

Të jesh i vetëpërmbytur dhe i butë, nuk do të thotë që ti je frikacak dhe nuk pyet për fenë e Zotit. Ne duhet të jemi të butë, por jo të nënshtruar, modestë por jo naivë, krenarë por jo mendjemëdhenj. Ne duhet të kontrollojmë fjalët dhe zemërimin tonë, të falim kur kemi mundësi, të japim kur të tjerët nuk japin, sepse për këto cilësi na nxiti Zoti i gjithësisë dhe Profeti (a.s).

Profeti (a.s) ka thënë: “Ajo që arrihet me butësi, nuk arrihet kurrë me vrazhdësi”.⁷

Lusim Zotin t’i mbushë zemrat tona me butësi dhe maturi. E lus Zotin që në situatë krizash e rrëmujash, të na udhëzojë në rrugën e drejtë e të na japë forcë ta ndjekim atë, të na ruajë nga rruga e keqe e të na japë forcë t’i largohemi asaj!

Amin!..

5. Muslimi (147, 1218).

6. Ebu Ja’la (4254). Hejthemiu në Mexhmauz’zeuaid (8/43) thotë: “E shënon Ebu Ja’la me përcjellës të vërtetë”. Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar.

7. Muslimi (2592).

2. Buhariu (3231).

3. Buhariu (3610).

4. Muslimi (2374).

Mrekullia e ekzistencës së gazrave në botën tonë



Siç dihet, gazrat që janë më të rëndë se ajri, bien poshtë, kurse gazrat që janë më të lehtë ngjiten lart. Për këtë arsye, balonat tona që fluturojnë i mbushim me gazra si hidrogjeni dhe heliumi të cilët janë gazra të lehtë. Ngaqë bombulat e kuzhinës i mbushim me gazra si butani dhe propani të cilët janë më të rëndë se ajri, gazrat bien në tokë kur këto bombulat kanë rrjedhje. Kështu që sugjerohet të hiqen duke i fshirë. Shtresa e atmosferës që e rrethon tokën, domethënë ajri është një përzierje gazrash mjaft homogjene që përbëhet nga molekulat e gazit të azotit dhe oksigjenit në një përqindje të madhe. Oksigjeni është një molekulë pak më e rëndë se azoti. (Oksigjen, O₂: 32 g/mol, Azot, N₂: 28 g/mol) Mirë, por pse akoma oksigjeni nuk ka precipituar në raport me azotin edhe pse kanë kaluar me miliarda vite? Le ta bëjmë pyetjen edhe më interesante: Çfarë do të ndodhte nëse oksigjeni do të precipitonte dhe shtresa më e poshtme e atmosferës të formohej nga oksigjeni?

Oksigjeni i cili është i dobishëm për frymëmarrjen e gjallesave dhe si rrjedhojë për vazhdimësinë e jetës, është një element djegës. Fakti që në atmosferë ka shumë tepër oksigjen, do të thotë që edhe një shkëndijë shumë e vogël mund të bëhet shkak për zjarre që nuk mund të shuhen. Domethënë, nëse oksigjeni do të kishte rënë në tokë, të gjitha gjallesat do të digjeshin krejt lehtësisht dhe do të zhdukeshin. Falënderimi i takon Allahut (xh.xh.), që oksigjenin i cili përbën 21 % të atmosferës, e ka subtilizuar (holluar / përzier) me azotin i cili përbën 78 % të saj. Azoti nuk digjet përveçse në temperatura shumë të larta. Kurse pjesa prej një përqind e ajrit që mbetet përbëhet më së shumti nga gazi i argonit. Argoni është më i rëndë edhe se oksigjeni, edhe se azoti (Ar: 40 g/mol) dhe është një lloj gazi me një atom. Edhe ai nuk digjet. Domethënë se oksigjeni djegës që gjendet në atmosfere

rë në sasi të mjaftueshme, është subtilizuar/holluar me gazra që nuk digjen. Përzierja e gazit me oksigjen në raport një me pesë, i cili është i përshtatshëm për vazhdimin e jetës në tokë, gjendet në atmosferë në këtë formë.

Tani le të vijmë te pyetja e parë: Përse nuk subtilizohet oksigjeni? Përgjigjja është e mahnitshme! Në fakt do të subtilizohej, por temperatura në atmosferë mundëson që ajri të mbetet një përzierje homogjene. Temperatura është një masë e shpejtësisë së molekulave në raport me njëra-tjetrën. Kur temperatura është e lartë, gazrat përzihen në formë të përkryer. Shpejtësia mesatare e molekulave që formojnë ajrin është më e lartë

se shpejtësia e zërit (1235 km/h). Domethënë se molekulat e vogla të cilat nuk mund t'i shohim me sy, fluturojnë rreth nesh me një shpejtësi kaq të lartë dhe përplasen me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë ajri përzihet mirë dhe shndërrohet në një gaz homogjen. Krahas kësaj, përgjatë miliarda viteve që kanë kaluar, gazrat e lehtë janë ngritur lart dhe kanë ikur në kozmos, kurse ata që janë të rëndë kanë subtilizuar nëpër oqeanë dhe janë shpërbërë. Për shembull, ndërkohë që përqindja e azotit nëpër oqeanë është më e paktë se në ajër, përqindja e oksigjenit argonit dhe karbondioksidit (CO₂: 44 g/mol) nëpër oqeanë është më e lartë se në ajër.

Dermani që vjen me tragjedinë

Për dioksidin e karbonit i cili është një gaz natyror, duhet të hapim një parantezë të madhe. Kur i shohim me vëmendje përqindjet e ajrit që janë dhënë më sipër, vihet re se dioksidi i karbonit nuk gjendet në një përqindje të konsiderueshme. Në fakt, po të gjendej në përqindje të konsiderueshme, do të ishte vrasës për njerëzit dhe kafshët. Krahas kësaj, bimët që bëjnë fotosintezën me energjinë që marrin nga dielli, ndjejnë një nevojë të madhe për dioksidin e karbonit. Madje është vërtetuar se po të mos jenë bimët, nuk mund të ketë jetë në tokë. Mirë, por nga e marrin bimët dioksidin e karbonit? Edhe kjo përgjigje është shumë interesante. Ato e marrin dioksidin e karbonit nga mjedisi dhe ajri. Kështu që mjaftohen me pak. Nëse dioksidi i karbonit shtohet në ajër për shkak të ndonjë faktori, bimët e thithin menjëherë në strukturën e tyre dhe rriten më shpejt. Për shembull, dioksidi i karbonit që përzihet në atmosferë si rrjedhojë e ndonjë zjarri të madh, bëhet shkak për rritjen më të shpejtë të bimëve. Sigurisht se për këtë bimët kanë nevojë edhe për ujë. Edhe një lloj gazi tjetër që del në pah përgjatë zjarreve është avulli i ujit, domethënë produkti themelor i reve. Në këtë mënyrë tragjedia na jep edhe ilaçin e nevojshëm për mjekimin e plagëve. Kjo në një farë mënyrë është mekanizmi për ta zëvendësuar diçka shpejt. Sepse këtu bëhet fjalë për një ekuilibër të ndjeshëm dhe të qëndrueshëm: **"Bimët dhe pemët i përulen (Allahut). Ai e ka ngritur qie-llin lart dhe ka vënë Balancën** (për çdo gjë), **që ju të mos e shkëlqi atë."** (Rrahman, 6-8) Edhe një çështje tjetër shumë e rëndësishme është fakti

Nga ka ardhur uji?

Një çështje tjetër që mund të na mbetet në mendje pas të vërtetës se molekula e ujit e cila është më e lehtë se ajri ngrihet në atmosferë, ftohet dhe kthehet pas duke rënë si shi për shkak të kondensimit, është kjo: Përse nuk ka fluturuar dhe ikur uji përgjatë periudhave shumë të lashta kur akoma toka dhe atmosfera nuk ishin ftohur dhe si rrjedhojë uji nuk mund të shndërrohej në shi? Në fakt shumë shkencëtarë mendojnë se një sasi shumë e madhe e ujit ka fluturuar dhe ka ikur. Mirë, atëherë nga ka ardhur ky ujë që gjendet nëpër oqeanet madhështore dhe për të cilin kanë nevojë bimët e gjallesat në tokë? Mos vallë ka zbritur nga qielli? Përgjigjja është po! Mendohet se uji që ka ardhur në tokë pasi ajo është ftohur e ka prejardhjen nga qielli. Ajeti i nëntëdhjetë e nëntë i sures En'am thotë: **“Është Ai që e ka zbritur ujin nga qielli. Ja pra, çdo lloj bime i kemi dhënë jetë me atë...”** Uji mund të jetë zbritur në tokë nëpërmjet kometave, apo nëpërmjet meteorëve apo nëpërmjet mekanizmave të tjera që përmbanin akull në sasi të mëdha në strukturat e tyre. Akoma ndodh që herë-herë trupat qiellorë përplasen me planetët dhe kështu bëhen shkak për shpërthime madhështore. Përplasja e një meteori mund të konsiderohet si tragjedi për një planet plot jetë, por siç e thamë edhe në shembullin e mësipërm rreth periudhave të para të tokës, mund të jetë edhe një faktor i rëndësishëm që formon kushtet e përshtatshme për jetën. Siç shihet, në të kaluarën e çdo molekule që formojnë qelizat e gjallesave, gjendet

një proces që shtrihet nga një mjedis pa jetë drejt një jete me sistem dhe që është shumë i vështirë për t'u shpjeguar me llogaritje të hamendësuar.¹

Së fundi, le të shtjellojmë pyetjen se përse gjendet një atmosferë e përshtatshme për jetën e gjallesave në tokë, por nuk gjendet te shumë trupa të tjerë qiellorë, si për shembull në hënë apo në Mars? Dielli në të vërtetë është një faktor që e fshin atmosferën dhe e hedh në hapësirë. Nëse planetët kanë një fushë elektromagnetike që i mbron prej kësaj, domethënë nëse kanë një kallkan, atmosfera mund të qëndrojë pa u prishur për miliona e miliarda vite. Edhe pse ky mekanizëm nuk është kuptuar plotësisht, ka shumë prej shkencëtarëve që formimin e kallkanit e lidhin me lëvizjen e metaleve të nxehta në planet. Kjo lëvizje dhe si rrjedhojë, ky kallkan mbrojtjeje në Mars, ka shumë kohë që është humbur. Për këtë arsye, një pjesë shumë e madhe e atmosferës së tij është zhdukur në hapësirë. Edhe një pjesë e rëndësishme e ujit ka ikur në këtë mënyrë. Kjo situatë mund të ketë lidhje me përmasat e planetit. Bazuar në këtë, hënat (satelitët) dhe planetët e vegjël mund t'i humbin më shpejt kallkanët e tyre elektromagnetikë. Toka është më e madhe edhe se hëna, edhe se Marsi. Kështu që akoma jemi të mbrojtur.²


1) “Si mund ta mohoni Allahun, ndërkohë që keni qenë të pajetë e Ai ju dha jetën?! Pastaj Ai do t'ju bëjë të vdisni, më pas do t'ju ringjallë e, në fund, do të ktheheni tek Ai!” (Bekare, 28) / 2) “Ne e bëmë qiellin mbulesë të mbrojtur, por përsëri ata shmangen nga shenjat që gjenden aty.” (Enbija, 32)

se ndotja e ujit dhe e ajrit që mund të ndodhë si rezultat i prishjes së ekuilibrit në fjalë, mund të çojë në shkatërrime shumë të mëdha.

Përqindjet e përzierjes atmosferike që i dhamë deri më tani, faktikisht ishin vetëm për ajrin e thatë. Sigurisht se edhe avulli i ujit përzihet në ajër. Uji në gjendje të gaztë (H_2O : 18g/mol) është më

i lehtë se ajri. Për këtë arsye uji ngrihet në atmosferë dhe arrin te shtresat e larta e të ftohta. Këtu, kur përqendrimi rritet dhe retë bëhen mjaft të dendura, zbret në tokë në formën e shiut ose dëborës. Po të mos ishte avulli i ujit më i lehtë se ajri dhe po të mos kondensohej në shtresat e larta e të ftohta, nuk do të kishte shira dhe si rrjedhojë, nuk do të kishte jetë me plot kuptimin e fjalës. Në këtë pikë është e dobishme që ta shprehim se niveli i presionit të ajrit prej 1 bar është në një nivel të përshtatshëm për të ndodhur ky cikël.

Mirë, po elementet e lehta, për shembull Heliumi (He : 4g/mol), përse nuk ngrihet lart, nuk largohet nga kjo botë dhe nuk zhduket në hapësirë? Edhe kjo ka një përgjigje interesante! Ngrihet lart dhe humbet. Domethënë, heliumi që përdoret në balonat e meteorologjisë apo që harxhohet nëpër vendet e argëtimit për të folur me zë të hollë, nuk zëvendësohet. Heliumi, i cili gjendet shumë në hapësirë, ngaqë nuk është një gaz i përbërë, fluturon dhe nuk kthehet më. Njerëzimi e nxjerr dhe e përdor gazin natyral dhe heliumin që gjenden ndërmjet shkëmbinjve, por nëse harxhohet edhe ai, do të mbesim pa helium. Prandaj, është një humbje serioze të harxhosh këtë gaz për argëtim, i cili ka të ngjarë të jetë shumë i vlefshëm për studime shkencore në të ardhmen.





USHQIME NATYRORE *apo përforcuese*

— Dr. Ali Akben —

Nuk ka ditë që në median e shkruar të mos ndeshemi me artikuj apo lajme rreth ushqyerjes, shëndetit, jetës së gjatë dhe jetesës cilësore. Të dhënat e ndryshme dhe të shumta që formulohen në lidhje me jetesën e shëndetshme, duam apo s'duam, tërheqin vëmendjen e njerëzve.

Orientimet rreth ushqyerjes organike dhe natyrale, që vitet e fundit janë bërë edhe pak modë,

pothuajse janë shndërruar në kamerdare shpëtimi për njeriun e sotëm që është i lodhur, i mërzitur dhe i dëshpëruar.

Problemet e shumta shëndetësore dhe gjërat negative me të cilat përballemi, si rezultat i gabimeve të pafalshme që bëjmë në të ushqyer, në stilin e jetesës dhe në jetën tonë, na përgatisin terrenin për të vepruar në mënyrë të pavetëdijshme.

Informimet e pabaza që dëgjoen andej-kënde, ose sensacionet e partnerëve e të miqve gjoja se kjo vitaminë i bën mirë filan sëmundjeje dhe numri i njerëzve që presin shërim për shqetësimet e tyre të ndryshme nga disa vitamina minerale përforcuese, po shtohet çdo ditë me shpejtësi.

Nëse jeni një njeri i painformuar mjaftueshëm nga aspekti i dijes shëndetësore, jeni pak i ndjeshëm ndaj dobive e dëmeve dhe lehtësisht i imponuar nga të tjerët, duhet ta lexoni këtë artikull. Duhet ta lexoni, sepse industria e vitaminave, ushqimeve përforcuese dhe ilaçeve nga e cila vendet perëndimore kanë shumë vështirësi për të dalë, ka filluar të bëhet problem edhe në vendin tonë.

Njeriu i sotëm po përballet me këto ushqime përforcuese sikur të ekzistonin disa sëmundje që janë bërë problem për njerëzit në kohëra të jash-tëzakonshme, si luftë, tërmet apo zi buke. Vallë, sa janë të vërteta dhe të sinqerta këto këshilla dhe sugjerime që duken si të pafajshme e që na ngjiten pothuajse si rrodhe me logjikën, “unë e kam marrë dhe më ka bërë mirë, prandaj merre edhe ti”, gjë e cila transmetohet pareshtur në programet televizive apo që shkon gojë më gojë nga fqinji te fqinji tjetër!

Vitaminat A-D-E-K, që njihen edhe si ADEK, janë vitamina që nuk mund t’i hedhim lehtë, ngaqë mbarten në qelizat tona duke u shkrirë në dhjamë pasi të merren. Domethënë, teprica e tyre që organizmi nuk e nxjerr dot jashtë, mund të na helmojë duke u mbledhur në indet dhe qelizat tona.

Në të njëjtën mënyrë, edhe metalet, si: kalciu-mi, zhiva, fosfori dhe arseniku, që gjenden te disa ushqime përforcuese, të cilat quhen suplement, hyjnë në qelizat tona dhe shkaktojnë dëmtime të përhershme. Edhe disa prej problemeve më të rëndësishme të njeriut të sotëm, e dimë se janë dobësia, lodhja dhe gjumi i çrregullt që kanë lidhje me helmimin e rëndë të metaleve.

Kur studiojmë probleme, të tilla si sjelljet e çrregullta te fëmijët, mangësia e përqendrimit dhe shpërqendrimi i memories e vëmendjes, shohim se ata lindin nga ushqimet e rafinuara, pijet me gaz dhe kola, ushqimet me ngjyruar dhe ushqimet përforcuese.

Arritjet në shkencë e në art dhe zhvillimi marra-mendës në teknologjinë e përparimit të shpejtë në

civilizim, i kanë bërë njerëzit e vërtetë pothuajse artificialë. Tashmë, mjaftohemi me aromën e frutave në vend të shijes dhe erës së tyre dhe jetojmë duke pandehur se kemi ngrënë fruta.

Përse vitaminat dhe ushqimet përforcuese, që na shfaqen si kamerdare shpëtimi nuk e japin efektin e pritshëm prej tyre, në mënyrë që të shpëtojmë nga shumë sëmundje, si: hiperaktiviteti, shpërqendrimi i vëmendjes, sëmundjet alergjike, astma, stresi, çrregullimi i gjumit, dobësia, kapitja, lodhja, dëshpërimi etj...

Përse nuk vijmë në vete prej sëmundjeve, edhe pse i bëjmë analizat dhe filmat me teknologjinë më të përpiktë? Përse nuk e arrijmë dot rezultatit e pritshëm në shumë sëmundje nga ilaçet dhe ushqimet përforcuese që na shfaqen si zgjidhje të mrekullueshme? Ne duhet ta pranojmë të vërtetën se nuk mund të arrijmë në një rezultat duke bërë letërsi zgjidhjesh e çajresh dhe duke shtuar pyetjet...

Nëse i hedhim një sy të shpejtë fabrikës së qelizës, që është guri më i vogël bazë i strukturës sonë, menjëherë mund të shikojmë përsosmërinë dhe natyrshmërinë e saj. Kjo fabrikë pothuajse ka një mbrojtje të veçantë kundrejt çdo gjëje që nuk është e natyrshme. Kur elementin e hekurit, ndaj të cilit ka nevojë për të prodhuar gjak, ta sigurojmë nga rrugë të natyrshme, ajo funksionon më me produktivitet dhe më shëndetshëm. Një qelizë gjaku e përpunon shumë më lehtë hekurin nga materialet e natyrshme, si: pekmezi, perimet me gjethe jeshile, fasulja, thjerrëza dhe mishi. Ndërsa hekurin e ushqimeve përforcuese të rafinuara, lëre që nuk e përpunon, por e ka shumë të vështirë edhe për ta thithur...

Ne mund të japim edhe shumë shembuj të tjerë, por përmbledhja e kësaj çështjeje është kjo: Kur të konsumojmë fruta e perime në stinën e tyre, duke marrë ushqime natyrale me masë e ekuilibër, nuk kemi nevojë ta mashtrojmë veten duke marrë preparate (përgatesa) të ushqimeve përforcuese apo të vitaminave. Uroj që nën dritën e maksimës “mbrojtje nga dëmi”, që është pranuar universalisht në mjekësi, ta mbajmë larg trupin tonë nga çdo gjë negative, të cilin Zoti (xh.xh.), na e ka dhënë amanet dhe na e ka bërë obligim ta ruajmë.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Ai ua pranoi pendimin
edhe atyre të treve,
që mbetën prapa atëherë,
kur toka, sado e gjerë,
iu duk e ngushtë dhe
iu shtrënguan shpirtrat,
aq sa u bindën
se nuk ka strehim tjetër
përveç Allahut e pastaj
Allahu u dha mëshirë
që të pendohen. Me të vërtetë,
Allahu pranon pendimin
dhe është Mëshirëplotë.”

(Teube, 118)

